LIGJ
Nr.10 083, datë 23.2.2009

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, SI AUTORITET KONTRAKTUES DHE AVN AG, STATKRAFT AS DHE DEVOLL HYDROPOWER SHA, SI BASHKËKONCESIONARË, PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË HIDROCENTRALIT NË LUMIN DEVOLL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet kontrata e koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe AVN AG, Statkraft AS dhe Devoll Hydropower sha, si bashkëkoncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Organet e pushtetit vendor apo qendror ndalohen të lëshojnë leje ndërtimi ose licenca në ato sipërfaqe, që përfshihen në zonat e sigurisë, të cilat mund të përmbyten.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6090, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONTRATË KONCESIONI
PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË HIDROCENTRALIT NË LUMIN DEVOLL, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NDËRMJET

MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
SI AUTORITETI KONTRAKTUES DHE EVN AG, STATKRAFT AS, DHE DEVOLL HYDROPOWER SHA SI BASHKË-KONCESIONARË

19 dhjetor 2008

KJO KONTRATË KONCESIONI për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në Lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë ("Kontrata"), lidhet më datë 19 Dhjetor 2008, ndërmjet:

1. MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Bul. "Dëshmorët e Kombit", 1001 Tiranë, Shqipëri, që vepron në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 463, datë 18 Korrik 2007, pjesa e parë e tij dhe referuar si ("METE" ose "Autoriteti Kontraktues");

dhe

2. a) EVN AG, shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Austrisë, me seli në adresën EVN Platz, 2344 Maria Enzersdorf, Austria, dhe regjistruar në Regjistrin e Shoqërive të Gjykatës Tregtare të Wiener Neustadt me nr. regjistrimi 72000 h ("EVN");

b) STATKRAFT AS, shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Norvegjisë, me seli në adresën Lilleakerveien 6, 0283 Oslo, Norway, dhe regjistruar në Regjistrin e Shoqërive të Norvegjisë me numër regjistrimi 987 059 699 ("STATKRAFT"); dhe

c) DEVOLL HYDROPOWER SHA, shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Sky Tower, Tiranë, Shqipëri, dhe regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Shqipërisë ("Shoqëria Koncesionare"),

në pjesën e dytë, secili referohet si "Bashkë-Koncesionar" dhe së bashku "Koncesionari" (në masën e parashikuar në Nenin 1.1).

Secilit prej tyre, si Autoritetit Kontraktues dhe Bashkë-Koncesionarëve, do t'u referohet individualisht si "Pala" dhe bashkërisht si "Palët".

DEKLARATA HYRËSE

DUKE QENË SE:

(A) Në përputhje me Ligjin "Për Koncesionet" nr. 9663, datë 18 Dhjetor 2006, Vendimin nr. 463 datë 18 Korrik 2007 dhe Kërkesën për Propozim dhe Udhëzimet për Ofertuesit datë 3 Gusht 2007, METE ka ftuar ofertuesit të paraqesin ofertat e tyre për Projektin;

(B) EVN paraqiti një ofertë detyruese për Projektin më 19 Nëntor 2007 ("Oferta"), përshkrimi teknik i së cilës është bashkëlidhur si Shtojca A;

(C) METE e vlerësoi EVN si ofertuesin fitues për Projektin, për të cilën Koncesionari u njoftua më 22 janar 2008;

(D) Me miratimin e METE, EVN në këtë Projekt ju bashkua edhe Shoqëria STATKRAFT dhe Shoqëria Koncesionare;

(E) Kjo Kontratë Koncesioni do të hyjë plotësisht në fuqi dhe do të jetë e zbatueshme në datën më të vonë të sa më poshtë (i) nënshkrimi i saj nga Palët; dhe (ii) data e miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë; dhe (iii) 15 dita pas datës së botimit në Fletoren Zyrtare të ligjit ratifikues të Kontratës së Koncesionit nga Kuvendi i Shqipërisë ("Data e Hyrjes në Fuqi"); nëse kushtet (i) deri në (iii) më sipër nuk janë plotësuar para datës 31 Mars 2009 (data përfundimtare për plotësimin e tyre) atëherë Autoriteti Kontraktues do ta çlirojë Garancinë e Kontratës.

(F) Në të njëjtën kohë me hyrjen në fuqi të kësaj Kontrate, Shoqëria Koncesionare lidh me OST një Kontratë për Ndërtimin dhe Lidhjen e Shtrirjes së Rrjetit të Transmetimit dhe një Kontratë për Përdorimin e Rrjetit të Sistemit të Transmetimit (bashkërisht "Kontratat e Transmetimit") për ndërtimin dhe shfrytëzimin e Linjave të Transmetimit dhe përdorimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

Dhe duke pasur parasysh zotimet detyruese të parashikuara këtu, të cilat konsiderohen të mjaftueshme në këtë Kontratë, Palët bien dakord si më poshtë:

PALËT, PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

1.1 Bashkë-Koncesionarët

1.1.1 Detyrimet e Koncesionarit. Bashkë-Koncesionarët do të jenë bashkërisht dhe

individualisht përgjegjës përballë Autoritetit Kontraktues për përmbushjen e detyrimeve që i janë caktuar Koncesionarit në këtë Kontratë (për të shmangur keqkuptimin, kjo vetëm njëherë), përveç kur konteksti qartësisht nënkupton se një detyrim do të merret përsipër nga një ose dy në vend të vetëm të gjithë Bashkë-Koncesionarëve. Përmbushja e saktë dhe e plotë e një detyrimi që i është caktuar Koncesionarit nga secili prej Bashkë-Koncesionarëve do të ketë efektin e një shlyerjeje të plotë të atij detyrimi për të gjithë Bashkë-Koncesionarët.

1.1.2 Të drejtat e Koncesionarit. Në varësi të Nenit 5.4.1, secili nga Koncesionarët do të ketë të drejtë të ushtrojë të drejtat dhe gëzojë përfitimet që janë parashikuar për Koncesionarin në këtë Kontratë, ndërkohë që ushtrimi i të drejtave dhe gëzimi i përfitimeve në rrjedhën normale të biznesit do të bëhet nepërmjet përfaqësimit të secilit Bashkë-Koncesionar nga Shoqëria Koncesionare, nëqoftëse nuk është parashikuar shprehimisht ndryshe në këtë Kontratë ose në ligj.

1.1.3 Referenca të tjera. Çdo referim "Koncesionar" në këtë Kontratë që nuk parashikohet në Nenet 1.1.1 dhe 1.1.2 do të konsiderohet se i bëhet ndonjërit ose të gjithë Bashkë-Koncesionarëve, përveç kur konteksti qartësisht nënkupton se kjo referencë do të bëhet për një ose dy në vend të të gjithë Bashkë-Koncesionarëve.

Përkufizimet

Kurdoherë që do të përdoren në këtë Kontratë (duke përfshirë edhe Shtojcat e saj), përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, fjalët e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

"Rrugët Hyrëse" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 7.2.6.

"Kostot Aktuale të Investimit" janë kostot e përgjithshme referuar si Shpenzimet e Fazës 1 në Shtojcën E të kryera faktikisht nga Koncesionari në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e Projektit para Datës Faktike të Përfundimit të Punimeve.

"Data Faktike e Përfundimit të Punimeve" është data në të cilën është lëshuar, ose konsiderohet se është lëshuar, Çertifikata e Përfundimit Final, në zbatim të Nenit 7.3.9 (b), përsa i përket Hidrocentralit të fundit që do të përfundohet.

"Pala e Cenuar" është Pala e Cenuar (ose që pretendon se është cenuar) nga një Rast i Forcës Madhore.

"Filial" do të thotë një person juridik i Kontrolluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga një person tjetër juridik, nëpërmjet një ose më shumë ndërmjetësve.

"Totali i NBK" do të thotë totali i normës së brendshme të kthimit të Projektit për t'u përllogaritur ashtu siç është përcaktuar në Shtojcën E.

"Kontratë" do të thotë kjo Kontratë Koncesioni (dhe të gjitha Shtojcat e saj, të cilat do të konsiderohen se janë pjesë përbërëse e saj).

"Shtojcë" do të thotë një shtojcë e kësaj Kontrateje.

"Autoriteti Emërues" ka kuptimin e dhënë në Seksionin 13.2.2(a)(iii).

"Autorizim" është çdo miratim, leje, licencë, autorizim ose çertifikatë, ose akt tjetër i një Enti Shtetëror, nxjerrja ose ripërtëritja e së cilës është në përgjegjësinë e çdo Enti Shtetëror dhe që kërkohet në lidhje me zbatimin, dorëzimin dhe përmbushjen e kësaj Kontrateje, zbatimin e Projektit, ndërtimin dhe shfrytëzimin e Hidrocentraleve, shitjen e Prodhimit Elektrik Neto dhe riatdhesimin e përfitimeve ose pagesave të borxhit nga Koncesionari ose Shoqëria Koncesionare, në çdo rast në përputhje me këtë Kontratë duke përfshirë (pa kufizim) të gjitha lejet e nevojshme që lidhen me:

a) Sheshet dhe Gëzimin e Qetë;

b) mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, duke përfshirë miratimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis nga Ministria e Mjedisit të Republikës së Shqipërisë;

c) të drejtat e përdorimit të ujit;

d) të drejtat (duke përfshirë edhe krijimin e guroreve) për të përdorur Materialet e Nevojshme të Ndërtimit të cilat gjenden në Republikën e Shqipërisë, qofshin ose jo të pranishme tek Sheshet (duke përfshirë materialet nga shtrati i lumit Devoll);

e) të drejtat për të prerë dhe përdorur lëndën e drurit nga pyjet në Sheshe; dhe

f) të drejtat për të depozituar dhe ruajtur mbetjet dhe materialet e gërmuara, si tek Sheshet dhe kudo gjetkë, dhe për të trajtuar mbetjet ujore.

"Hidrocentrali i Banjës" do të thotë strukturat ekzistuese, të ndërtuara midis 195 dhe 95 metrave mbi nivelin e detit, që ndodhen në afërsi të fshatit të Banjës, të cilat do të rindërtohen

dhe përfundohen nga Koncesionari, siç është përshkruar në Shtojcën A, në zbatim të Kërkesave Teknike Minimale, dhe që përfshijnë të gjitha punimet civile dhe instalimet elektro-mekanike të nevojshme, duke përfshirë, pa kufizim, turbinat, gjeneratorët, pajisjet ndihmëse të ndërtesës së centralit, transformatorët, pajisjet e nënstacionit dhe linjën e transmetimit deri në Pikën e miratuar të Lëvrimit.

"Rezervuari i Banjës" do të thotë rezervuari ujor i kontrolluar nga diga ekzistuese e Hidrocentralit të Banjës.

"Pajisje Mbrojtëse Bllokuese e Shkarkimit të Poshtëm" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 2.6.6.

"Ditë Pune" do të thotë të gjitha ditët e javës përveç të Shtunave, të Dielave dhe festave të tjera zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

"Ndryshim në Ligj" do të thotë:

a) nxjerrja, miratimi, dekretimi, hyrja në fuqi e një ligji të ri, kërkese të re ligjore ose akti tjetër detyrues në Shqipëri, ose shfuqizimi, amendimi, ri-interpretimi, ndryshimi në zbatim ose ndryshimi pas datës së ofertës së Koncesionarit për Projektin, i ndonjë ligji ose kërkese ligjore ekzistuese në Shqipëri, që

i) ka natyrë mjedisore ose teknike e cila do të sillte si pasojë bërjen e Ligjit më të vështirë për t'u zbatuar se rregullat ose rregulloret e Bashkimit Evropian në fuqi në atë kohë, përsa i përket thelbësisht të njëjtës çështje; ose

ii) ka si objekt drejtpërsëdrejti Projektin dhe/ose është ose sjell të qenit diskriminues ndaj Koncesionarit; ose

iii) përmban masa të kontrollit të çmimeve dhe/ose kufizime të shitjeve të cilat cenojnë prodhuesit kryesorë të energjisë.

b) çdo Autorizim që i është dhënë Koncesionarit dhe që kërkohet nga ai për të përmbushur detyrimet e tij sipas Kontratës ose ndonjë kontrate tjetër të nevojshme për shfrytëzimin, mirëmbajtjen ose financimin e Projektit dhe që më pas ndërpritet, anullohet, amendohet, ndryshohet ose zëvendësohet, përveç se si pasojë e:

i) ndërprerjes, anullimit, amendimit, ndryshimit ose zëvendësimit të këtij Autorizimi në përputhje me kushtet sipas të cilave ai u dha fillimisht; ose

ii) moszbatimit nga Koncesionari i ndonjë kushti thelbësor të lidhur me këtë Autorizim ose të përcaktuar në të; dhe

c) çdo Autorizim kërkuar nga Koncesionari në kohën e duhur, dhe ndjekur në mënyrë këmbëngulëse prej tij, që nuk është dhënë, ose dhënia e të cilit është vonuar në mënyrë të paarsyeshme, përjashtuar rastet kur refuzimi nga Enti përkatës Shtetëror për ta dhënë, ose vonesa e Enti Shtetëror në dhënien e këtij Autorizimi:

i) është bërë në përputhje me ligjin ose kërkesat ligjore që rregullojnë dhënien ose ndryshe që lidhen me këto Autorizime duke përfshirë për të shmangur çdo keqinterpretim ushtrimin ashtu si duhet nga një Ent Shtetëror të ndonjë diskrecioni të dhënë nga një ligj ose kërkesë ligjore e tillë ose vendosjen e kushteve të arsyeshme për çdo Autorizim ku ligji ose kërkesa ligjore përkatëse parashikon këtë vendosje; ose

ii) në mënyrë të arsyeshme (duke përfshirë një parashikim të arsyeshëm) mund të ishte shmangur ose të shmanget apo kapërcehet nga një Koncesionar që vepron si Operator i Arsyeshëm dhe i Kujdesshëm.

"Pajisje Mbrojtëse Bllokuese" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 2.6.6.

"Bashkë-Koncesionarët" ka kuptimin që i është dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Kontrate.

"Përfundimi i Punimeve sipas Grafikut" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 7.2.2.

"Raporti i Përfundimit" do të thotë raporti i përfundimit që do të lëshohet nga Koncesionari në përputhje me Nenin 7.3.9 (a)

"Projekt-Ideja" do të thotë specifikimet teknike të Hidrocentraleve të përgatitura nga Koncesionari siç është përshkruar në Shtojcën A.

"Pagesa e Koncesionit" ka kuptimin e parashikuar në Nenin 0.

"Përqindja e Pagesës së Koncesionit" është 2%, me kusht që gjatë Zgjatjes së Afatit, Përqindja e Pagesës së Koncesionit do të jetë 4%.

"Të drejtat Koncesionare" janë të drejtat Koncesionare që nga Data e Hyrjes në Fuqi siç

është parashikuar në vijim në Nenin 2 (Të drejtat Koncesionare).

"Koncesionari" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 1.1.

i) "Paaftësia Paguese e Koncesionarit" është secila nga dukuritë e mëposhtme: (i) marrja e një vendimi nga Aksionarët për likujdimin e Koncesionarit përveç në rastin e një ristrukturimi përsa i përket aftësisë paguese; (ii) depozitimi vullnetar nga ana e Koncesionarit i një kërkese në gjykatë për falimentimin, kërkese për pezullim dhe zgjatje afati ose mjeti tjetër ligjor; (iii) emërimi i një likujduesi në një padi për likujdimin e Koncesionarit pas njoftimit për këtë dhe pas seancës përkatëse, emërim i cili nuk është refuzuar ose vonuar brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga ky emërim; ose (iv) dhënia nga një gjykatë me judiriksion mbi Koncesionarin e një urdhri për likujdimin e Koncesionarit, që nuk është pezulluar ose shfuqizuar nga një gjykatë kompetente brenda nëntëdhjetë (90) ditëve.

"Pika e Lidhjes" është çdo pikë në të cilën Linjat e Transmetimit janë lidhur me Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike.

"Humbje e Tërthortë" është çdo humbje ose dëm i pësuar nga njëra Palë e cila nuk përbën Humbje të Drejtpërdrejtë, përveç humbjes ose dëmit që i përket

a) Dëmeve të Likujdueshme; dhe

b) të ardhurave nga ndonjë policë sigurimi e kërkuar për t'u mbajtur sipas kësaj Kontrateje.

"Ndërtim" është shqyrtimi dhe studimi, projektimi, furnizimi, pajisja, ndërtimi, reabilitimi dhe ripërtëritja, kontraktimi, instalimi, kolaudimi, vënia në punë dhe kryerja e gjërave të tjera në përputhje me (dhe në rastin e Hidrocentraleve, në mënyrë që të mundësohet shfrytëzimi në përputhje me) kërkesat e kësaj Kontrateje dhe Autorizimet dhe "Ndërtimi", "Të ndërtosh" dhe "Të ndërtuara" do të interpretohen në të njëjtën mënyrë.

"Leje Ndërtimi" është autorizimi që Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit, në të cilin Autoriteti Kontraktues do të pranojë me shkrim se Koncesionari mund të fillojë Ndërtimin.

"Kufiri Maksimal i Dëmeve të Likujdueshme në Ndërtim" është tavani i dëmeve të likujdueshme referuar në Nenin 7.3.11 (c).

"Ndërtimi i Hidrocentralit të Banjës" është periudha që (i) fillon në datën kur Koncesionari fillon faktikisht Punimet e Ndërtimit në digën e Banjës (që, për të shmangur çdo keqinterpretim, nuk përfshijnë (x) punimet që nuk kanë ndikim fizik në digën e Banjës, të tillë si, në veçanti punimet që lidhen me shqyrtimin, studimin dhe projektimin e Hidrocentralit të Banjës, dhe (y) Ndërtimin e Pajisjeve Mbrojtëse Bllokuese), por në asnjë rast para Datës së Fillimit të Punimeve të Ndërtimit, dhe (ii) përfundon në datën që lëshohet Çertifikata e Përfundimit të Plotë të Hidrocentralit të Banjës në përputhje me Nenin 7.3.9 (b).

"Faza e Ndërtimit" është periudha e kohës që fillon në Datën e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit dhe mbaron në Datën e Përfundimit Faktik të Punimeve.

"Garancia e Kontratës" është një garanci bankare e nivelit të parë e lëshuar nga një bankë kryesore ndërkombëtare dhe me reputacion që vepron në Shqipëri (nëpërmjet një filiali ose dege), e rregulluar nga Ligji shqiptar dhe që siguron përmbushjen e detyrimeve nga Koncesionari, siç përshkruhet më tej në këtë Kontratë, duke përfshirë Nenin 7.3.14 (Garancia e Kontratës).

"Punimet e Ndërtimit" janë, në lidhje me çdo Hidrocentral dhe çdo Shesh, Punimet që nevojiten dhe që janë ndihmëse për ndërtimin dhe përfundimin e këtij Hidrocentrali, duke përfshirë të gjitha punimet e domosdoshme civile dhe instalimet elektro-mekanike, duke përfshirë, pa kufizim, turbinat, gjeneratorët, pajisjet ndihmëse për ndërtesën e centralit, transformatorë, pajisjet e nënstacionit, dhe Linjat e Transmetimit.

"Data e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 3.6.

"Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit sipas Grafikut" është data q rezulton kur zbriten 72 muaj nga Data e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit.

"Vëllimi i Prodhimit sipas Kontratës" është sasia e Energjisë Elektrike e barabartë me 59 (pesëdhjetë e nëntë) TWh, siç përcaktohet, sipas rastit, në përputhje me këtë Kontratë, por në çdo rast duke llogaritur Energjinë Elektrike të prodhuar me anë të aplikimit të ndonjë formë të akumulumit me pompim.

"Autoritet Kontraktues" do të thotë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë.

"Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues" do të thotë çdo përfaqësues të cilin Autoriteti Kontraktues mund ta caktojë herë pas here për ta përfaqësuar atë në lidhje me zbatimin e ndonjërës nga të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate (duke përfshirë sa i përket ndërtimit, edhe Testet e Funksionimit dhe pranimin e Punimeve të Ndërtimit): me kusht që Autoriteti Kontraktues të njoftojë Koncesionarin menjëherë pas çdo ndërprerjeje ose zëvendësimi.

"Kontroll", i përdorur si emër ose si folje, është pushteti për të zgjedhur shumicën e bordit të drejtorëve (ose të ndonjë organi tjetër të ngjashëm të krijuar) ose ndryshe për të drejtuar menaxhimin dhe politikat e Shoqërisë së Projektit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, si me anë të pronësisë së titujve me të drejtë vote, ashtu edhe me anë marrëveshjesh ose në forma të tjera.

“Pika e Lëvrimit”, është, përsa i përket një Hidrocentrali, pika ku matet Prodhimi Neto i Energjisë Elektrike dhe që gjendet në anën dytësore (110/220 kV) të transformatorit rritës ose të nënstacionit në centralin përkatës në pronësi të Koncesionarit dhe nëpërmjet të cilës Prodhimi Neto i Energjisë Elektrike kalon nga kontrolli dhe risku i Konçesionarit tek Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike.

“Projekt i Detajuar” është propozimi i projektit të detajuar përsa i përket secilit Hidrocentral, i cili do të paraqitet nga Koncesionari në aplikimin e tij për Leje Ndërtimi.

"Lejet për Zhvillimin e Punimeve" është çdo Autorizim që kërkohet nga Koncesionari për kryerjen e studimeve dhe kërkimeve të cilat Koncesionari i konsideron të nevojshme ose të përshtatshme në lidhje me planifikimin e Projektit.

"Lumi Devoll" është Lumi Devoll referuar në Shtojcën A.

"Lugina e Lumit Devoll" është lugina e Lumit Devoll referuar në Shtojcën A.

"Humbje e Drejtpërdrejtë" është (a) për Koncesionarin (i) çdo humbje neto e të ardhurave (të ardhurat të humbura si rezultat i shkeljes ose mospërmbushjes së kësaj Kontrateje nga Autoriteti Kontraktues minus të ardhurat e fituara si rezultat i shkeljes ose mospërmbushjes së kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues, me kusht që të zbatohen normat dhe parimet e zbritjes standarte të tregut në lidhje me të ardhurat e mëvonshme) dhe/ose çdo kosto shtesë të shkaktuar nga shkelja ose mospërmbushja e kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues dhe (ii) çdo humbje ose dëm të pësuar nga Koncesionari si rezultat i drejtpërdrejtë i dëmit në pronë ose dëmit vetjak; dhe (b) për Autoritetin Kontraktues (i) çdo humbje neto e Tarifës së Koncesionit (humbje e Tarifës së Koncesionit si pasojë e shkeljes ose mospërmbushjes së kësaj Kontrateje nga Koncesionari minus Tarifën e Koncesionait të fituar si rezultat i shkeljes ose mospërmbushjes së kësaj Kontrateje nga Koncesionari, me kusht që të zbatohen normat dhe parimet e zbritjes standard të tregut përsa i përket marrjes në të ardhmen të Pagesës së Koncesionit) dhe (ii) çdo humbje ose dëm të pësuar nga ai si pasojë e drejtëpërdrejtë e dëmit pasuror ose personal.

"Mosmarrëveshje" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 13.1.

"Data e Hyrjes në Fuqi" ka kuptimin e përcaktuar në Pikën E të Deklaratës Hyrëse të kësaj Kontrateje.

"Energji Elektrike" është energjia elektrike e prodhuar, e transmetuar ose furnizuar nga një qark elektrik gjatë një intervali kohor duke qenë integrali përsa i përket kohës së energjisë së menjëhershme, të matur në njësi orësh megavat (MWh).

"Ndikimi i Vlerësimit në Mjedis" është raporti që vlerëson ndikimin real dhe të mundshëm të Projektit në mjedis në përputhje me Ligjin.

“Ligj Mjedisor” është Ligji që lidhet me mjedisin, duke përfshirë Ligjet që lidhen me përdorimin e tokës, urbanistikën, vlerësimin mjedisor, trashëgiminë mjedisore, ujin, ujëmbledhësat, lumenjtë, detrat, shtratin e detit, bregdetin, plazhet, ajrin, dheun, ujrat tokësore ose ujin, zhurmën, tokën, elementët kimikë, pesticidet, substancat e rrezikshme, shtresën e ozonit, mbetjet, mallrat e rrezikshme, rregulloret e ndërtimit, vendet e zëna nga ndërtesat, shëndetin publik, shëndetin dhe sigurinë profesionale, rrezikun mjedisor, çdo aspekt të mbrojtjes së mjedisit.

"Studim Mjedisor" është studimi mjedisor për të gjitha zonat që janë pjesë përbërëse të çdo Sheshi të cilin Koncesionari do ta kryejë ose do të bëjë që të kryhet, me shpenzimet e tij, menjëherë pasi Koncesionarit t’i bëhet i mundur hyrja në këto Sheshe dhe para fillimit të Ndërtimit.

“Pjesëmarrja e Aksionarëve” në Shoqërinë Koncesionare do të thotë kapitali i Shoqërisë Koncesionare përsa i përket investimit të tyre në Shoqërinë Koncesionare duke përfshirë detyrime parash të huazuara nga Shoqëria Koncesionare nga një Aksionar ose Filial i tij, megjithatë vetëm në masën që ky detyrim i nënshtrohet (qoftë kur është rënë dakord shprehimisht ose në bazë të ligjit) çdo detyrimi parash të huazuara të Shoqërisë së Projektit sipas ndonjë Dokumenti Financiar, si dhe huatë afatshkurtra të pjesëmarrjes së aksionarëve.

"EVN" ka kuptimin që i është dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Kontrate.

"Ligji për Shpronësimet" ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën B (Procedurat Treguese të Shpronësimit).

"Zgjatje Afati" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 10.1.2.

"Njoftimi i Mospërmbushjes" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 7.3.10.

"Çertifikata e Përfundimit Final" është çertifikata që do të lëshohet nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me Nenin 7.3.9 (b), dhe që vërteton përfundimin e plotë të Hidrocentralit.

“Mbyllje Financiare” është data e cila nuk do të jetë më vonë se 12 muaj pas Datës së Hyrjes në Fuqi kur Shoqëria Koncesionare konfirmon me shkrim në thelb ato që përmbahen në Shtojcën H (Forma e Njoftimit të Mbylljes Financiare).

"Raporti Financiar" do të thotë raporti i përcaktuar në Nenin 4.3.

“Dokumente Financiare” janë çdo marrëveshje huaje, bono, obligacione, kontrata, instrumente, marrëveshje sigurimi, deklarata regjistrimi ose informimi, marrëveshje varësie, hipoteka, akte përfaqësimi e administrimi, marrëveshje kredie, marrëveshje për blerje bonosh ose obligacionesh, marrëveshje pjesëmarrjeje dhe dokumente të tjera që lidhen nga Shoqëria Koncesionare në lidhje me financimin e një projektimi, prokurimi, ndërtimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtjeje të Hidrocentraleve dhe për ushtrimin e të Drejtave Koncesionare, duke përfshirë modifikimet, plotësimet, shtesat, zgjatjet, ripërtëritjet dhe zëvendësimet e çdo financimi të tillë.

“Palë Financuese” do të thotë çdo person ose persona që financojnë ose rifinancojnë borxhe sipas Dokumenteve Financiare të Shoqërisë së Projektit në lidhje me projektimin, prokurimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Hidrocentraleve dhe për ushtrimin e të Drejtave Koncesionare, si dhe zëvendësuesve dhe të ngarkuarve të lejuar të këtyre personave, duke përfshirë çdo agjent ose përfaqësues për një person ose persona të tillë, përfshirë një Aksionar ose një Filial të një Aksioneri përsa i përket ndonjë borxhi që nuk është borxh që jepet si pjesëmarrje në kapitalin aksionar.

"Rasti i Forcës Madhore" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 10.2.

“Praktika e Industrisë së Mirë” është të veprosh në mirëbesim për të përmbushur detyrimet me aftësinë dhe përkujdesin e duhur në përputhje me kërkesat e ligjit dhe praktikën e mirë ndërkombëtare në industrinë e elektricitetit përgjithësisht dhe vecanërisht në industrinë hidroelektrike për sa i përket projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së energjisë hidroelektrike, e cila pritet në mënyrë të arsyeshme të realizohet nga një kontraktor i aftë dhe me përvojë, inxhinier ose operator, sipas rastit, në rrethana të njëjta ose të ngjashme.

"Të dhënat Publike” janë të gjitha të dhënat dhe informacioni (i) që kërkohet në mënyrë të arsyeshme për zbatimin e Projektit dhe/ose përmbushjen nga Koncesionari të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrateje, dhe (ii) që Autoriteti Kontraktues ose ndonjë Ent tjetër Shtetëror ka në posedim dhe që mund të gjendet në mënyrë të arsyeshme, dhe (iii) që është kërkuar ose do të kërkohet nga Koncesionari.

“Ent Shtetëror” do të thotë (i) Qeveria e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike a ushtarake e saj; dhe (ii) çdo ent tjetër shtetëror, instrument, agjenci ose autoritet nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike e saj, që ushtrojnë juridiksion sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë mbi Koncesionarin, në çdo rast brenda Republikës së Shqipërisë. Për të shmangur çdo keqinterpretim ‘kontroll i tërthortë’ përfshin vëzhgimin ose mbikëqyrjen e duhur të OST nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

"Sistem i Transmetimit të Energjisë Elektrike" është sistemi kombëtar Shqiptar i transmetimit të energjisë elektrike.

"Kodi i Sistemit të Transmetimit" është kodi i zbatueshëm që rregullon përdorimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

"Pajisje Mbrojtëse Bllokuese e Tunelit të Prurjes" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 2.6.6.

"Njoftim për Rritjen e Kostove" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 3.5.1.

"Informacion" është i gjithë informacioni i siguruar nga Koncesionari para ose në datën e lidhjes së kësaj Kontrateje, informacion i cili lidhet me (a) këtë Kontratë dhe/ose (b) Projektin dhe/ose (c) aftësinë e Koncesionarit për të marrë përsipër Projektin në përputhje me këtë Kontratë.

"Afati Fillestar" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 10.1.1.

"Kapacitet i Instaluar" është, në lidhje me të gjitha Hidrocentralet, kapacitetin i përgjithshëm i të gjitha Hidrocentraleve, shprehur në MW për t'u përcaktuar në Projektin e Detajuar;

"Kërkesat për Sigurim" janë kërkesat përsa i përket llojeve dhe shumave të sigurimit që do të merren nga Koncesionari, ashtu si janë përshkruar në Shtojcën F.

"Data e Mbushjes së Ujëmbledhësit me Ujë" është data e përcaktuar si e tillë në kërkesën e Koncesionarit për lejet e ndërtimit në të cilën do të fillojë mbushja me ujë e ujëmbledhësit të secilit Hidrocentral.

"Rasti i Realizimit të NBK" është Rasti kur NBK Totale arrin NBK Minimale të Nevojshme.

"Ligj" është çdo ligj i zbatueshëm kombëtar ose lokal, urdhëresë, dekret ose ligj tjetër (duke përfshirë Ligjin Mjedisor), rregullore, akt nënligjor ose çdo rregull, kod (duke përfshirë Kodin e Sistemit të Transmetimit) ose udhëzim apo licencë miratim, leje, autorizim ose aprovim tjetër i Republikës së Shqipërisë ose i çdo entiteti ose nëndarjeje të saj, ose të një personi ligjor (i pavarur ose jo), që ka juridiksionin e duhur, në masën e publikuar dhe që disponohet publikisht, dhe që është subjekt zbatimi i vendimeve të gjykatave të ndryshme dhe të trupave gjyqësorë të Republikës së Shqipërisë, të vendimeve dhe urdhrave ekzekutive, të udhëzimeve a qarkoreve të departamenteve, si dhe prononcimet dhe interpretimet e organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, që kanë juridiksion mbi çështjen në fjalë; siç mund të ndryshohen hera herës gjatë Afatit të Kontratës së Koncesionit.

"Aksionarët Kryesorë" janë EVN dhe STATKRAFT.

"Huadhënësi" është një institut financiar (por jo Koncesionari e as ndonjë Filial i Koncesionarit) i cili i jep Koncesionarit (ose Shoqërisë së Projektit) hua ose zmadhon kredinë ose financimet apo rifinancimet e tjera në lidhje me zbatimin e Projektit.

"Dëmet e Likujdueshme" do të thotë ato dëme të likujdueshme të pagueshme nga Koncesionari në përputhje me Nenin 7.3.11.

"Vlera e Dëmeve të Likujdueshme" do të thotë për të gjitha Hidrocentralet së bashku vlera totale prej:

c) 20,000 Euro për ditë vonese nga dita e 1-rë në ditën e 60-të të periudhës së vonesës;

d) 30,000 Euro për ditë vonese nga dita e 61-të në ditën e 120-të të periudhës së vonesës;

e) 40,000 Euro për ditë vonese nga dita e 121-të në ditën e 180-të të periudhës së vonesës;

f) 50,000 Euro për ditë vonese pas ose në ditën e 181-të;

ku Vlera e Dëmeve të Likujdueshme për secilin nga tre Hidrocentralet do të thotë një e treta e vlerave të sipërpërmendura.

"Vlera e Veprimit Ndreqës të Dëmeve të Likujdueshme" është për të gjitha Hidrocentralet së bashku vlera e përgjithshme 5,000 Euro për ditë vonese pas kalimit të periudhës së ndreqjes prej 60 Ditë Pune nga dita e 1-rë në ditën e 100-të, ku Vlera e Veprimit për Ndreqjen e Dëmeve të Likujdueshme është një e treta e vlerës së sipërpërmendur.

"Hidrocentrali i Lozhan-Grabovës" është hidrocentrali hidroelektrik që do të Ndërtohet në ose përreth zonës së njohur si Lozhan-Grabovë në Luginën e Lumit Devoll, ashtu siç është përshkruar në Shtojcën A, në zbatim të Kërkesave Teknike Minimale, duke përfshirë, pa kufizim, turbinat, gjeneratorët, pajisjet ndihmëse për ndërtesën e centralit, transformatorë, pajisjet e nënstacionit, dhe linjën e transmetimit në pikën e miratuar të lëvrimit të elektricitetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

"Kompensimi për VTHDQ" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 10.3.7.

"Njoftimi për VTHDQ" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 10.3.1 më poshtë.

"m m.n.d." do të thotë metra mbi nivelin e detit.

"Veprim Thelbësisht i Dëmshëm i Qeverisë " ose "VTHDQ" është:

a) i) çdo ngjarje me Rrezik Politik;

ii) shpronësimi, marrja, konfiskimi ose shtetëzimi i Hidrocentralit, aksioneve në Shoqërinë e Projektit dhe/ose të Drejtave Koncesionare;

iii) ndalimi ose kufizimi i riatdhesimit ose transferimit të fitimeve ose të të ardhurave të Koncesionarit, Pjesëmarrjes së Aksionarëve dhe të shërbimeve për detyrimet (sipas Dokumenteve Financiare) nga Republika e Shqipërisë (duke përfshirë ndalimin dhe kufizimet në këmbimin e monedhave të huaja);

b) mosvënia në dispozicion të tërësisë së çdo Sheshi ose mosdhënia nga Autoriteti Kontraktues Koncesionarit të të drejtave përkatëse reale të pronësisë në përputhje me këtë Kontratë ose mosgarantimi i Gëzimit të Pacenuar të çdo Sheshi (ose çdo pjese të tyre) nga Koncesionari, në çdo kohë deri në përfundim të Afatit;

c) ndërmarrja e kufizimeve ose masave me efekt të ngjashëm, veçanërisht në lidhje me makineritë dhe materialet përkatëse për realizimin e Projektit, racionimet ose shpërndarjet, ose mbyllja e porteve, dokeve, objekteve për shërbimet ose përdorimin e transportit detar ose lundrimit, në çdo rast qoftë të vendosura nga Ligji apo ndryshe nga ndonjë Ent Shtetëror (përveç atyre ekzistuese ose të aplikuara që nga Data e Hyrjes në Fuqi);

d) kufizimet ose masat me efekt të ngjashëm përsa i përket punësimit të personelit të nevojshëm, pavarësisht kombësisë dhe/ose vendbanimit të tyre, përveç kufizimeve për shkaqe të lidhura me dënime të rënda penale të këtij personeli nga një gjykatë kompetente;

e) zbulimi i ndonjë objekti të bërë nga njeriu ose send antik të groposur në Shesh;

f) çdo kufizim ligjor i cili pengon Koncesionarin që lirisht të shesë ose eksportojë ndonjë pjesë të Prodhimit Neto Elektrik te ndonjë palë brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, përveç kufizimeve të parashikuara në këtë Kontratë;

g) çdo shkelje thelbësore e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrateje nga Autoriteti Kontraktues;

h) (i) çdo veprim ose mosveprim i paarsyeshëm i një Enti Shtetëror si pasojë e të cilit zvogëlohet vëllimi total mesatar i ujit për prodhimin e elektricitetit krahasuar me shifrat respektive të planifikuara në Ofertë; ose (ii) çdo kufizim i paarsyeshëm nga një Ent Shtetëror për të përdorur ujin e disponueshëm në përputhje me (i) me sipër në çdo Hidrocentral në kohën e prodhimit, që përcaktohet nga Koncesionari sipas gjykimit të tij; ose

i) një Ndryshim në Ligj,

me kusht që një ngjarje e tillë të ndodhë pas nënshkrimit të kësaj Kontrateje, ose në rastin e një Ndryshimi në Ligj, pas datës së ofertës së Koncesionarit për Projektin; dhe pasojat thelbësore në kundërshtim me Kontratën të kësaj ngjarjeje mbi përmbushjen nga Koncesionari të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate ose mbi fizibilitetin ekonomik ose teknik të Projektit nuk mund të shmangen ose kapërcehen, ose nuk mund të ishin shmangur ose kapërcyer, nga Koncesionari që vepron si Operator i Arsyeshëm dhe i Kujdesshëm. Për shmangjen e çdo keqinterpretimi, që Veprimet e Shtetit Thelbësisht të Dëmshme të përbëjnë VSHTHD nuk kërkohet që ato të kryhen me faj nga Autoriteti Kontraktues; në veçanti, mosvënia e pjesëve të Sheshit në dispozicion të Koncesionarit nga Autoriteti Kontraktues, ose mosdhënia e të drejtave përkatëse reale të pronësisë Koncesionarit, të cilat aktualisht janë në pronësi të organeve të qeverisjes vendore dhe që nuk mund të shpronësohen, edhe pse Koncesionari ofron kompensim të drejtë për pronarët e tyre përbën VSHDK, me kusht që mos vënia në dispozicion e këtyre pjesëve të Shesheve nga ana e Autoritetit Kontraktues të cilat janë aktualisht në pronësi të organeve të qeverisjes vendore që nevojiten sipas Nenit 3.4.4 për gërminin dhe nxjerrjen e Materialeve të Nevojshme të Ndërtimit do të jetë Veprim Thelbësisht i Dëmshëm i Qeverisë vetëm nëqoftëse nuk ka alternative të tjera të mundshme për gjedhje nga ana e Koncesionarit.

"Minimum Technical Requirements" means the

"Kërkesat Teknike Minimale" janë kërkesat teknike minimale të specifikuara në Pjesën A të Shtojcës A.

"Prodhimi Elektrik Neto" është e gjithë Energjia Elektrike e lëvruar në Pikën e Lëvrimit

nga Koncesionari në çdo kohë deri në përfundim të Afatit.

"Të Ardhurat Neto të Shitjes së Elektricitetit" ka kuptimin e përcaktuar në Shtojcën E.

"Vlera Aktuale Neto" është vlera aktuale e derdhjeve të ardhshme cash e cila llogaritet duke zbritur këto derdhje cash nga norma e zbatuar e kthimit.

"Faza e Shfrytëzimit" është periudha që fillon në Datën e Përfundimit Faktik të Punimeve dhe mbaron në ditën e fundit të Afatit.

"OST" është shoqëria OST SHA (ose person tjetër trashëgues), i cili është operatori i autorizuar i sistemit të transmetimit për sistemin kombëtar të energjisë elektrike të Republikës së Shqipërisë.

"Palë" or "Pala" ka kuptimin që u është dhënë këtyre fjalëve në pjesën hyrëse të kësaj Kontrateje.

"Testet e Funksionimit" janë testet e specifikuara në shtojcën G (Udhëzimet e Testeve të Funksionimit).

"NJZP" është Njësia e Zbatimit të Projektit siç është përcaktuar në Nenin 3.1.

"Hidrocentralet" janë Hidrocentrali i Banjës, Hidrocentrali i Lozhan-Grabovës dhe Hidrocentrali i Skënderbegas-Cekinit.

"Rrezik Politik" është çdo veprim ose hap nga ana e një Enti Shtetëror ose një rregullatori të caktuar nga një Ent Shtetëror i cili

a) përbën një abuzim të autoritetit shtetëror ose është nga natyra ose pasoja e tij diskriminues ose ndryshe është i papajtueshëm me vendosjen e kuadrit të drejtë legjislativ ndërmjet prodhuesve kryesorë të energjisë brenda Republikës së Shqipërisë, dhe i cili

b) çon në dëmtimin thelbësor të Koncesionarit në realizimin e objektivave të kësaj Kontrateje.

"Faza Para Ndërtimit" është periudha që fillon në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe mbaron në Datën e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit.

"Detyrimet e Fazës Para Ndërtimit" janë detyrimet e Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit siç është përcaktuar përkatësisht në Nenin 3.3 dhe 3.4.

"Ndotja e Mëparshme Mjedisore" është ndotja e mjedisit e bërë nga njeriu, duke përfshirë pa kufizim groposjen e mbetjeve dhe municionet dhe armët e groposura në çdo Shesh, që është e pranishme në këtë Shesh në ose para datës në të cilën rreziku në Shesh, sipas rastit, ka kaluar nga Autoriteti Kontraktues (ose Enti tjeter përkatës Shtetëror) te Koncesionari në përputhje me Nenet 2.3 dhe 3.4.5 (pavarësisht nëse është identifikuar ose jo në Studimin Mjedisor).

"Përfundimi Paraprak" do të thotë, përsa i përket çdo Hidrocentrali, që Koncesionari ka njoftuar me shkrim Autoritetin Kontraktues se Ndërtimi i këtij Hidrocentrali është përfunduar në mënyrë të tillë që ky Hidrocentral është në gjendje të fillojë testin e funksionimit në përputhje me Nenin 7.3.8.

"Sistemi i Prokurimit" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin [ ].

"Rasti i Arritjes së Prodhimit" do të thotë rasti kur Prodhimi Elektrik Neto arrin Vëllimin e Prodhimit sipas Kontratës.

"Projekt" do të thotë projektimi, financimi, ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi i pronësisë së Hidrocentraleve tek Autoriteti Kontraktues.

"Shoqëria Koncesionare" ka kuptimin që i është dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Kontrateje.

"Kostot e Planifikuara të Investimit" do të thotë kostot e investimit të planifikuara për Shpenzimet e Fazës I (siç është përcaktuar në Shtojcën E) që arrin në vlerën 950,000,000 Euro.

“Rasti i Forcës Madhore të Tejzgjatur” do të thotë Rasti i Forcës Madhore që (i) zgjat më shumë se tetëmbëdhjetë muaj të njëpasnjëshëm që nga data e ndodhjes së saj, ose nëse bëhet e qartë para kalimit të kësaj periudhe se Rasti i Forcës Madhore do të zgjasë të paktën për këtë periudhë, 6 muaj nga data kur ajo bëhet e dukshme ose (ii) e bën realizimin e Projektit të pamundshëm ekonomikisht për Koncesionarin (madje dhe duke marrë parasysh të ardhurat nga sigurimi në përputhje me Nenin 9).

“Gëzim i qetë” do të thotë e drejta ekskluzive për të zënë, përdorur dhe gëzuar çdo Hidrocentral, Shesh dhe të Drejtat për Kalim gjatë Afatit, në përputhje me këtë Kontratë, pa ndërhyrje të parregullt nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë Ent Shtetëror.

“Operator i Arsyeshëm dhe i Kujdesshëm” do të thotë një person që vepron në mirëbesim për të përmbushur detyrimet e tij kontraktore dhe, gjatë përmbushjes së tyre dhe realizimit të përgjithshëm të zotimeve të tij këtu, duke ushtruar atë nivel aftësie, kujdesi, urtësie dhe largpamësie e cila do të pritej në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme nga një person i aftë dhe me eksperiencë ndërkombëtare i angazhuar në një lloj të njëjtë ose të ngjashëm sipërmarrjeje, në kushte ose rrethana të ngjashme, duke qenë në përputhje me Ligjin dhe Praktikën e Industrisë së Mirë dhe çdo referencë këtu për standartin e një Operatori të Arsyeshëm dhe të Kujdesshëm do të interpretohet përkatësisht.

“Rregullator” do të thotë ERE (Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike) ose ndonjë rregullator tjetër i industrisë elektrike ose departament tjetër rregullator, organ, agjenci ose autoritet i Republikës së Shqipërisë ose të ndonjë prej nënndarjeve të tyre të krijuar mbi bazën e Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë”, ose çdo akt tjetër ligjor që vesh organin e krijuar nëpërmjet këtij akti me autoritet për të miratuar tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike, për të monitoruar aktivitetet e licencuara, dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet të licencuarve, si dhe ndërmjet të licencuarve dhe konsumatorëve.

"Infrastrukturë Zëvendësuese" janë rrugët, urat dhe çdo lloj tjetër infrastrukture që do të jetë nënujë ose që do të bëhet e papërdorshme për shkak të funksionimit të Hidrocentraleve.

"Shesh Zëvendësues" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 14.9.4.

"Materialet e Nevojshme të Ndërtimit" janë rëra, copëra betoni, gure, shkëmbinj, zhavorr, lëndë druri, ujë burimi, ujë lumi dhe materiale të tjera ndërtimit që janë të nevojshme për Ndërtimin e projektit.

"NBK Minimale e Nevojshme" është një NBK Totale prej □□%.

“E Drejta për Kalim” është, në lidhje me çdo Sheshi, e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në to, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj Kontrateje.

“Rasti i Përmbytjes së Rëndë” do të thotë ngritja 120 m.m.n.d të nivelit aktual të ujit të Rezervuarit të Banjës.

“Aksionar” është personi që ka Pjesëmarrje financiare a pasurore në Shoqërinë e Projektit.

“Shesh”, për çdo Hidrocentral, është, zona ose zonat në të cilat do të vendoset çdo pjesë e këtyre Hidrocentraleve ose strukturave (duke përfshirë tunelet) që i përkasin këtij Hidrocentrali dhe në të cilat do të kryhen veprimtaritë dhe shërbimet që janë pjesë përbërëse të Ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së këtij Hidrocentrali, duke përfshirë zonat të cilat janë në mënyrë të përhershme nën ujë ose kohë pas kohe nën ujë, ose zonat që nevojiten për nxjerrjen e Materialeve të Nevojshme të Ndërtimit, bashkë me, kur Koncesionarit i kërkohet ta Ndërtojë këtë infrastrukturë në përputhje me këtë Kontratë, të drejtat mbi tokën dhe të drejtat për kalim për (i) Linjat përkatëse të Transmetimit dhe (ii) infrastrukturën e transportit, e cila kërkohet të Ndërtohet për realizimin e Projektit, duke përfshirë rrugët dhe urat.

“Kosto e Blerjes së Sheshit” do të thotë shpenzimet operative të arsyeshme (cash) (duke përfshirë kostot e arsyeshme të konsulentit ligjor ose këshilltarëve të tjerë) të bëra rregullisht nga Autoriteti Kontraktues në lidhje me shpronësimin e ndonjë pjese të Shesheve të cilat nuk janë në pronësi të Autoritetit Kontraktues, Enti tjetër Shtetëror dhe as të Republikës së Shqipërisë ose të ndonjë njesie territoriale të saj.

"Kontratat mbi Sheshet" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 3.4.5 (a).

"Dokumentacioni i Kërkesës për Sheshin" do të thotë dokumentacioni i kërkuar që ta b-ëjë Autoritetin Kontraktues të aftë për t’i vënë në dispozicion Koncesionarit parcelat e Sheshit siç kërkohet herë pas here në përputhje me fazat përkatëse të Projektit, duke përfshirë, nëse është e mundur, dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar për ndonjë procedurë shpronësimi në lidhje me parcelat e Sheshit, përfshirë dhe identifikimin e saktë të ndonjë parcele që do të shpronësohet.

"Hidrocentrali Skenderbegas-Cekini" do të thotë hidrocentrali hidroelektrik që do të Ndërtohet në ose përreth zonës së njohur si Skenderbegas-Cekini ose Bratile-Cekini në Luginën e Lumit Devoll, ashtu siç është përshkruar në Shtojcën A, në zbatim të Kërkesave Teknike Minimale, duke përfshirë por pa u kufizuar në turbinat, gjeneratorët, pajisjet ndihmëse për

ndërtesën e centralit, transformatorë, pajisjet e nënstacionit, dhe linjën e transmetimit në pikën e miratuar të lëvrimit të elektricitetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

"STATKRAFT" ka kuptimin që i është dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Kontrateje.

“Taksë” do të thotë çdo taksë, detyrim, tatim, tarifë, pagesë, taksë doganore ose tarifë e çdo lloji, e ngarkuar, e vënë, e vendosur, e kërkuar, ose mbledhur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga çdo Entitet Shtetëror sipas Ligjit, duke përfshirë çdo taksë malli dhe shërbimi, taksë shitjeje, tarifë pullash a vulash, tarifë importi, taksë mbi të ardhurat (qoftë mbi të ardhurat, dividentët, pagesat e interesit, tarifat, mbi qiratë e pajisjeve ose të tjera), taksë mbi huatë në monedhë të huaj ose transaksione këmbimi me jashtë, taksë akcize, taksë mbi pronësinë, tarifë regjistrimi ose licence.

“Eksperti Teknik dhe Ekonomik” do të thotë eksperti i caktuar bashkërisht nga Palët për qëllime pajtimi në zbatim të Nenit 13.2 (Eksperti Teknik dhe Ekonomik).

"Afat" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 10.1.

“Njoftimi për Zgjidhje” do të thotë, përsa i përket Autoritetit Kontraktues ose Koncesionarit, nëse është e mundur, një njoftim nga njëra Palë te Pala tjetër që deklaron se kjo Kontratë do të zgjidhet në përputhje me Nenin 10.2, 11.1, 11.2, 11.3 ose 11.4 ose në vijim të çdo shkaku tjetër për zgjidhje të parashikuar shprehimisht kudogjetkë në këtë Kontratë.

"Kontratat e Transmetimit" ka kuptimin që i është dhënë në Pikën (F) të Deklaratës Hyrëse.

"Linjat e Transmetimit" do të thotë objekte të reja rrjeti të tensionit të lartë që e lidhin secilin Hidrocentral me Pikën përkatëse të Lidhjes që do të ndërtohen nga dhe me kostot e Koncesionarit, ku këto linja të reja transmetimi, pas përfundimit, dhe sipas rastit pas transferimit të titullit të pronësisë te OST në përputhje me Nenin 2.5, do të jenë pjesë përbërëse të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

"Këshilli i Basenit Ujor" do të thotë Këshilli Shqiptar i Basenit Ujor.

"Pagesa e Përdorimit të Ujit" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 4.2.

"Punimet" do të thotë çdo Shesh ose përgatitje e dheut dhe punimet e Ndërtimit (në masën që është e mundur) që do të kryhen në çdo Shesh.

1.3 Interpretimi

Përveç kur konteksti i kësaj Kontrateje nuk e kërkon ndryshe:

a) fjalët në secilën gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër;

b) fjalët që përdorin numrin njëjës ose shumës përfshijnë gjithashtu respektivisht numrin shumës ose njëjës;

c) termat “të kësaj”, “këtu”, “nëpërmjet kësaj ose nga kjo”, “në këtë” dhe fjalë të ngjashme i referohen Kontratës në tërësi dhe jo ndonjë Neni, Shtojce apo ndonjë nënndarjeje tjetër të kësaj Kontrateje;

d) Deklarata Hyrëse dhe Shtojcat e kësaj Kontrateje do të përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrateje dhe referencat në Shtojcat do të jenë referenca në Shtojcat e kësaj Kontrateje, përveç kur Palët merren vesh ndryshe.

e) referencat në ndonjë akt përfshijnë çdo ndryshim ose ri-nxjerrje të atij akti, si dhe çdo rregull ose rregullore të nxjerrë në zbatim të këtij akti; dhe referencat në një ligj do të thotë referencë në një ligj të tillë, siç mund të jetë ndryshuar ose rinxjerrë a ribërë;

f) fjalët “përfshin” ose “duke përfshirë” do të konsiderohet se pasohen nga [fjalët] “pa kufizim” ose “duke mos u kufizuar në”, edhe nëse ato ndiqen ose jo nga fraza ose fjalë të të tilla të ngjashme;

g) referencat në “këtë Kontratë” ose “kjo Kontratë Koncesioni” ose çdo marrëveshje ose dokument tjetër do të interpretohen si referenca në këtë marrëveshje ose dokument, siç ndryshohet, modifikohet ose shtohet, dhe që janë në fuqi kohë pas kohe, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë, ose që është lidhur, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj;

h) sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri “ditësh” ky numër do t’i referohet ditëve kalendarike përveç kur specifikohen si Ditë Pune;

i) çdo referencë në një “muaj” ose “vit” do të interpretohet si referencë në një muaj kalendarik ose vit kalendarik;

j) çdo fjalë, term, frazë dhe shkurtim që fillon me shkronjë të madhe e përdorur specifikisht në ndonjë Shtojcë, ose Bashkëlidhje të Shtojcës, do të ketë kuptimin e përcaktuar në këtë Shtojcë ose Bashkëlidhje, sipas rastit;

k) në rast mospërputhjeje midis çdo fjale me germë të madhe, termi të përcaktuar, fraze ose shkurtimi të parashikuara në Nenin 1.1 dhe një dispozite, fjale me germë të madhe, termi, fraze ose shkurtimi parashikuar gjetkë në këtë Kontratë, Shtojcë, ose në një Bashkëlidhje tek çdo Shtojcë, kuptimi i dhënë në këtë vend do të ketë përparësi ndaj kuptimit të dhënë në Nenin 1.1, përveç kur konteksti i kësaj Kontrateje e kërkon ndryshe;

l) në rast papajtueshmërie ndërmjet Neneve të kësaj Kontrateje me Shtojcat, Palët do të përpiqen, që fillimisht të zgjidhin papajtueshmërinë nëpërmjet leximit të kësaj Kontrateje në tërësi, ndërsa do të zbatohet dispozita që e trajton në mënyrë më specifike këtë çështjeje. Nëse papajtueshmëria vazhdon të ekzistojë megjithë përpjekjet të Palëve për ta zgjidhur me mirëbesim atë siç parashikohet në fjalinë paraardhëse, për zgjidhjen e saj do të zbatohen dispozitat e Neneve të kësaj Kontrateje; dhe

m) titujt e Neneve, Kapitujve dhe të Neneve në këtë Kontratë dhe Tabela e Përmbajtjes janë bërë vetëm për qëllime lehtësimi dhe reference, dhe këto nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në interpretimin e kësaj Kontrateje.

2. TË DREJTAT KONCESIONARE

2.1 Zotimi i Përgjithshëm Detyrues dhe Bashkëpunimi

Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet dhe do të bashkëpunojnë aktivisht për të zbatuar Projektin në mënyrë sa më eficente dhe sa më parë të jetë e mundur. Autoriteti Kontraktues në veçanti do të bëjë të gjitha përpjekjet për të marrë mbështetjen e ndonjë Enti Shtetëror dhe do të kërkojë aktivisht bashkëpunimin me të, gjë që është e nevojshme për këtë qëllim.

2.2 Dhënia e të Drejtave Koncesionare

1.2.1 Që nga Data e Hyrjes në Fuqi, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit, i cili i pranon, të drejtat ekskluzive për të gjithë Afatin, në mënyrë që:

a) të projektojë, financojë, ndërtojë, kolaudojë, të vërë në punë, të ketë në pronësi, të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë Hidrocentralet;

b) në varësi të Nenit 2.2 më poshtë, të ketë Gëzim të Qetë;

c) në varësi të Nenit 2.3 më poshtë, të ketë akses dhe të përdorë ujin e Luginës së Lumit Devoll midis 810 metrave mbi nivelin e detit dhe 95 metrave mbi nivelin e detit, duke përfshirë Lumin Devoll dhe të gjithë degët e tij: megjithatë, përsa i përket degëve, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë t'u japë palëve të treta të drejta koncesionare me kusht që dhënia e këtyre të drejtave të jetë në përputhje me Nenin 2.4.2;

d) shesë dhe furnizojë Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe mbledhë dhe mbajë të ardhurat nga këto shitje, me kusht që:

i) Koncesionari të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi për prodhimin, transmetimin dhe shitjen e energjisë gjatë vazhdimësisë së këtij aktiviteti; dhe

ii) Koncesionari të plotësojë kërkesat e Autoritetit Kontraktues ose të Rregullatorit për të vepruar sipas detyrimeve të shërbimit publik siç është përcaktuar në nenin 25 të ligjit nr. 9072 datë 22 maj 2003 (Për Sektorin e Energjisë Elektrike", me kusht që Koncesionari të kompensohet nga Autoriteti Kontraktues për ndonjë rënie në të ardhura ose rritje në kosto të cilat ai mund t'i pësojë për shkak të përmbushjes së këtyre detyrimeve ose për shkak të ndonjë kufizimi tjetër ligjor të cilat ndalojnë Koncesionarin të shesë ose eksportojë ndonjë pjesë të Prodhimit Neto të Energjisë Elektrike brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë; dhe

e) t'i kthejë sërish Autoritetit Kontraktues përdorimin e Sheshit dhe të Drejtën për Kalim, dhe t'i transferojë Autoritetit pronësinë e Hidrocentraleve, me mbarimin e Afatit, si dhe, në çdo rast, t'i kryejë ato veprime, të cilat janë pazgjidhmërisht të lidhura me këto aktivitete (së

bashku, “të Drejtat Konçesionare”).

1.2.2 Kjo Kontratë Konçesioni përbën një Kontratë të tipit BOOT (Build-Own-Operate-Transfer)-(Ndërtim-Pronësim-Shfrytëzim-Transferim).

2.3 Dhënia e Shesheve

Pavarësisht nga sa parashikohet në Nenin 2.2 më sipër,

a) Sheshet, e Drejta për Kalim, Gëzimi i Qetë dhe e drejta për akses dhe për të përdorur ujin e Luginës së Lumit Devoll midis 810 metrave mbi nivelin e detit dhe 95 metrave mbi nivelin e detit, duke përfshirë Lumin Devoll dhe të gjitha degët e tij: do të konsiderohen se i jepen Konçesionarit vetëm pasi Koncesionari të pajisë Autoritetin Kontraktues me kopje autentike të çertifikatave siguruese që vërtetojnë (në një masë të arsyeshme të kënaqshme për Autoritetin Kontraktues), se Konçesionari është pajisur me policat e sigurimit, dhe garancitë e kërkuara për këtë qëllim në përputhje me nenin 9 (Sigurimi).

b) Në lidhje me dhënien e Sheshit, të Drejtës për Kalim, Gëzimit të Qetë dhe të drejtës për akses dhe për të përdorur ujin si më sipër, Koncesionari e pranon Sheshin “siç është” që nga data e një dhënieje të tillë, si dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë përgjegjës përkundrejt Konçesionarit në lidhje me gjendjen e Sheshit, me kusht që, sidoqoftë, Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës për koston e pastrimit të ndonjë Ndotjeje Mjedisore të Mëparshme për aq sa ky pastrim të kërkohet nga një ligj në fuqi ose të jetë i nevojshëm në lidhje me realizimin e Projektit, si dhe do të zhdëmtojë Koncesionarin përkundrejt ndonjë pretendimi nga palët e treta përsa i përket dëmeve të pësuara nga ata si rezultat i prezencës së Ndotjes së Mëparshme Mjedisore.

2.4 Zotimet Detyruese të Autoritetit Kontraktues

2.4.1 Në çdo kohë gjatë Afatit, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet për të garantuar aksesin e Koncesionarit në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike.

2.4.2 As Autoriteti Kontraktues dhe as ndonjë Ent tjetër Shtetëror nuk do të japin ndonjë të drejtë për të shfrytëzuar, devijuar ose lëshuar burimet e ujit në rrjedhën e sipërme të Sheshit nëse ky veprim do të sillte si pasojë (i) pakësimin e prodhimit ose vëllimit të prurjes mesatare ditore, sezonale ose vjetore të ujit të disponuar në Shesh poshtë prurjes ose vëllimit të nevojshëm për të prodhuar Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike të barabartë me Kapacitetin e Instaluar; ose (ii) ndryshe cenon shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Projektit në kundërshtim me Kontratën.

2.4.3 Në çdo kohë gjatë Afatit, Autoriteti Kontraktues do të

a) zhdëmtojë Shoqërinë Koncesionare dhe Koncesionarin nga përgjegjësitë ose kostot që lindin nga vendosja ose një rritje e Taksave e cila

i) e bën atë Taksë specifike 20% më të lartë se mesatarja e parashikuar (e parashikuar mbi bazën e GDP-së së vendeve anëtare) e asaj Takse specifike brenda Bashkimit Evropian, ose

ii) shkakton, individualisht ose në total me rritjet dhe zbritjet e akumuluara të Taksave të tjera që ishin vendosur ose që kishin lindur pas Datës së Hyrjes në Fuqi, kostot vjetore shtesë për Projektin, prej 1,500,000 Euro (një milion e pesëqind mijë Euro) ose më shumë, kur krahasohen me kostot që do të ishin pësuar nëse do të ishin aplikuar normat e Taksës që kishin qenë në fuqi që nga Data e Hyrjes në Fuqi;

Për qëllime të këtij paragrafi (a), fjala Taksa nuk do të përfshijë (x) taksat e arsyeshme, detyrime, tatime, tarifa, pagesa, taksa doganore ose tarifa të çdo lloji që paguhen në këmbim të një përfitimi të drejtpërdrejtë ekuivalent të një të drejte, shërbimi, licence ose titulli tjetër tek Koncesionari dhe (y) kontributet për sigurimin e detyrueshëm shoqëror dhe sigurimin shëndetësor.

b) sigurojë që stafi i përshtatshëm dhe i kualifikuar si duhet për Projektin të ketë mundësi të pajiset me viza, leje punësimi dhe ndonjë leje të ngjashme të kërkuar nga Ligji;

c) asistojë Koncesionarin në pajisjen e tij me miratimet dhe lejet e nevojshme për çdo lloj aksesi/lidhjeje infrastrukture siç mund të jetë e nevojshme për Projektin të tillë si rrugët, urat, shërbimet publike, elektriciteti (lidhja me rrjetin e shpërndarjes), mjetet e komunikimit duke përfshirë IT, etj. tek Koncesionari ose Shoqëria Koncesionare.

2.4.4 Pavarësisht nga Neni 2.4.3 (a) Autoriteti Kontraktues do të zhdëmtojë plotësisht dhe ruajë Bashkë-Koncesionarët të padëmtuar nëse

i) taksa e ndikimit në infrastrukturë (siç është përcaktuar në Nenin 27 të Ligjit nr. 9632

datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” me ndryshimet e tij ose ndonjë dispozitë e krahasueshme, që shton ose zëvendëson këtë ligj) ose ndonjë

ii) taksa për studimet urbanistike (siç është përcaktuar në Nenin 51 të Ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” me ndryshimet e tij, ose ndonjë dispozitë e krahasueshme, që shton ose zëvendëson këtë ligj)

që tejkalon në çdo rast 0.1 % (zero pikë një përqind) e kostos së investimit do vendoset mbi Koncesionarin në lidhje me Projektin.

2.5 Objektet e Transmetimit

2.5.1 Koncesionari do të jetë përgjegjës për Ndërtimin e Linjave të Transmetimit me shpenzimet e tij.

2.5.2 Çdo Pikë e Lidhjes së Linjave të Transmetimit me Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike do të vendoset në pikën më të përshtatshme për lidhjen e këtyre Linjave të Transmetimit me Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike, siç është rënë dakord me OST.

2.6 Hidrocentrali i Banjës

2.6.1 Koncesionari do të ketë të drejtë të përdorë, ndryshojë, heqë dhe rindërtojë digën ekzistuese të Hidrocentralit të Banjës nëse këto ndryshime do të jenë të nevojshme për realizimin e Projektit.

2.6.2 Para fillimit të Ndërtimit të Hidrocentralit të Banjës, Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër të gjitha rreziqet që shkaktohen nga dëmtimi, shkatërrimi ose ndonjë mosfunksionim tjetër i Hidrocentralit të Banjës dhe do të zhdëmtojë dhe rimbursojë plotësisht Koncesionarin, për pretendimet, ose kostot që lindin nga këto pretendime, të ngritura nga palët e treta lidhur me këtë çështje. Në këtë rast, Koncesionari mund, por nuk është i detyruar, të vazhdojë fillimin e Ndërtimit të Hidrocentralit të Banjës me Ndërtimin e një dige të re në Banjë.

2.6.3 Gjatë Ndërtimit të Hidrocentralit të Banjës, Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër të gjitha rreziqet që shkaktohen nga dëmtimi, shkatërrimi ose ndonjë mosfunksionim tjetër i shkaktuar nga Rasti i Përmbytjes së Rëndë. Në këtë rast të Përmbytjes së Rëndë, çdo përgjegjësi e Koncesionarit që lind nga pretendimet e bëra nga palët e treta kundrejt tij do të zhdëmtohet plotësisht nga Autoriteti Kontraktues përveç dhe në masën e shkaktuar nga neglizhenca e Koncesionarit.

2.6.4 Që nga Përfundimi Paraprak i Hidrocentralit të Banjës deri në përfundim të Afatit, Koncesionari do të marrë përsipër të gjitha rreziqet që rezultojnë nga dëmtimi, shkatërrimi ose ndonjë mosfunksionim tjetër i Hidrocentralit të Banjës.

2.6.5 Pronësia e digës ekzistuese të Banjës do të transferohet te Koncesionari pas Përfundimit Paraprak të Hidrocentralit të Banjës.

2.6.6 Koncesionari do të ndërtojë dhe përfundojë, me shpenzimet e tij dhe në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë, (a) një pajisje mbrojtëse bllokuese lidhur me shkarkimin e poshtëm të digës ekzistuese të Banjës (“Pajisje Mbrojtëse Bllokuese e Shkarkimit të Poshtëm”) dhe (b) një pajisje mbrojtëse bllokuese lidhur pjesërisht me tunelin ekzistues të prurjes së digës ekzistuese të Banjës (“Pajisje Mbrojtëse Bllokuese e Tunelit të Prurjes” dhe së bashku me Pajisjen Mbrojtëse Bllokuese të Shkarkimit të Poshtëm, “Pajisjet Mbrojtëse Bllokuese”). Koncesionari do të fillojë me shqyrtimet, planifikimet dhe projektimet e nevojshme të Pajisjeve Mbrojtëse Bllokuese sa më shpejt dhe praktikisht të jetë e mundur pas Datës së Hyrjes në Fuqi dhe të bëjë kërkesat e duhura për të gjitha Autorizimet e kërkuara për ndërtimin e Pajisjeve Mbrojtëse Bllokuese. Autoriteti Kontraktues do të mbështesë Koncesionarin dhe bëjë të gjitha përpjekjet për të garantuar marrjen në kohë të këtyre Autorizimeve. Ndërtimi i Pajisjeve Mbrojtëse Bllokuese do të përfundohet brenda tetë muajve pas 31 Marsit që vjen menjëherë pas datës në të cilën Koncesionari ka marrë të gjitha Autorizimet e kërkuara për ndërtimin e Pajisjeve Mbrojtëse Bllokuese, me kusht që niveli i ujit në Lumin Devoll të mos ndalojë punimet e ndërtimit përsa i përket Pajisjes Mbrojtëse Bllokuese të Shkarkimit të Poshtëm. Palët pranojnë se gjatë projektimit dhe ndërtimit të Pajisjeve Mbrojtëse Bllokuese uji i lumit Devoll do të bllokohet përkohësisht në mënyrë të tillë që uji të mos kaloj nëpërmjet digës së Banjës.

Në rast se kjo Kontratë zgjidhet për çfarëdolloj arsye, përveç pakujdesisë së Koncesionarit para përfundimit të Ndërtimit të Pajisjeve Mbrojtëse Bllokuese Autoriteti Kontraktues do të rimbursojë Koncesionarin për çdo dhe të gjitha kostot e bëra në mënyrë të

arsyeshme në lidhje me projektimin dhe ndërtimin e Pajisjeve Mbrojtëse Bllokuese. Për të shmangur çdo keqinterpretim, ky nen nuk kufizon zbatueshmërinë e Nenit 2.6.2.

2.7 Krijimi i Zonave të Sigurisë

Autoriteti Kontraktues do të përfshijë një dispozitë në ligjin ratifikues të kësaj Kontrate e cila nuk do të lejojë që asnjë Ent Shtetëror të lëshojë leje ndërtimi përsa i përket zonave të sigurisë për ato sipërfaqe të cilat mund të përmbyten në situatat me nivel të lartë të ujit. Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet për të krijuar këto zona sigurie ashtu siç do t'i propozohet nga Koncesionari. Nëse këto zona sigurie do të krijohen me kërkesë të Koncesionarit, Koncesionari do të përballojë kostot e shoqëruara me to.

3 DETYRIMET (FAZA PARA NDËRTIMIT)

3.1 Njësia e Zbatimit të Projektit

3.1.1 Brenda një muaji nga Data e Hyrjes në Fuqi, Palët do të krijojnë Njësinë e Zbatimit të Projektit ("NJZP") për Fazën Para Ndërtimit e cila do të përbëhet nga katër anëtarë që do të caktohen si më poshtë:

a) dy anëtarë, funksionarë të lartë të shtetit të caktuar nga METE; dhe

b) dy anëtarë, përfaqësues të rangut të lartë të Koncesionarit.

Çdo anëtar i NJZP ka të drejtë të ftojë persona të tjera për të marrë pjesë në takimet e NJZP, kur ata e shikojnë të arsyeshme. Palët mund ta zgjasin afatin e NJZP edhe pas fillimit të Fazës së Ndërtimit.

3.1.2 NJZP do të mbikëqyrë dhe koordinojë aktivisht përmbushjen nga Palët të detyrimeve të tyre respektive të Fazës Para Ndërtimit, me synimin e përshpejtimit për aq sa është praktikisht e arsyeshme, të fillimit të Ndërtimit. Në veçanti ajo do të shqyrtojë çdo propozim për zgjatje të afateve dhe për ndryshime të Projektit, si dhe çdo çështje tjetër të cilën ajo dëshiron ta marrë në shqyrtim në lidhje me Projektin, ose që i referohet asaj nga secila prej Palëve.

3.1.3 NJZP mund t'u japë Palëve, sa herë ta konsiderojë të nevojshme rekomandime dhe njoftime. Mëgjithatë, NJZP nuk ka autoritet për të ndryshuar kushtet e kësaj Kontrate ose për t'i hequr Palëve ndonjë të drejtë sipas saj.

3.1.4 NJZP do të mblidhet në Tiranë sa herë të jetë e nevojshme, por të paktën një herë në dy muaj. Ajo nuk do të jetë e detyruar të zbatojë rregulla proceduriale të caktuara.

3.2 Zotimet e Përgjithshme Detyruese

3.2.1 Palët do të mbështesin dhe bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në mënyrë që të përmbushin sa më shpejt që të jetë e mundur të gjitha Detyrimet e Fazës Para Ndërtimit. Pavarësisht ndonjë afati ose kuadri kohor të përcaktuar në këtë Kontratë, Palët, kurdoherë që të jetë e mundur, do t'i kryejnë paralelisht veprimet dhe punimet e tyre.

3.2.2 Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të përfunduar çdo Detyrim të Fazës Para Ndërtimit sa më shpejt që të jetë e mundur. Palët pranojnë dhe bien dakord se procesi dhe kuadri kohor për përmbushjen nga palët të zotimeve të përcaktuara në nenet 2.6.6, 3.3 dhe 3.4 nuk mund të specifikohen me saktësi përsa i përket datës të parashikuar në to, ndërmjet të tjerave, për shkak të mbivendosjeve të ndryshme ndërmjet këtyre proceseve (duke përfshirë pasojat që mund të ketë zgjatja e ndonjë prej këtyre proceseve, të parashikuar ose jo në Ligj, tek ndonjë proces tjetër) dhe, për këtë arsye, (x) përmbushja e detyrimit nga Palët për të filluar dhe përfunduar çdo proces të tillë, do të përcaktohet gjithmonë në bazë të rrethanave të veçanta, prandaj vonesa nga njëra Palë nuk do të çojë në zgjidhjen e kësaj Kontrate nëse kjo vonesë duket u justifikueshme duke pasur parasysh rrethanat dhe (y) në rast vonese të ndonjë procesi të tillë, që nuk i atribuohet neglizhencës së Koncesionarit dhe që sjell si pasojë vonesë në fillimin ose zbatimin e Fazës së Ndërtimit, të gjitha datat e planifikuara lidhur me ndërtimin sipas kësaj Kontrate do të konsiderohen automatikisht të zgjatura sa edhe kohëzgjatja e kësaj vonese.

3.3 Detyrimet e Fazës Para Ndërtimit Nën Përgjegjësinë e Koncesionarit

3.3.1 Brenda 12 muajsh pas Datës së Hyrjes në Fuqi, Koncesionari do të sigurojë ose kujdeset të dërgojë tek Autoriteti Kontraktues një konfirmim me shkrim kryesisht në formën e specifikuar në Shtojcën H (Forma e Njoftimit të Mbylljes Financiare) që është bërë Mbyllja Financiare.

3.3.2 Jo më vonë se 5 muaj pas Datës së Hyrjes në Fuqi, Koncesionari do të fillojë procedurën për t'u pajisur me pronësinë mbi parcelat e kërkuara të sheshit duke paraqitur

Dokumentacionin e Kërkesës për Sheshin.

3.3.3 Brenda 3 muajsh pasi Koncesionari të ketë marrë Lejet e për Zhvillimin e Punimeve, Koncesionari do të fillojë procedurat për t'i siguruar Autoritetit Kontraktues dërgimin në kohë të një raporti mjedisor, social, shëndetësor dhe për sigurinë.

3.3.4 Brenda 24 muajsh pasi Koncesionari të ketë marrë Lejet e për Zhvillimin e Punimeve, Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues Projektin e Detajuar.

3.3.5 Koncesionari jo më vonë se 1 muaj para finalizimit të punimeve përgatitore të Ndërtimit siç është përcaktuar në nenin 3.3.6 do t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues kopje autentike të çertifikatave siguruese që vërtetojnë (në mënyrë të arsyeshme të pranueshme për Autoritetin Kontraktues) se Koncesionari është pajisur me të gjitha policat e sigurimit dhe garancitë mbuluese për t'u marrë prej tij për të gjitha qëllimet e Fazës së Ndërtimit në përputhje me Nenin 9.

3.3.6 Brenda 18 muajsh pasi Koncesionari të jetë pajisur me të gjitha Autorizimet e kërkuara për qëllimet e Fazës së Ndërtimit, Koncesionari do të finalizojë punimet përgatitore të Ndërtimit të tilla si në veçanti tenderin e Koncesionarit për Punimet kryesore të Ndërtimit dhe lidhjen e kontratave civile kryesore për Ndërtimin, finalizim për të cilin Koncesionari do të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues.

3.4 Detyrimet e Fazës Para Ndërtimit Nën Përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues

3.4.1 Brenda maksimumi (i) 2 muaj pas Datës së Hyrjes në Fuqi dhe (ii) 1 muaj pasi Autoritetit Kontraktues t'i jetë dërguar një kërkesë për të dhëna publike, Autoriteti Kontraktues do t'i sigurojë Koncesionarit pa pagesë (përveç ndonjë kostoje reale dhe të arsyeshme të bërë, nëse ka) të gjitha të Dhënave Publike, por nuk do të jetë përgjegjës për saktësinë e tyre.

3.4.2 Brenda 1 muaji pas paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktues do të japë, ose kujdeset që çdo Ent Shtetëror përkatës t'i japë Koncesionarit Lejet për Zhvillimin e Punimeve në mënyrë që t'i bëjë të mundur Koncesionarit të identifikojë dhe shqyrtojë Sheshet si dhe të vazhdojë me zhvillimin e Projektit.

3.4.3 Brenda 6 muajsh pas paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktues do të japë, ose kujdeset që çdo Ent Shtetëror përkatës të japë, të gjitha Autorizimet e kërkuara për qëllimet e Fazës së Ndërtimit, me kusht që Koncesionari të ketë paraqitur në kohë kërkesat e plota dhe dokumentacionin e nevojshëm shoqërues për çdo Autorizim, duke përfshirë përgatitjen dhe paraqitjen e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

3.4.4 Nëse Materialet e Nevojshme të Ndërtimit (përfshirë materialet e shtratit të lumit Devoll) gjenden në Shesh ose në tokën në afërsi të Sheshit që është në pronësi të Autoriteti Kontraktues, një Enti tjetër Shtetëror, ose Republikës së Shqipërisë para Datës së Fillimit të Punimeve të Ndërtimit, Autoriteti Kontraktues do të kujdeset që, në varësi të dhënies së ndonjë Autorizimi të nevojshëm, Koncesionari të ketë të drejtë, të heqë ose përdorë në Projekt, pa pagesë, këto Materiale të Nevojshme Ndërtimit dhe të ruajë ndonjë mbetje dhe materiale të gërmuara, si në Shesh ashtu edhe jashtë tij në këtë tokë.

3.4.5 Brenda 6 muajsh pas marrjes nga Autoriteti Kontraktues të Dokumentacionit të Kërkesës për Sheshin përsa i përket parcelave respektive të Sheshit, Autoriteti Kontraktues, pa pagesë (objekt i nenit 3.4.6), do t'i vërë Koncesionarit në disponim Sheshet dhe do t'i japë atij mbi të gjitha pjesët e Sheshit, uzufruktin ose të drejtat përkatëse të ngjashme reale të pronësisë, të drejta të nevojshme për realizimin e Projektit (psh, të drejta ndërtimi, qira afatgjata ose, sipas rastit të drejta përdorimi ose të drejta kalimi). Këto të drejta reale të pronësisë, përsa i përket Shesheve:

a) do të evidentohen në kontrata të shkruara ndërmjet Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues (ose Enti tjetër përkatës Shtetëror) me kushte që janë në përputhje me këtë Kontratë dhe të pranueshme në mënyrë të arsyeshme nga të dyja palët (Kontratat për Sheshet);

b) do të kenë një afat që nuk është më i shkurtër se ai i kësaj Kontrate dhe do të zgjatet automatikisht në rast se zgjatet Afati Fillestar në përputhje me këtë Kontratë, me kusht që, nëse Ligji i Zbatueshëm e kufizon afatin maksimal të një Kontrate Sheshi, kjo Kontratë Sheshi, pas mbarimit të kohëzgjatjes së saj, do të zgjatet, ripërtërihet ose zëvendësohet me një Kontratë të re Sheshi, të tillë që Koncesionari të ketë në çdo kohë deri në përfundim të Afatit, të drejtat përkatëse reale mbi Sheshin.

c) do të jenë të lira nga ndonjë barrë ose interesa të tjerë dëmtues dhe nuk do të ketë

asnjë pengesë që mbi to të vendoset hipotekë, një detyrim ose ndryshe të transferohen për llogari të Huadhënësve si garanci për detyrimin parësor që do të pretendohet nga Koncesionari për qëllime të financimit të Projektit.

3.4.6 Nëse i kërkohet për përmbushjen e detyrimeve sipas Nenit 3.4.5, Autoritetit Kontraktues do të miratojë shpronësimin e ndonjë parcele të Sheshit i cili mund të konsiderohet i nevojshëm nga Koncesionari (dhe që është rënë dakord me Autoritetin Kontraktues) dhe do të kryejë procesin përkatës të shpronësimit në mënyrën më eficente të mundshme dhe me koston më të ulët të arritshme në përputhje me Ligjin dhe siç parashikohet në Shtojcën (e cila nuk është detyruese dhe shërben vetëm për qëllime informuese, si dhe pa cenuar zbatimin e kërkesave të Ligjit), ku sipas të cilës

a) të gjitha Kostot e Blerjes së Sheshit do të përballohen nga Koncesionari;

b) në rast se Autoriteti Kontraktues, pas paraqitjes së një kërkese për shpronësim nga Koncesionari nuk arrin ta miratojë atë në përputhje me këtë Nen ose të ndjekë procedurat përkatëse në përputhje me Ligjin, Koncesionari do të ketë të drejtë (x) t'i japë Autoritetit Kontraktues një Njoftim për Zgjidhje dhe (y) të marrë kompensim nga Autoriteti Kontraktues në një shumë të barabartë me shpenzimet e arsyeshme dhe të justifikueshme të bëra nga Koncesionari në lidhje me ofertën e tij për Projektin dhe për zbatimin e Marrëveshjes së Koncesionit deri në datën e hyrjes në fuqi të Njoftimit për Zgjidhje (por ky kompensim nuk do të përfshijë ndonjë element të fitimit të munguar, të dëmeve të tërthorta ose të humbjeve të rezultuara); për të shmangur çdo keqinterpretim, Koncesionari nuk do të marrë ndonjë kompensim nga Autoriteti Kontraktues në rast vonese në procesin e shpronësimit;

c) për të shmangur çdo keqinterpretim, (x) çdo parcelë e Sheshit që është shpronësuar në përputhje me sa më sipër do të konsiderohet se është e inkorporuar në këtë Shesh (duke e përfshirë edhe për qëllime të Gëzimit të Qetë) që nga data e përfundimit të këtij shpronësimi, (y) data e paraqitur si datë e kërkesës nga Koncesionarit do të jetë data në të cilën Koncesionari ka paraqitur rregullisht të gjitha dokumentet e nevojshme për shpronësimin (siç kërkohet nga Ligji), dhe (z) Autoriteti Kontraktues ose Enti Shtetëror Përkatës do të marrë vendim lidhur me shpronësimin brenda kuadrit kohor të parashikuar në përputhje me Ligjin.

d) Autoriteti Kontraktues do të jetë plotësisht përgjegjës për shpërnguljen e çdo personi dhe zhvendosjen e pronës nga çdo tokë e shpronësuar në përputhje me këtë Nen 3.4.6.

3.5 Rritja e Kostos

3.5.1 Nëse, në çdo kohë brenda 18 muajsh pasi Koncesionarit t'i jenë dhënë Lejet për Zhvillimin e Punimeve, kostot totale të investimit për të gjitha Hidrocentralet siç është parashikuar në mënyrë të arsyeshme në një moment të tillë kohor, do të jenë rritur me më shumë se 30 % nëse krahasohen me shumën nominale të Kostove të Parashikuara të Investimit, Koncesionari mund të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues ("Njoftimi për Rritjen e Kostove").

3.5.2 Çdo Njoftim për Rritjen e Kostove do të shoqërohet nga një propozim i Koncesionarit lidhur me atë se si mund të ndryshohen shifrat e Projektit në mënyrë që Koncesionari të vihet në një pozitë të ngjashme me atë që do të kishte qenë, nëse kostot e investimit nuk do të ishin rritur me më shumë se 30 %.

3.5.3 Brenda 15 ditësh pas marrjes nga Autoriteti Kontraktues të një Njoftimi për Rritjen e Kostove, Palët do të takohen për të negociuar se çfarë ndryshimesh, nëse është e mundur, duhet t'u bëhen shifrave të Projektit në mënyrë që Koncesionari të vihet në një pozitë të ngjashme me atë që do të kishte qenë, nëse kostot e investimit nuk do të ishin rritur me më shumë se 30 %.

3.5.4 Në rast se Palët, duke vepruar në mirëbesim, nuk janë të afta të arrijnë një marrëveshje në negociatat e parashikuara në Nenin 3.5.3 më sipër, gjatë një periudheje prej 90 ditësh, Koncesionari do të ketë të drejtë ta zgjidhë këtë Kontratë në përputhje me Nenin 11.1 nëpërmjet njoftimit me shkrim me pasojë të menjëhershme, dhe asnjëra nga Palët nuk do të ketë ndonjë detyrim të mëtejshëm sipas Kontratës.

3.6 Fillimi i Fazës së Ndërtimit

Fillim i Fazës së Ndërtimit do të konsiderohet data në të cilën do të jetë përmbushur (ose është hequr dorë prej tyre nga Autoriteti Kontraktues në masën që lejohet nga Ligji) secili nga detyrimet e parashikuara në Nenet 3.3 dhe 3.4 ("Data e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit").

Koncesionari do të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues për këtë datë. 4. PAGESAT, RAPORTIMI & REVIZIONIMI

4.1 Pagesa e Koncesionit, Përllogaritja dhe Shlyerja e Pagesës së Koncesionit

4.1.1 Pas të jetë lëshuar Çertifikata e Përfundimit Final përsa i përket një Hidrocentrali, Koncesionari, pasi të vendoset nga Autoriteti Kontraktues, ose:

a) do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues një shumë të barabartë me Përqindjen e Pagesës së Koncesionit të (i) Të ardhurave Neto nga Shitjet e Energjisë, përsa i përket këtij Hidrocentrali dhe (ii) të ardhurat neto (për të arritur këto të ardhura janë bërë kosto më të ulëta) të marra nga Shoqëria Koncesionare nga shitja e çertifikatave të ripërtëritjes së energjisë ose produkteve të ngjashme, nëse ka: ose

b) në varësi të Nenit 4.1.6, t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues (ose një Enti tjetër Shtetëror të caktuar nga Autoriteti Kontraktues) Përqindjen e Pagesës së Koncesionit të (i) Prodhimit Elektrik Neto të këtij Hidrocentrali dhe (ii) çertifikatat e ripërtëritjes së energjisë ose produktet e ngjashme, nëse ka,

dhe shuma e paguar, ose Energjia Elektrike e transmetuar, tek Autoriteti Kontraktues në përputhje me Nenin 4.1 do të përbëjë Pagesën e Koncesionit.

4.1.2 Pagesa e Koncesionit do të përfaqësojë shpërblimin e vetëm në para të Autoritetit Kontraktues përsa i përket koncesionit dhe të drejtave të lidhura me të që i janë dhënë Koncesionarit sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë sigurimin e Sheshit dhe Autorizimeve, përveç se në masën që nuk është parashikuar shprehimisht ndryshe në këtë Kontratë.

4.1.3 Para ose në 1 mars të çdo viti kalendarik pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit Final përsa i përket Hidrocentralit të parë të përfunduar, Koncesionari do t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues të gjithë informacionin, së bashku me përligjien e arsyeshme, të nevojshme për qëllime të përllogaritjes së Pagesës së Koncesionit, përsa i përket vitit paraardhës kalendarik.

4.1.4 Autoriteti Kontraktues do ta bëjë menjëherë përllogaritjet e shumës së Pagesës së Koncesionit dhe do t'i paraqesë Koncesionarit një faturë/kërkesë për pagesë lidhur me të.

4.1.5 Koncesionari do të paguajë shumën e padiskutueshme të një fature/kërkese të tillë për pagesë brenda 90 ditësh nga marrja e saj.

4.1.6 Nëse Autoriteti Kontraktues vendos që të marrë Pagesën e Koncesionit në formën e energjisë elektrike në përputhje me Nenin 4.1.1 (b), Palët së pari do të bien dakord mbi kushtet e arsyeshme lidhur me mekanizmat e transmetimit të kësaj energjie elektrike te Autoriteti Kontraktues (ose Ent tjetër Shtetëror, sipas rastit).

4.2 Pagesa e Përdorimit të Ujit

Pagesa e përdorimit të ujit, në masën dhe për aq sa është në fuqi në përputhje me Ligjin e zbatueshëm shqiptar ("Pagesa e Përdorimit të Ujit"), është përfshirë në Pagesën e Koncesionit dhe do të quhet e paguar me bërjen e Pagesës së Koncesionit në përputhje me Nenin 4.1. Çdo rritje ose rivendosje e mëvonshme e Pagesës së Përdorimit të Ujit nuk do t'i japë të drejtë Autoritetit Kontraktues për një rritje korresponduese të shumës së Pagesës së Koncesionit.

4.3 Raporti Financiar dhe Revizionimi

4.3.1 Jo më pak se një herë në vit gjatë Afatit, në të njëjtën datë me Datën e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit, Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues Raportin e tij Financiar të revizionuar.

4.3.2 Raporti i revizionuar Financiar do të përmbajë minimalisht informacionin dhe të dhënat financiare të nevojshme për të llogaritur Totalin e NBK siç është parashikuar në Shtojcën E dhe Pagesën e Koncesionit.

4.3.3 Autoriteti Kontraktues me shpenzimet e tij do të ketë të drejtë pas njoftimit të arsyeshëm për të revizionuar veçmas Raportin e revizionuar Financiar nëpërmjet ekonomistëve të kualifikuar me reputacion ndërkombëtar në mënyrë që të verifikojë informacionin dhe të dhënat e përmbajtura në Raportin Financiar. Koncesionari do t'u japë këtyre ekonomistëve asistencën dhe lehtësitë e arsyeshme.

5. SHOQËRIA KONCESIONARE, KONTROLLI DHE INVESTIMET MINIMALE TË AKSIONARËVE

5.1 Kontrolli

Brenda Afatit, Aksionarët Kryesorë do të Kontrollojnë së bashku Shoqërinë

Koncesionare, me kusht që, gjithsesi, (i) çdo Aksionar (duke përfshirë edhe Aksionarët Kryesorë) do të ketë të drejtë të transferojë lirisht, aksionet e Shoqërisë Koncesionare te një Aksioner tjetër ose te ndonjë prej Filialeve të tij në çdo kohë gjatë Afatit, në qoftë se një transfertë e tillë nuk do të çojë në transferimin e Kontrollit nga Aksionarët Kryesorë, si dhe (ii) çdo transfertë tjetër, (duke përfshirë transferimin e Kontrollit) do të jetë objekt i miratimit paraprak të Autoritetit Kontraktues, miratim i cili nuk do të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme, me kusht që, më tej, në lidhje me ndonjë transferim të propozuar (duke përfshirë transferimin e Kontrollit), Autoriteti Kontraktues do t'i kushtojë konsideratën e duhur eksperiencës, gjendjes financiare (e cila do të përfshijë mbështetjen kredituese nga palë të treta), stabilitetit dhe reputacionin e përfituesit të transferimit të propozuar.

5.2 Investimi Minimal i Pjesëmarrjes së Aksionarëve

Aksionarët Kryesorë do të kujdesen që Pjesëmarrja e Aksionarëve e paguar plotësisht në Shoqërinë Koncesionare të jetë dhe të mbetet të paktën njëzetë përqind (20%) e shumës së shpenzimeve kryesore të kërkuara nga Koncesionari në lidhje me zbatimin e Punimeve të Ndërtimit në periudhat respektive kur këto shpenzime kryesore do të bëhen nga Shoqëria Koncesionare.

5.3 Shoqëria Koncesionare – Detyrimet e Aksionarëve Kryesorë

Secili nga Aksionarët Kryesorë merr përsipër se:

a) ai do të ruajë ekzistencën e Shoqërisë Koncesionare si një shoqëri aksionare në përputhje me Ligjin, dhe

b) pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues, Shoqëria Koncesionare nuk do të angazhohet në asnjë biznes tjetër përveç Projektit.

5.4 Roli i Shoqërisë Koncesionare

5.4.1 Bashkë-Koncesionarët do të Ndërtojnë dhe shfrytëzojnë Hidrocentralet nëpërmjet Shoqërisë Koncesionare. Shoqëria Koncesionare do t'i ketë në pronësi Hidrocentralet dhe të gjitha aestet që janë pjesë përbërëse e tyre dhe do të marrë përsipër të gjitha detyrimet në lidhje me këtë Ndërtim dhe shfrytëzim të Hidrocentraleve përveçse nëse ligji ose dobia e realizimit të Projektit e kërkon ndryshe.

5.4.2 Shoqëria Koncesionare nuk do të shesë, vendosë detyrime ose ndonjë barrë apo ndryshe transferojë, dhe Aksionarët Kryesorë do të kujdesen për këtë, interesin e saj dobiprurës te Hidrocentralet dhe te të gjitha asetet që janë pjesë përbërëse e tyre përveç se te ndonjë Palë Financuese në përputhje me Dokumentet Financiare.

6. AUTORIZIMET

6.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet për të bërë të mundur që Entet kompetente Shtetërore të japin ose ripërtërijnë të gjitha Autorizimet, duke përfshirë ato Autorizime të specifikuara në Shtojcën C (Lista e Autorizimeve të nevojshme për Ndërtimin e një Hidrocentrali), të nevojshme për qëllimet e Projektit, me kusht që Koncesionari të ketë paraqitur në kohë kërkesat e plota dhe dokumentacionin e nevojshëm shoqërues për të gjitha Autorizimet.

6.2 Me kërkesë të Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues do të asistojë Koncesionarin ose Filialet e tij lidhur me këtë Projekt në pajisjen dhe ripërtëritjen e çdo dhe të gjitha Autorizimeve, me kusht që Koncesionari:

a) të ketë bërë të gjitha veprimet e arsyeshme për të si Koncesionar, dhe që vepron si një Operator i Arsyeshëm dhe i Kujdesshëm, dhe që janë të nevojshme për të mbajtur këto Autorizime;

b) të vazhdojë në mënyrë të zellshme mbajtjen e çdo Autorizimi;

c) në të njëjtën kohë që ai i paraqet Autoritetit Kontraktues kërkesën e tij, t'i japë Autoritetit Kontraktues detaje të plota për hapat e ndërmarra nga Koncesionari, para datës së kërkesës me shkrim, për të mbajtur Autorizimin(et) dhe për hapat që ai vazhdon të ndërmarrë përsa i përket mbajtjes së këtij(yre) Autorizimi(eve); dhe

d) t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues asistencën dhe Informacionin i cili mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

7. NDËRTIMI I HIDROCENTRALEVE

7.1 Projekti

Projekti i Detajuar do të përgatitet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Shtojcën A, në mënyrë që çdo Hidrocentral të jetë plotësisht në përputhje me Kërkesat Teknike Minimale. Koncesionari do ta ndërtojë çdo Hidrocentral Hidro Energjetik në përputhje thelbësore me Projektin e Detajuar përsa i përket çdo Hidrocentrali si dhe në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë.

7.2 Ndërtimi

7.2.1 Koncesionari do të fillojë Ndërtimin e Hidrocentraleve në Datën e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit dhe do ta përfundojë në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë.

7.2.2 Koncesionari do të fillojë ndërtimin e Hidrocentralet në Datën e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit dhe do ti përfundojë ato në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë.

7.2.3 Koncesionari do ti ndërtojë Hidrocentralet duke arritur Përfundimim Paraprak të tyre jo më vonë se Data e Parashikuar e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit ("Përfundimi i Synuar"), me kusht që Koncesionari të ndërtojë Hidrocentralin e Banjës jo më vonë se në datën që përkon me 36 muaj pas datës së Fillimit të Punimeve të Ndërtimit, e cila përfaqëson një Datë Grafiku. Në rast se struktura ekzistuese e digës së Banjës është e papërdorshme për ndërtimin e Hidrocentralit të Banjës, dmth pjesë thelbësore të saj ose tërësia e saj duhet të hiqen dhe/ose të rindërtohen (sipas Nenit 2.6.1), Afati i Perfundimit do të shtyhet për periudhën kohore të nevojshme për të ndrequr këto rrethana.

Nëqoftëse Përfundimi Paraprak i Hidrocentraleve (jo Hidrocentrali i Banjës) arrihet përpara Afatit të Grafikut, Koncesionarit, në bazë të Nenit 7.2.3 për cdo ditë përfundimi para afatit do të përftojë kreditë e mëposhtme:

Nëqoftëse Dëmet e Likujdueshme janë paguar ose janë maturuar për tu paguar sipas Nenit 7.2.4 për shkak se Koncesionari nuk ka arritur përfundimin e ndërtimit të Hidrocentralit të Banjës brenda 36 muajve nga Data e Fillimit të Punimeve Ndërtimore, Autoriteti Kontraktues do të bëjë rimbursimin e menjëhershëm të shumave përkatëse të Dëmeve të Likujdueshme për ditët e kredituara sipas paragrafit të mësipërm.

7.2.4 Me përjashtim të rasteve për të cilat zbatohen Nenet 10.2 ose 10.3, nëqoftëse Koncesionari nuk arrin Afatin e Synuar, Koncesionari do ti paguajë Autoritetit Kontraktues Dëmet e Likujdueshme në përputhje me Nenin 7.3.11 për cdo ditë vonese përtej Datës së Parashikuar të Përfundimit Paraprak të Punimeve Ndërtimore.

7.2.5 Koncesionari do të paguajë çdo Dëm të Likujdueshëm përsa i përket çdo muaji kalendarik, brenda shtatë ditëve nga fillimi i muajit pasardhës kalendarik. Në rast se Koncesionari nuk arrin të paguajë këtë Dëm të Likujdueshëm brenda tre (3) muajve nga data në të cilën duhej bërë pagesa, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtën të tërheqë shumat përkatëse nga Garancia e Kontratës. Shumë totale e Dëmeve të Likujdueshme do të kufizohet në cdo rast në shumën që ka në gjendje kohë pas kohe Garancia e Kontratës.

7.2.6 Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues si kompensim për infrastrukturën që do të jetë nën ujë ose që do të bëhet e papërdorshme në cdo mënyrë tjetër, si rrjedhojë e shfrytëzimit të Hidrocentraleve, sa më poshtë:

i) shumën 10.500 Euro (dhjetëmijepesëqind) , sipas Shtojcës I, të përgatitur nga Koncesionari, për rrugët dhe urat e mbuluara me ujë, sipas inventarit dhe vlerave të listuara në të. Autoriteti Kontraktues mund ta marrë këtë kompensim për pjesën përkitëse kur Autoriteti Kontraktues të fillojë ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese në lidhje me secilin Hidrocentral.

ii) një shumë për të cilën do të bihet dakord në mirëbesim nga Palët për çdo infrastrukturë shtesë që mund të mbulohet nga uji por që nuk është parashikuar në Shtojcën [ ]; nëse ose për sa Palët nuk arrijnë të bien dakord për natyrën e kësaj infrastrukture shtesë ose kostove përkatëse brenda 60 ditësh, çështja përkatëse ose opinionet e ndryshme do t'i referohen Ekspertit Teknik dhe Ekonomik, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar dhe detyrues.

iii) Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të shqyrtojë inventarin dhe shumën e përmendur në pikën (i) jo më vonë se 6 muaj pas Datës Efektive; nëqoftëse Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit cmon se shuma aktuale është jo më shumë se 20 per qind mbi ose nën shumën e përcaktuar në pikën (i), shuma që do të japë Autoriteti Kontraktues do të jetë shuma përfundimtare; nëqoftëse Autoriteti Kontraktues cmon se shuma aktuala pas shqyrtimit është 20 për qind mbi ose nën shumën e përcaktuar sipas pikës (i) më sipër, Autoriteti Kontraktues ka të

drejtë tja kalojë cështjen Ekspertit Tekniko Ekonomik, vendimi i të cilit është i formës së prerë dhe detyrues.

Asnjë nga sa thuhet më sipër nuk përbën detyrim të Koncesionarit për të kompensuar si Autoritetin Kontraktues ashtu edhe ndonjë pronar privat për të njëjtin objekt të infrastrukturës.

Autoriteti Kontraktues do të jetë tërësisht përgjegjës, me shpenzimet e tij, për ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, me kusht që shumat ashtu siç janë parashtruar në paragrafin paraardhës të paguhen nga Koncesionari në kohën e duhur. Infrastruktura Zëvendësuese duhet të vendoset jo më vonë se tre muaj para Datës së realizimit të Mbushjes me Ujë të Ujëmbledhësit; me kusht që gjithsesi, Infrastruktura Zëvendësuese (i) me të cilën do të lidhen Rrugët Hyrëse dhe (ii) që i nevojitet Koncesionarit për t'u përdorur për tu futur në Shesh (a) përsa i përket gjerësisë, rrezes minimale të kthesave, pjerrësisë dhe kapacitetit të ngarkesës, të jetë e një cilësie jo më të ulët se cilësia e infrastrukturës që do të zëvendësohet në përputhje me këtë Nen 7.2.5, dhe (b) ajo duhet të vendoset jo më vonë se 12 muaj pas Datës së Fillimit të Punimeve të Ndërtimit. Nëqoftëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin të përmbushë kërkesat e këtij Neni 7.2.5, ai do të kompensojë dhe zhdëmtojë Koncesionarin për të gjitha dëmet që rezultojnë nga kjo shkelje.

7.2.7 Koncesionari do të jetë përgjegjës, me shpenzimet e tij, për ndërtimin e të gjitha rrugëve të nevojshme të hyrjes nga rrjeti ekzistues shqiptar i rrugëve ose të Infrastrukturës Zëvendësuese në kufijtë e Shesheve dhe të gjitha rrugëve të nevojshme tek Sheshet (përveç Infrastrukturës Zëvendësuese) ("Rrugët Hyrëse").

7.3 Rrethana të Veçanta Gjatë Fazës së Ndërtimit: Zgjatja e Përfundimit sipas Grafikut

7.3.1 Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit sipas Grafikut për çdo Hidrocentral do të zgjatet si më poshtë përsa i përket çdo Hidrocentrali:

a) nëse ka ndodhur dhe është duke vazhduar një Rast i Forcës Madhore, Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit sipas Grafikut do të zgjatet me një periudhë kohe që do t'i korrespondojë vonesës së shkaktuar nga ky Rasti i Forcës Madhore;

b) nëse ka ndodhur dhe është duke vazhduar një Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm, Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit sipas Grafikut do të zgjatet me një periudhë kohe që do t'i korrespondojë këtij Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm;

c) nëse ka ndodhur ose është duke vazhduar një ngjarje e përshkruar në Nenin 11.3, Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit sipas Grafikut do të zgjatet për një periudhë kohore që do t'i korrespondojë vonesës së shkaktuar nga kjo ngjarje;

d) në rast se zbulohen relike kulturore arkeologjike, fosile, tuma varrezash dhe përmendore, mbetje të kaluara artisitike dhe çdo artifac ose send tjetër me vlerë arkeologjike, gjeologjike ose historike në Shesh ose rreth tij, që rezulton në ndërhyrjen ose vonesën e Ndërtimit ose përfundimin e Punimeve, Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit sipas Grafikut do të zgjatet me një periudhë kohe që do t'i korrespondojë kohëzgjatjes së kësaj ndërhyrjeje ose vonese; dhe

e) nëse ndodh ndonjë ngjarje tjetër që shkakton një zgjatje siç është parashikuar në Nenin 3.2.2, Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit sipas Grafikut do të zgjatet ashtu siç është parashikuar aty.

7.3.2 Secila nga Palët mund t'ja adresojë ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me këtë nen mekanizmit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeje në Nenin 13. Në rast se ndodh ndonjë nga ngjarjet e sipërpërmendura, Koncesionari do të përfitojë nga çdo zgjatje siç është parashikuar këtu, por nuk do të ketë të drejtën e ndonjë kompensimi shtesë përveçse siç është parashikuar shprehimisht në këtë Kontratë.

7.3.3 Monitorimi dhe Inspektimi i Ndërtimit të Hidrocentraleve

7.3.4 Përveç monitorimit dhe inspektimit nga Entet përkatëse Shtetërore në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Autoriteti Kontraktues mund të monitorojë dhe inspektojë Ndërtimin gjatë Fazës së Ndërtimit në prani të Koncesionarit pasi t'i japë Koncesionarit një njoftim paraprak të arsyeshëm; me kusht që, gjithsesi, ky monitorim dhe inspektim të mos përbëjë pengesë ose të ndërhyjë në ecurinë e ndërtimit apo ta ndërpresë ndërtimin.

7.3.5 Koncesionari do t'i raportojë Autoritetit Kontraktues çdo gjashtë-mujor gjatë Ndërtimit lidhur me

a) Progresin dhe masat e marra për të kapërcyer ndonjë vonesë;

b) Shmangiet nga Projekti i Miratuar i Detajuar;

c) Defektet Thelbësore

d) Implementimin e sistemeve të cilësisë së kontrollit dhe sigurisë;

e) Aksidentet serioze për shëndetin dhe sigurinë;

f) Pretendimet e palëve të treta;

g) Çdo ngjarje ose rrethanë tjetër për të cilën Autoriteti Kontraktues është ose mund të jetë përgjegjës sipas kësaj Kontrate.

7.3.6 Çdo Ent Shtetëror do të përballojë kostot e veta të monitorimit dhe inspektimit të Ndërtimit të Hidrocentraleve.

7.3.7 Detyrime të Tjera

Koncesionari:

a) pas kërkesës së Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktues duhet t'i sigurojë këtij kopje të çdo dokumenti skicimi dhe projektimi;

b) duhet t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues serinë e skicimeve dhe dokumenteve të tjera në përputhje me këtë Kontratë;

c) të parandalojë dhe/ose kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë Punim;

d) pa rënë ndesh me Nenin 8.3, të marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë përsa i përket Shesheve (objekt i Nenit 8.3);

e) të heqë mbetjet nga ndërtimi dhe mbeturinat e projektit në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe Praktikën e Industrisë së Mirë; dhe

f) të mos i shkaktojë dëmtime ndonjë tubacioni, linje kabllore ose kanali ekzistues te Sheshet dhe që janë në pronësi të shtetit, ekzistenca e të cilave i është njoftuar Koncesonarit nga Autoriteti Kontraktues pas kërkesës përkatëse nga Koncesionari, ose të cilat duhet të ishin të dukshme për Koncesionarin, përveç kur bëhet me aprovim të Autoritetit Kontraktues.

7.3.8 Testet e Funksionimit

a) Koncesionari do të njoftojë Autoritetin Kontraktues me të paktën një njoftim paraprak me shkrim prej 15 ditësh për datën dhe vendin në të cilin do të fillojnë Testet e Funksionimit përsa i përket çdo Hidrocentrali.

b) Nëse Autoriteti Kontraktues ose i caktuari i tij nuk është i pranishëm në kohën e caktuar për Testet e Funksionimit, Testi i Funksionimit mund të kryhet edhe në mungesë të Autoritetit Kontraktues ose të caktuarit prej tij.

7.3.9 Raporti i Përfundimit dhe Çertifikata e Përfundimit Final

a) Brenda një muaji pas përfundimit të çdo Testi Funksionimi përsa i përket një Hidrocentrali, Koncesionari do t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues një raport përfundimi ("Raporti i Përfundimit").

b) Nëse nuk është dhënë asnjë Njoftim për Mospërmbushje në përputhje me Nenin 7.3.10 (Dhënia e Njoftimit për Mospërmbushje), Autoriteti Kontraktues do të lëshojë Çertifikatën e Përfundimit Final jo më vonë se 1 muaj pas dërgimit të Raportit të Përfundimit. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin të lëshojë Çertifikatën e Përfundimit Final dhe Njoftimin për Mospërmbushje në përputhje me Nenin 7.3.10, në çdo rast brenda 1 muaji pas dërgimit të Raportit të Përfundimit, Çertifikata e Përfundimit Final, përsa i përket këtij Hidrocentrali do të konsiderohet se është lëshuar në datën e cila është 1 muaj pas dërgimit të Raportit të Përfundimit.

7.3.10 Dhënia e Njoftimit për Mospërmbushje

a) Nëse Autoriteti Kontraktues vendos se Raporti i Përfundimit nuk arrin të vërtetojë se Projekti është në përmbushje të plotë me Projektin e Detajuar, Autoriteti Kontraktues mund të japë një njoftim për mospërmbushje ("Njoftimi për Mospërmbushje") jo më vonë se 1 muaj pas dërgimit të këtij Raporti Përfundimi, duke deklaruar se Projekti nuk përputhet me Projektin e Detajuar, duke përcaktuar kriteret specifike të Projektit të Detajuar me të cilat nuk përputhet Projekti dhe duke përshkruar këto mospërputhshmëri me detaje të arsyeshme. Koncesionari do ta njoftojë Autoritetin Kontraktues brenda 1 muaji nga marrja e Njoftimit për Mospërmbushje nëse ai e miraton ose kundërshton këtë Njoftim për Mospërmbushje, dhe nëse Koncesionari e kundërshton këtë Njoftim për Mospërmbushje, do të japë arsyet për këtë kundërshtim. Secila

nga Palët mund t'ja adresojë këtë mosmarrëveshje mekanizmit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të përcaktuar në Nenin 13.

b) Pas marrjes së Njoftimit për Mospërmbushje, Koncesionari, brenda një kohe të arsyeshme, do të bëjë të gjitha veprimet e nevojshme rregulluese për të ndrequr shkaqet e mospërputhshmërisë së vënë re në këtë Njoftim për Mospërmbushje. Përveç se nëse është parashikuar ndryshe në këtë Kontratë, Koncesionari do të përballojë të gjitha kostot dhe shpenzimet e veprimeve rregulluese të bëra në përputhje me Nenin 7.3.10. Pasi të jenë përfunduar këto veprime rregulluese, Koncesionari do të parashikojë sërish kryerjen e një Testi Funksionimi në përputhje me Nenin 7.3.8.

7.3.11 Vonesa

a) Vonesa në Përfundimin Paraprak. Përveç përsa i përket ndonjë ngjarjeje të përcaktuar sipas Nenit 7.3 të kësaj Kontrate (Rrethana të veçanta Gatë Fazës së Ndërtimit – Zgjatja e Përfundimit sipas Grafikut), nëse Përfundimi Paraprak përsa i përket një Hidrocentrali nuk ndodh para ose në Datën e Përfundimit të Punimeve sipas Ggrafikut për shkak të neglizhencës së Koncesionarit ose të atyre për të cilët ai është përgjegjës, Dëmet e Likujdueshme lidhur me këtë Hidrocentral do t'i paguhen Autoritetit Kontraktues nga Koncesionari në Vlerën përkatëse të Dëmeve të Likujdueshme për kohëzgjatjen e kësaj vonese.

b) Vonesa në Veprimet Rregulluese. Nëse Koncesionari nuk ndërmerr të gjitha veprimet regulluese për të ndrequr shkaqet thelbësore të mospërputhshmërisë së vënë re në Njoftimin për Mospërmbushje brenda një kohe të arsyeshme siç parashikohet në Nenin 7.3.9 (b), Dëmet e Likujdueshme, lidhur me këtë Hidrocentral do t'i paguhen Autoritetit Kontraktues nga Koncesionari pas kalimit të periudhës së ndreqjes prej gjashtëdhjetë Ditë Pune në Vlerën Përkatëse të Veprimit Rregullues të Dëmeve të Likujdueshme.

c) Shuma totale e Dëmeve të Likujdueshme për t'u paguar mbështetur në Nenin 7.3.11 nuk do të kalojë shumën e disponueshme sipas Garancisë së Kontratës ("Kufiri Maksimal i Dëmeve të Likujdueshme"). Marrja e Dëmeve të Likujdueshme nga Autoriteti Kontraktues do të jetë zhdëmtimi i vetëm përsa i përket vonesës përkatëse. Pasi të arrihet Kufiri Maksimal i Dëmeve të Likujdueshme, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë ta zgjidhë këtë Kontratë në përputhje me nenin 11.1 (a) (Zgjidhja e Kontratës) nëse ka kaluar periudha e ndreqjes së përcaktuar këtu.

d) Çdo shumë e paguar nga Koncesionari te Autoriteti Kontraktues si Dëme të Likujdueshme do të konsiderohet se është një vlerësim i vërtetë i humbjes së pësuar nga Autoriteti Kontraktues dhe në asnjë mënyrë nuk do të konsiderohet se përbën një gjobë.

7.3.12 Detyrimet Pas Përfundimit

Jo më vonë se një (1) muaj pas Datës Faktike të Përfundimit të Punimeve, Koncesionari do t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues sa më poshtë:

a) dy kopje të të gjitha të dhënave teknike (duke përfshirë raportin e projektit, dokumentet e përllogaritjeve dhe të projektimit, si në formë të shtypur ashtu edhe në formë elektronike, duke përfshirë të gjitha udhëzimet e nevojshme) që lidhen me projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentraleve;

b) dy kopje të skicimeve "ashtu siç janë ndërtuar" të Hidrocentraleve, së bashku me dokumentat e evidencave të çdo Testi Funksionimi të Hidrocentraleve nga Koncesionari; dhe

c) dy kopje të të gjitha dokumenteve ose materialeve të tjera teknike që lidhen me Hidrocentralet, siç mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

7.3.13 Braktisja

Ndërtimi i Hidrocentralit do të konsiderohet i braktisur nga Koncesionari nëse, pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues, Koncesionari:

a) njofton Autoritetin Kontraktues lidhur me vendimin e tij për të braktisur plotësisht ose pjesërisht Punimet;

b) nuk rifillon plotësisht ose pjesërisht ndërtimin e Punimeve përsa i përket atij Hidrocentrali brenda nëntëdhjetë ditëve nga mbarimi i Rastit të Forcës Madhore;

c) ndërpret ndërtimin e të gjitha ose pothuaj të gjitha Punimeve përsa i përket atij Hidrocetnrali për një periudhë në vazhdim prej nëntëdhjetë ditësh; ose

d) tërheq drejtpërdrejt ose nëpërmjet veprimit të kryer nga kontraktuesi i ndërtimit, të gjithë, ose pothuaj të gjithë, personelin nga Sheshi, përsa i përket atij Hidrocetnrali, para Datës

së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut, me kusht që në atë Hidrocentral:

i) kjo tërheqje të çojë në një ndërprerje të plotë të Punimeve; dhe

ii) të mos jetë caktuar një kontraktues zëvendësues ndërtimi për të vazhduar ndërtimin, brenda nëntëdhjetë ditëve nga data në të cilën është ndërprerë ndërtimi; dhe

iii) kjo tërheqje, sipas gjykimit të arsyeshëm të Koncesionarit, nuk është e nevojshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e këtij personeli.

Data e të konsideruarit të braktisur do të jetë, (x) në rastin e parashikuar në paragrafin (a) më sipër, data në të cilën është bërë njoftimi, dhe (y) në rastet e parashikuara në paragrafet (b) deri te (d) më sipër, data në të cilën mbaron periudha prej nëntëdhjetë ditësh referuar në këto paragrafë.

7.3.14 Garancia e Kontratës

a) Para ose në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues një Garanci Kontrate, e cila është thelbësisht në përputhje me formatin e paraqitur në Shtojcën D (Forma e Garancisë së Kontratës). Vlera Fillestare e Garancisë së Kontratës do të jetë 50 milion Euro dhe në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate si dhe në çdo ripërtëritje të mëpasshme Garancia e Kontratës do të jetë e vlefshme për një minimum prej një viti.

b) Koncesionari brenda afatit të kësaj Kontrate do të ripërtërijë Garancinë e Kontratës me kushte thelbësisht të njëjta – e zvogëluar në përputhje me pikën (c) më poshtë (nëse zbatohet) – dhe do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues çdo Garanci Kontrate të ripërtërirë jo më vonë se dhjetë (10) Ditë Pune para mbarimit të kohëzgjatjes së Garancisë së paçliruar të Kontratës. Mosripërtëritja në kohë e Garancisë së Kontratës do t'i japë të drejtë Autoritetit Kontraktues të çlirojë atëherë Garancinë e Kontratës.

c) Autoriteti Kontraktues bie dakord se shuma fillestare e Garancisë së Kontratës do të zvogëlohet me:

i) 12.5 milion Euro pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit Final për Hidrocentralin e Banjës (minus shumat e tërhequra deri në atë kohë për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Banjës)

ii) 18.75 milion Euro pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit Final për Hidrocentralin e Lozhan-Grabovës (minus shumat e tërhequra deri në atë kohë për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Lozhan-Dragovës)

iii) 18.75 milion Euro tridhjetë (30) ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit Final për Hidrocentralin e Skënderbegas-Cekinit (nga ku zbriten shumat e tërhequra deri në atë kohë për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Skënderbegas-Cekinit)

d) Autoriteti Kontraktues do të çlirojë plotësisht Garancinë e Kontratës në Datën e Përfundimit Faktik të Punimeve.

e) Shuma maksimale që Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të marrë sipas Garancisë së Kontratës do të jetë 50 milion Euro.

f) Pa rënë ndesh me mjetet e tjera ligjore të mundshme sipas kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të çlirojë Garancinë e Kontratës për çdo Dëm të Likujdueshëm i cili është për t'u paguar sipas Nenit 7.3.11 (a) nëse Koncesionari nuk i ka paguar këto shuma brenda periudhave të specifikuara në Nenin 7.2.4.

8. SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBAJTJA

8.1 Shfrytëzimi

Pas Përfundimit Paraprak të një Hidrocentrali, Koncesionari duhet dhe ka të drejtë

a) të ushtrojë të gjitha të Drejtat Koncesionare në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë, si dhe në përputhje me Kërkesat Teknike Minimale;

(b) të shfrytëzojë dhe mirëmbajë Hidrocentralet si Operator i Kujdesshëm dhe i Arsyeshëm;

c) të krijojë dhe zbatojë një sistem të planifikuar mirëmbajtjeje në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë; dhe

d) të raportojë lidhur me këtë në një masë të kënaqshme dhe të arsyeshme për Autoritetin Kontraktues.

Për të shmangur çdo keqinterpretim, Koncesionari ka të drejtë të shfrytëzojë ndonjë nga Hidrocentralet për të cilat është arritur Përfundimi Paraprak pavarësisht nëse është arritur

Përfundimi Paraprak për të gjitha Hidrocentralet e tjera.

8.2 Shërbimet Publike

Koncesionari, me ndihmën, e kërkuar në mënyrë të arsyeshme, të Autoritetit Kontraktues, do të marrë vetë masat për furnizimin me ujë, trajtimin e ujërave të zeza dhe furnizimin me energji elektrike, si dhe marrë përsipër dhe do të përballojë të gjitha kostot, shpenzimet dhe detyrimet në lidhje me to.

8.3 Siguria

Nëse do të jetë e nevojshme sipas rrethanave të jashtëzakonshme, Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës për ruajtjen e sigurisë së materialeve, makinerive dhe personelit në Sheshe, në masën që e lejon Ligji.

9. SIGURIMI

9.1 Koncesionari në çdo kohë do të pajiset, mbajë dhe ripërtërijë ato garanci sigurimi të kërkuara në lidhje me ushtrimin e të Drejtave Koncesionare dhe shfrytëzimin e Hidrocentraleve në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë, dhe do t'i përcjellë ose do të kujdeset që t'i përcillen Autoritetit Kontraktues kopjet e çertifikuara të çdo çertifikate sigurimi pas marrjes së një njoftimi të arsyeshëm paraprak prej Autoritetit Kontraktues.

9.2 Koncesionari do të përdorë çdo të ardhur nga policat e sigurimit referuar në Nenin 9.1 për rivendosjen e të Drejtave Koncesionare dhe Hidrocentraleve në kushte pune.

9.3 Nëse Koncesionari nuk do të pajiset, mbajë ose ripërtërijë garancitë e sigurimit të parashikuara në Nenin 9.1, Autoriteti Kontraktues mund t'i kryejë vetë këto garanci sigurimi me shpenzimet e Koncesionarit.

10. AFATI, FORCA MADHORE DHE VEPRIMI SHTETËROR THELBËSISHT I DËMSHËM

10.1 Afati

10.1.1 Afati fillon në Datën e Hyrjes në Fuqi të saj dhe, në varësi të dispozitave të mëtejshme të Nenit 10, do të përfundojë në datën që shënon 35 vjet pas Datës së Hyrjes në Fuqi ("Afati Fillestar"), përveçse kur përfundon më herët në përputhje me Nenin 11.

10.1.2 Në rast se në fund të Afatit Fillestar, nuk ka ndodhur as Rasti i Realizimit të NBK dhe as Rasti i Realizimit të Prodhimit, Afati Fillestar do të zgjatet automatikisht në datën më të herët të sa më poshtë (x) fundi i vitit kalendarik në të cilin është përcaktuar se është përmbushur Rasti i Realizimit të NBK (y) fundi i vitit kalendarik në të cilin është përmbushur Rasti i Realizimit të Prodhimit ("Zgjatje Afati"). Për shmangien e çdo keqinterpretimi, hyrja në fuqi e një zgjatjeje të tillë automatike, nuk kërkon në veçanti ndonjë miratim apo pëlqim të Palëve.

10.1.3 Para datës 30 qershor të vitit që shënon 35-vjetorin e Datës së Hyrjes në Fuqi dhe të çdo viti pas kësaj, Koncesionari do të vendosë nëse ka ndodhur Rasti i Realizimit të NBK ose Rasti i Realizimit të Prodhimit dhe do të njoftojë pa vonesë të paarsyeshme Autoritetin Kontraktues për këtë vendim. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk është dakord me këtë vendim, mund t'ja paraqesë këtë mosmarrëveshje Ekspertit Teknik dhe Ekonomik në përputhje me Nenin 13.2. Në këtë rast, Afati do të përfundojë pas 30 ditëve nga dhënia e një vendimi detyrues dhe të pakundërshtueshëm nga Eksperti Teknik dhe Ekonomik, në bazë të të cilit ka ndodhur Rasti i Realizimit të NBK dhe Rasti i Realizimit të Prodhimit, nëse është e zbatueshme, rast në të cilin Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues përfitimin neto të përftuar nga Koncesionari si pasojë e shfrytëzimit të Hidrocentraleve, që nga (x) përfundimi i ditës së fundit që vjen pas vitit kalendarik në të cilin ka ndodhur Rasti i Realizimit të NBK ose Rasti i Realizimit të Prodhimit, nëse është e zbatueshme, ashtu siç është përcaktuar me vendimin e Ekspertit Teknik dhe Ekonomik, deri në (y) përfundimin e Afatit.

10.2 Rasti i Forcës Madhore

10.2.1 "Rasti i Forcës Madhore" do të thotë çdo rrethanë që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të njërës Palë ("Pala e Cenuar") për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

a) kjo rrethanë, pavarësisht ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm, nuk mund të parandalohet ose nuk ishte e mundur të parandalohej, shmangej ose mënjanohej nga Pala e Cenuar;

b) Pala e Cenuar mori ose ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në aftësinë e Palës së Cenuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;

c) ngjarja nuk është, ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cenuar të një prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate; dhe

d) Pala e Cenuar t'i ketë dhënë njoftim Palës tjetër për këtë Rast të Forcës Madhore.

10.2.2 Pa kufizuar frymën e përgjithshme të Nenit 10.2.1 më sipër, secila nga rrethanat e mëposhtme, në masën që është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Nenin 10.2.1 më sipër, do të përbëjë Rast të Forcës Madhore:

a) veprimet e luftës, pushtimi ose aktet e një armiku të huaj, ose aktet e terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimet;

b) aktet e rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat e natyrës politike, aktet ose fushatat e terrorizimit, ose sabotazhi me natyre politike;

c) rrufeja, zjarri, tërmeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore;

d) epidemia ose murtaja; dhe

e) grevat ose veprimtaritë e punës për të imponuar ose për të ngadalësuar punën (sidoqoftë duke përjashtuar punonjësit e Palës që e pretendon atë si Rast të Forcës Madhore ose punonjësit e ndonjë prej aksionerëve të kësaj Pale, ose punonjësit e ndonjë filiali të kontrolluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga shoqëria mëmë ose degë e ndonjë aksionari të kësaj Pale).

10.2.3 Nëse është rënë dakord ose është vendosur se ka ndodhur Rasti i Forcës Madhore dhe ky rast sjell ose do të sjellë si pasojë pengesën, vështirësimin ose vonesën në përmbushjen e detyrimeve sipas Kontratës nga Pala e Cenuar, në shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Projektit, atëherë Pala e Cenuar do të përjashtohet nga përmbushja sipas Kontratës e detyrimeve që janë cenuar nga ky Rast i Forcës Madhore për gjithë kohëzgjatjen e këtij Rasti të Forcës Madhore dhe do të ketë të drejtën e shtyrjes së ndonjë date përfundimi ose date të planifikuar për aq sa zgjat Rasti i Forcës Madhore.

10.3 Veprimi Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm

10.3.1 Nese Koncesionarit i shkaktohen pengesa, vështirësi ose vonesa në përmbushjen e ndonjë apo të gjitha detyrimeve sipas kësaj Kontrate, ose çdo kontrate tjetër në të cilën Shoqëria Koncesionare është palë, apo në shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen Hidrocentraleve apo shitjen e Prodhimit Elektrik Neto, për shkak të një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm, Koncesionari do d'i dërgojë një njoftim ("Njoftimi i VSHTHD") Autoritetit Kontraktues sa më shpejt që të jetë praktike në mënyrë të arsyeshme pasi të jetë vënë në dijeni për këtë Veprim Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm, duke informuar Autoritetin Kontraktues për:

a) ekzistencën dhe natyrën e Veprimit Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm;

b) masën në të cilën, përmbushja e detyrimeve nga Koncesionari është ose do të pengohet, vështirësohet ose vonohet si rezultat i drejtpërdrejtë i këtij Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm; dhe

c) hapat që Koncesionari është duke ndërmarrë apo synon të ndërmarrë ose që do të ndërmarrë për të zvogëluar, shmangur apo kapërcyer pasojat e dëmshme si pasojë e këtij Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm.

10.3.2 Koncesionari do të ketë barrën e provës për të demonstruar në detaje të arsyeshme si ekzistencën e një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm ashtu edhe pasojën (si përsa i përket natyrës ashtu edhe shtrirjes) që ka ky Veprim Thelbësisht i Dëmshëm i Qeverisë në përmbushjen e detyrimeve të tij.

10.3.3 Autoriteti Kontraktues, me marrjen e njoftimit të VSHTHD, do të ketë të drejtë të kërkojë që Koncesionari t'i paraqesë atij informacion shtesë dhe dokumentacionin mbështetës siç mund të jetë e arsyeshme për të kërkuar mbështetjen e një Njoftimi VSHTHD dhe Koncesionari do ta sigurojë këtë informacion dhe/ose dokumentacion mbështetës brenda 15 ditëve pas kërkesës së bërë për to.

10.3.4 Nëse Palët, mbi bazën e Njoftimit të VSHTHD dhe çdo dokumentacioni mbështetës, nuk janë në gjendje të bien dakord mbi ekzistencën apo pasojat e një Veprimi

Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm deri në fund të (a) 60 ditëve pas marrjes nga Autoriteti Kontraktues të Njoftimit për VSHTHD dhe (b) 30 ditëve pas marrjes nga Autoriteti Kontraktues të informacionit shtesë në përputhje me Nenin 10.3.3, secila nga Palët ka të drejtë t'ja paraqesë çështjen për gjykim arbitrazhit në përputhje me Nenin 13.3.

10.3.5 Nëse është rënë dakord apo vendosur se ka ndodhur një Veprim Thelbësisht i Dëmshëm i Qeverisë dhe se ai ka sjellë ose do të sjellë pasjat e përshkruara në Nenin 10.3.1, Koncesionari do të ketë të drejtën e përjashtimit nga detyrimet e përshkruara më poshtë në masën që:

a) këto pasoja janë shkaktuar nga ky Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm; dhe

b) pasojat e dëmshme të Veprimit Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm nuk mund të ishin zvogëluar, shmangur ose kapërcyer apo nuk mund të zvogëlohen, shmangen ose kapërcehen nga Koncesionari që vepron si një Operator i Kujdesshëm dhe i Arsyeshëm.

10.3.6 Nëse përmbushja nga Koncesionari e detyrimeve të tij sipas Kontratës pengohet, vështirësohet apo vonohet në çdo kohë nga një Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm, ky Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm:

a) do të përjashtojë Koncesionarin nga përmbushja e atyre detyrimeve që janë cenuar nga Veprimi Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm për aq kohë sa zgjat ky Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm;

b) do t'i japë Koncesionarit të drejtën për shtyrjen e ndonjë date përfundimi ose të planifikuar për aq sa zgjat ky Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm.

10.3.7 Nëse Veprimi Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm (i) kërkon që Koncesionari të modifikojë ndonjërin nga Hidrocentralet apo mënyrën sesi ai ndërton, shfrytëzon ose mirëmban këtë Hidrocentral, dhe/ose (ii) sjell si pasojë rritjen e kostove të Koncesionarit dhe/ose uljen e të ardhurave të Koncesionarit, atëherë Koncesionari do të ketë të drejtën e një kompensimi nga Autoriteti Kontraktues përsa i përket kostove shtese të bëra nga Koncesionari (duke përfshirë kostot kryesore shtesë dhe koston shtesë operative) si dhe të ardhurave të zvogëluara të përftuara nga Koncesionari ("Kompensimi VSHTHD"), përveç nëse kosto të tilla shtesë dhe/ose te ardhurat e zvogëluara janë në total nën 300,000 Euro p.a (për shmangien e çdo keqinterpretimi, këto kosto shtesë dhe/ose të ardhura të zvogëluara të shkaktuara nga një Veprim Thelbësisht i Dëmshëm i Qeverisë do të përllogariten në krahasim me kostot ose të ardhurat që do të ishin pësuar ose marrë, nëse VSHTHD nuk do të kishte ndodhur). Limiti financiar i mësipërm do të aplikohet vetëm ndaj Nenit 10.3.7 dhe nuk do të aplikohet ndaj ndonjë dispozite që ka të bëjë me kompensimin apo dëmshpërblimin parashikuar kudogjetkë në këtë Kontratë.

10.3.8 Sasia dhe mjetet e pagesës në rastet e kompensimit të VSHTHD do të miratohen nga palët ose do të percaktohen nga Eksperti Teknik dhe Ekonomik. Koncesionari do të ketë të drejtën e zbritjes së Kompensimit VSHTHD që duhet t'i paguhet atij nga shlyerjet e Pagesës së Koncesionit që i paguhen Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të përfitojë si Kompensim VSHTHD një kompensim ekuivalent në vend të pagesave cash, duke përfshirë një zbritje nga Pagesa e Koncesionit, në varësi të miratimit të Koncesionarit, i cili nuk duhet të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme.

11. ZGJIDHJA E KONTRATËS

11.1 Zgjidhje e Parakohshme. Koncesionari do të ketë të drejtë ta zgjidhë këtë kontratë pa pasoja financiare për ndonjërën nga Palët në rast të

a) një rritjeje në kosto siç është parashikuar në Nenin 3.5; ose

b) çdo ngjarjeje tjetër pasojat e së cilës vënë thelbësisht në rrezik bazat ekonomike të projektit.

11.2 Mospërmbushja e detyrimeve nga Koncesionari. Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve nga Koncesionari duke e njoftuar Koncesionarin me shkrim për secilën nga dukuritë e mëposhtme (me përjashtim të rasteve kur kjo dukuri: (i) rezulton nga një VSHTHD; (ii) rezulton nga një shkelje e kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues; ose (iii) ndodh si rezultat ose në lidhje me një Rast të Forcës Madhore):

a) Paaftësia paguese e Koncesionarit;

b) braktisja e Projektit nga Koncesionari sipas Nenit 7.3.13;

c) një shkelje thelbësore nga Koncesionari e ndonjë prej detyrimeve kryesore sipas kësaj Kontrate (përveç shkeljeve të përcaktuara në Nenet 11.2(a), 11.2(b) dhe 11.2(d)), shkelje e cila ka vazhduar pa u ndrequr edhe 6 muaj pas njoftimit të dhënë nga Autoriteti Kontraktues për një shkelje të tillë;dhe

d) çdo shkelje thelbësore nga Koncesionari, Aksionerët Kryesorë, apo Shoqëria Koncesionare e detyrimeve të tyre respektive sipas Nenit 5 me kusht që Autoriteti Kontraktues t'i ketë dhënë Koncesionarit një njoftim paraprak me shkrim prej 14 ditësh për shkeljen në fjalë si dhe lidhur me qëllimin për të ushtruar të drejtat e tij sipas këtij Neni.

11.3 Mospërmbushja e detyrimeve nga Autoriteti Kontraktues. Koncesionari do të ketë të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve nga Autoriteti Kontraktues duke e njoftuar me shkrim Autoritetin Kontraktues për secilën nga dukuritë e mëposhtme (me përjashtim të rasteve kur kjo dukuri: (i) rezulton nga një shkelje e kësaj Kontrate nga Koncesionari; ose (ii) ndodh si rezultat ose në lidhje me një Rast të Forcës Madhore):

a) shpronësimi, përvetësimi dhe marrja e detyruar, konfiskimi ose shtetëzimi nga ndonjë Ent Shtetëror i:

i) çdo aksioni në Shoqërinë Koncesionare apo të ndonjë Aksioneri; ose

ii) çdo aset apo te drejte thelbësore të Koncesionarit apo të një kontraktori, ose

iii) çdo veprimi tjetër të ngjashëm të ndonje Enti Shtetëror që cenon thelbësisht:

1. gëzimin nga Koncesionari të çdo të drejte dhe përfitimi të parashikuar nga kjo Kontratë;

2. përmbushjen nga Koncesionari të çdonjërit nga detyrimet e tij sipas apo në zbatim të kësaj Kontrate;

3. shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Hidrocentraleve dhe prodhimin e elektricitetit tek ato; ose

4. gëzimin nga çdo Aksioner të të drejtave dhe përfitimeve të cilat ai i gëzon për shkak të pjesëmarrjes në Shoqërinë Koncesionare;

b) Koncesionari nuk është në gjendje që të përmbushë të gjitha apo një pjesë thelbësore të detyrimeve sipas kësaj Kontrate ose ndryshe të shfrytëzojë Hidrocentralet mbi baza të qëndrueshme ekonomike për shkak të një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm që ka vazhduar për më tepër se një periudhë prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm;

c) Autoriteti Kontraktues, në vijim të paraqitjes së një kërkese për shpronësim nga Koncesionari, nuk e miraton atë në përputhje me Nenin 3.4.6 apo nuk kryen procedurat përkatëse në përputhje me Ligjin; ose

d) një shkelje thelbësore nga Autoriteti Kontraktues e ndonjë prej detyrimeve të tij thelbësore sipas kësaj Kontrate (përveç atyre shkeljeve të përcaktuara në Nenet 11.3(a) deri te (c)), shkelje e cila ka vazhduar pa u ndrequr për 6 muaj të tjerë pas dhënies së njoftimit nga Koncesionari për një shkelje të tillë.

11.4 Rasti i Forcës Madhore të Tejzgjatur. Secila Palë do të ketë të drejte ta zgjidhë këtë Kontratë duke i dërguar Palës tjetër një njoftim me shkrim, nëse asnjëra nga Palët nuk është në gjendje të përmbushë të gjitha ose një pjesë thelbësore të detyrimeve sipas kësaj Kontrate për shkak të Rastit të Forcës Madhore të Tejzgjatur; me kusht që Autoriteti Kontraktues të mos ketë të drejtë ta zgjidhë këtë Kontratë nëse Koncesionari riparon ose rregullon dëmet e shkaktuara si pasojë e këtij Rasti të Forcës Madhore të Tejzgjatur.

11.5 Njoftimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me Nenin 11.2 (Mospërmbushja nga Koncesionari) ose njoftimi i dhënë nga Koncesionari në përputhje me Nenin 11.3 (Mospërmbushja nga Autoriteti Kontraktues):

a) nëse mospërmbushja në fjalë nuk mund të ndreqet, do të ketë si pasojë zgjidhjen e kësaj Kontrate me efekt të menjëhershëm, ose nëse konsiderohet e përshtatshme, në ndonjë datë të mëvonshme të specifikuar në njoftim; ose

b) nëse mospërmbushja mund të ndreqet, do të sjellë si pasojë zgjidhjen e kësaj Kontrate me kalimin e një periudhe 45-ditore, me përjashtim të rasteve kur Pala mospërmbushëse, para kalimit të kësaj periudhe:

i) ka ndrequr mospërmbushjen; ose

ii) i ka paraqitur Palës që ka pësuar mospërmbushjen një plan rregullues brenda 21

ditëve nga data e këtij njoftimi, ka marrë miratimin e palës e cila ka pësuar mospërmbushjen (miratim i cili nuk duhet të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme) për këtë plan rregullues brenda 24 ditëve të mëtejshme dhe ka filluar ta zbatojë këtë program.

11.6 Njoftimi i dhënë nga Pala përkatëse në përputhje me Nenin 11.4 (Rasti i Forcës Madhore të Tejgjatur) do të sjellë si pasojë zgjidhjen e kësaj Kontrate me efekt të menjëhershëm, ose nëse konsiderohet e përshtatshme, në ndonjë datë të mëvonshme të specifikuar në njoftim.

11.7 Në rast se Koncesionari e zgjidh këtë Kontratë para fillimit të Fazës së Ndërtimit në përputhje me dispozitat e Nenit 11.3 (Mospërmbushja nga Autoriteti Kontraktues), Autoriteti Kontraktues do të jetë i detyruar të rimbursojë Koncesionarin për kostot e arsyeshme te bëra në lidhje me Projektin dhe Koncesionari do të jetë i detyruar t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues të gjithë dokumentacionin e projektit, studimeve, planimetritë. etj., që lidhen me Projektin.

11.8 Në rast se Autoriteti Kontraktues e zgjidh këtë Kontratë për ndonjë nga shkaqet e specifikuara në Nenin 11.2 (Mospërmbushja nga Koncesionari), Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit, duke marrë në konsideratë transferimin sipas parimit "ashtu siç është ndërtuar"; të Hidrocentraleve dhe të gjitha të drejtave dhe aseteve lidhur me ta te Autoriteti Kontraktues në përputhje me këtë Kontratë, (i) nëse zgjidhja ndodh pas fillimit të Fazës së Ndërtimit, por para ose në Datën e Përfundimit Faktik të Punimeve, një shumë të barabartë me 80% të Kostove Faktike të Investimit të bëra nga Koncesionari; ose (ii) nëse zgjidhja ndodh pas Datës së Përfundimit Faktik të Punimeve, një shumë të barabartë me vlerën reale të tregut që ka Projekti, në datën e zgjidhjes, siç është rënë dakord ndërmjet Palëve ose siç është vendosur nga Eksperti Teknik dhe Ekonomik.

11.9 Në rast se Koncesionari e zgjidh këtë Kontratë pas fillimit të Fazës së Ndërtimit për ndonjë nga shkaqet e specifikuara në Nenin 11.3 (Mospërmbushja nga Autoriteti Kontraktues), Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit, duke marrë në konsideratë transferimin, sipas parimit "ashtu siç është ndërtuar"; të Hidrocentraleve dhe të gjitha të drejtave dhe aseteve lidhur me ta te Autoriteti Kontraktues në përputhje me këtë Kontratë, një shumë të barabarte me (x) Kostot Faktike te Investimeve, (y)Vlerën Aktuale Neto duke përdorur EURIBOR 3-mujor plus 50bps në kohën e zgjidhjes si norma zbritjeje të derdhjeve neto cash të parashikuara të Projektit, ashtu siç është përcaktuar nga preventivi i arsyeshëm i Ekspertit Teknik dhe Ekonomik për vitet që nga koha e zgjidhjes deri në 59-vjetorin e Datës së Përfundimit Faktik të Punimeve, dhe (z) çdo kosto të bërë nga Koncesionari në lidhje me ose si rezultat i zgjidhjes së kësaj Kontrate, duke përfshirë kostos e zgjidhjes përsa i përket punëmarrësve dhe kostove që i paguhen kontraktorëve.

11.10 Nëse secila nga Palët e zgjidh këtë Kontratë pas fillimit të Fazës së Ndërtimit për shkaqet e parashikuara në Nenin 11.4 (Rasti i Forcës Madhore të Tejzgjatur), Autoriteti Kontraktues do t'i paguajeëKoncesionarit, duke marrë në konsideratë transferimin sipas parimit "ashtu siç është ndërtuar"; të Hidrocentraleve dhe të gjitha të drejtave dhe aseteve lidhur me ta te Autoriteti Kontraktues në përputhje me këtë Kontratë, (i) nëse zgjidhja ndodh pas fillimit te Fazës së Ndërtimit, por para ose në Datën e Përfundimit Faktik të Punimeve, një shumë të barabartë me Kostot Faktike të Investimit (minus të ardhurat e përftuara nga ndonjë lloj siguracioni); ose (ii) nëse zgjidhja ndodh pas fillimit të Fazës së Ndertimit, një shumë të barabartë me Kostot Faktike të Investimit (minus të ardhurat e përftuara nga ndonjë lloj siguracioni) me kusht që kjo shumë do të zvogëlohet me 1.69 (një, presje gjashtëdhjetenëntë) për qind për çdo vit të plotë deri në vitin në të cilin ndodh zgjidhja pas Datës së Përfundimit Faktik të Punimeve.

Koncesionari do të bëjë përpjekje maksimale për të konstatuar nëse Ngjarjet e Forcës Madhore janë të sigurueshme në treg me prime të arsyeshme për projkte të kësaj natyre (primet vjetore nuk duhet të jenë mbi 1 për qind të kostos së operimit të Hidrocentralit) dhe nëse janë nën të, të shikojë mundësinë e sigurimit përkatës të Projektit.

11.11 Çdo transferim i një Hidrocentrali sipas Neneve, 11.8, 11.9 ose 11.10 do të bëhet paralelisht me pagesën në lidhje me këtë transferim siç është përcaktuar në Nenet 11.8, 11.9 ose 11.10 brenda 90 ditëve nga zgjidhja e kësaj Kontrate.

11.12 Asnjëra nga Palët nuk do të ketë të drejtë ta zgjidhë këtë Kontratë përveç se siç është parashikuar në këtë Kontratë.

12. DORËZIMI DHE PERIUDHA KALIMTARE

12.1 Në gjashtë (6) muajt e fundit të Afatit, Koncesionari do të fillojë përmbushjen e detyrimeve të dorëzimit, siç jepen më poshtë, dhe do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktues dhe do t'i sigurojë këtij (ose ndonjë pale të tretë të caktuar nëpërmjet saj) të gjithë aksesin dhe informacionin, siç mund të kërkohet ose është e nevojshme për të marrë në ngarkim shfrytëzimin e Hidrocentraleve;

12.1.1 Menjëherë pas kalimit të Afatit dhe në varësi të Nenit 12.1.2 më poshtë:

a) çdo Hidrocentral duhet të jetë (x) në gjendje të mire në përputhje me çdo regjim të planifikuar mirëmbajtjeje, dhe (y) në zbatim të Kërkesave Teknike Minimale; me kusht që gjithsesi të çdo Mosmarrëveshje në lidhje me paragrafet (x) ose (y) në fjalinë paraardhëse do t'i referohet Ekspertit Teknik dhe Ekonomik, i cili (pavarësisht ndonjë gjëje në kundërshtim me sa përmbahet këtu) do të japë vendim përfundimtar për Mosmarrëveshjen;

b) të Drejtat Koncesionare do të pushojnë automatikisht së ekzistuari dhe Koncesionari nuk do të ketë më të drejtë të përdorë apo shfrytëzojë Hidrocentralin, Sheshin dhe të Drejtën përkatëse të Kalimit;

c) Koncesionari do të transferojë menjëherë tek Autoriteti Kontraktues, të lira nga çdo detyrim apo barrë, në gjendjen ekzistuese, të gjitha të drejtat, titujt ligjorë dhe interesat ndaj Hidrocentralit përkatës, (duke përfshirë pronësinë e këtij Hidrocentrali, si dhe (për aq sa ato janë pjesë të Projektit apo përdoren në Projekt), sa më poshtë:

i) të gjitha lëndët e para, pjesët e konsumueshme dhe pjesët e këmbimit,

ii) e gjithë prona personale e trupëzuar,

iii) e gjithë prona personale e trupëzuar, duke përfshirë dhe të drejtat e pronësisë intelektuale (që nuk janë transferuar tashmë me anë të ndonjë licence),

iv) të gjitha ndërtimet dhe pjesët e lidhura pazgjidhmërisht me to,

v) librat apo dokumentat e evidencave (records) të kompjuterizuara ose jo, raportet, të dhënat, dosjet dhe informacioni, skicimet, rezultatet e testeve, dokumentet,

vi) të gjitha garancitë e pajisjeve, materialeve dhe punimeve,

vii) të gjitha të drejtat kontraktore, duke përfshirë qiratë dhe policat e sigurimit,

viii) të gjitha punimet në proçes (duke përfshirë Punimet e Ndërtimit, nëse ka) në bazë të kontratave me shitës, furnizues, kontraktorë dhe nënkontraktorë, dhe

ix) të gjitha të drejtat në lidhje me çdo shumë sigurimi për t'u paguar në emër dhe për llogari të Koncesionarit, por e papaguar në datën e zgjidhjes së kësaj Kontrate, në lidhje me të drejtat, titujt dhe interesat e Koncesionarit në Projekt;

d) Koncesionari do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të zbatuar çdo transferim të parashikuar këtu në Nenin 12, duke përfshirë nënshkrimin e çdo dokumenti të kërkuar, si dhe lidhjen e çdo akti ose kontrate të nevojshme me Autoritetin Kontraktues (ose me çdo palë të tretë të caktuar nëpërmjet kësaj Kontrate) dhe pa asnjë kosto ose shpenzim për Autoritetin Kontraktues (përveç rastit siç parashikohet shprehimisht në nënparagrafin (e) më poshtë); dhe

e) Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës për pajisjen ose dhënien, me shpenzimet e tij, të të gjitha Autorizimeve për të shfrytëzuar Hidrocentralet (ose për të transferuar shfrytëzimin e tyre tek një palë e tretë), si dhe Koncesionari do të ndihmojë Autoritetin Kontraktues për identifikimin dhe marrjen e çdo Autorizimi të tillë, duke përfshirë dhënien e ndihmës së arsyeshme në përgatitjen e kërkesave në lidhje me to.

f) Transferimi i Hidrocentraleve te Autoriteti Kontraktues në përputhje me Nenin 12 do të kryhet pa pagesë, me përjashtim që çdo kosto në lidhje me këtë transferim, nëse ka, do të merret përsipër nga Autoriteti Kontraktues.

12.1.2 Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kësaj Kontrate, kërkesat e Nenit 12.1.1(a) më sipër, do të zbatohen si më poshtë:

i) në rast të zgjidhjes së Kontratës si rezultat i Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktues (shih Nenin 11.2), me përjashtim të për aq sa Mospërmbushja nga Autoriteti Kontraktues të ketë shkaktuar dëme ose shkatërrimin e plotë ose të pjesshëm të Hidrocentralit;

(ii) në rast të zgjidhjes së Kontratës si rezultat i Rastit të Forcës Madhore të Tejzgjatur, përveç dhe në masën që Rasti përkatës i Forcës Madhore të ketë ka shkaktuar dëme ose shkatërrimin e plotë ose të pjesshëm të Hidrocentralit; dhe

iii) në rast të zgjidhjes nga Autoriteti Kontraktues si rezultat i Mospërmbushjes nga Koncesionari,

me kusht gjithsesi që në masën që ndodh ndonjë nga rrethanat e zgjidhjes të parashikuara sipas pikës (i) deri në pikën (iii) më sipër gjatë Fazës së Ndërtimit, kërkesat e Nenit 12.1.1 (a) më sipër do të përshtaten për të reflektuar faktin që (x) Hidrocentrali nuk mund të ketë arritur ende Përfundimin Final dhe për rrjedhojë nuk është i shfrytëzueshëm; dhe (y) në të vërtetë, Hidrocentrali duhet të ishte në një gjendje e cila të ishte në përpjestim me nivelin e përfundimit që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme në datën përkatëse të zgjidhjes (duke marrë si duhet në konsideratë grafikun e plotë kohor të ndërtimit dhe Praktikën e Industrisë së Mirë, si dhe shumën e investuar nga Koncesionari në Projekt në atë datë).

12.2 Me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, Koncesionari do të lidhë një kontratë shfrytëzimi dhe mirëmbajtjeje me Autoritetin Kontraktues për të shfrytëzuar dhe mirëmbajtur Hidrocentralet për një periudhe kalimtare deri në 18 muaj që vijon pas mbarimit të Afatit përkundrejt një vlere që do të përllogaritet mbi bazën e formulës "kosto shtesë" dhe bazuar në kushtet dhe kriteret e tregut të zakonshëm.

13. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

13.1 Zgjidhja me Pajtim

Nëse do të lindë ndonjë mosmarrëveshje nga kjo Kontratë ose në lidhje me të ("Mosmarrëveshje"), secila nga Palët do t'i japë Palës tjetër njoftim në lidhje me këtë Mosmarrëveshje, pas së cilës Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të takohen menjëherë dhe do të përpiqen me mirëbesim të arrijnë një zgjidhje me pajtim brenda tridhjetë (30) ditëve nga dhënia e njoftimit.

13.2 Eksperti Teknik dhe Ekonomik

13.2.1 Mosarritja e zgjidhjes me pajtim

a) Nëse nuk arrihet një zgjidhje me pajtim në përputhje me Nenin 13.1 më sipër brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e njoftimit të parashikuar këtu, çdo Mosmarrëveshje do t'i paraqitet një eksperti ("Eksperti Teknik dhe Ekonomik"), për të vendosur brenda tridhjetë (30) ditëve pas mbarimit të periudhës së sipërpërmendur të zgjidhjes me pajtim.

b) Në rastet kur është i nevojshëm vendimi lidhur me një Mosmarrëveshje nga Eksperti Teknik dhe Ekonomik, asnjëra nga Palët nuk do të ketë të drejtë t'ja paraqesë këtë mosmarrëveshje për gjykim arbitrazhit ndërkombëtar nëse kjo mosmarrëveshje nuk i është paraqitur së pari për marrjen e një vendimi Ekspertit Teknik dhe Ekonomik dhe nëse kanë kaluar tridhjetë (30) ditë nga momenti i referimit.

13.2.2 Përzgjedhja e Ekspertit Ekonomik dhe Teknik

a) Procedura për emërimin e Ekspertit Teknik dhe Ekonomik do të jetë si më poshtë:

i) Pala që dëshiron të emërojë apo paraqesë çështjen para një Eksperti Teknik dhe Ekonomik do të njoftojë Palën tjetër për këtë qëllim dhe me këtë njoftim do të parashtrojë detajet lidhur me arsyetimin e emërimit dhe natyrën e çështjes që do t'i paraqitet Ekspertit Teknik dhe Ekonomik;

ii) Palët do të takohen dhe përpiqen të bien dakord mbi personin që do të jetë Eksperti Teknik dhe Ekonomik;

iii) Nëse, brenda njëzet e një (21) ditëve nga data e dhënies së njoftimit sipas 31.2.2(a)(i) më sipër, Palët nuk kanë rënë dakord për Ekspertin Teknik dhe Ekonomik, çështja do të paraqitet menjëherë nga Pala që dëshiron të bëjë emërimin, përpara Presidentit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë ("Autoriteti Emërues"), të cilit do t'i kërkohet të emërojë Ekspertin Teknik dhe Ekonomik brenda tridhjetë (30) ditëve dhe gjatë këtij procesi, ai/ajo mund të këshillohet në mënyrë të pavarur kurdoherë që ta konsiderojë të përshtatshme;

vi) Me emërimin e një personi në funksionin e Ekspertit Teknik dhe Ekonomik sipas dispozitave të mësipërme, Palët do ta njoftojnë menjëherë këtë Person për përzgjedhjen e tij/saj dhe do t'i kërkojne atij/asaj të konfirmojë brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve nese ai apo ajo ka vullnetin dhe është në gjendje të pranojë këtë emërim;

v) Nëse ky person nuk shpreh vullnetin si dhe nuk është në gjendje për të pranuar këtë emërim, ose nuk ka konfirmuar gatishmërinë e tij/saj dhe aftësinë për të pranuar këtë emërim brenda periudhës së dhënë prej katërmbëdhjetë (14) ditesh, atëherë (përveç nëse Palët janë në gjendje të bien dakord mbi emërimin e një Eksperti tjetër Teknik dhe Ekonomik), çështja do t'i

paraqitet (nga secila prej Palëve) në mënyrën e sipërpërmendur Autoritetit Emërues, të cilit do t'i kërkohet të bëjë emerimin ose (sipas rastit) një emërim tjetër dhe procesi do të përsëritet derisa të gjendet një person i cili pranon emerimin si Eksperti Teknik dhe Ekonomik; dhe

vi) Nëse lind ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me shpërblimin e ofruar ndaj Ekspertit Teknik dhe Ekonomik, atëherë kjo shumë do të përcaktohet nga Autoriteti Emërues vendimi i të cilit është përfundimtar dhe detyrues për Palët.

b) Nuk mund të caktohet Eksperti Teknik dhe Ekonomik personi që:

i) nuk është i kualifikuar si nga arsimimi, trajnimi dhe eksperienca për të marrë një vendim lidhur me mosmarrëveshjen;

ii) ka një interes apo detyrim i cili në mënyrë thelbësore bie në konflikt me rolin e tij/saj (duke përfshirë të qenit drejtor, funksionar, punonjës apo këshilltar i njërës Palë apo i Filialit të asaj Pale); ose

iii) mban shtetësinë e njërës prej Palëve në këtë Kontratë ose shtetësinë e ndonjë aksionari apo grupi aksionarësh që zotëron më tepër se dhjetë për qind 10% të titujve të pronësisë me të drejtë vote dhe gjithashtu Eksperti Teknik dhe Ekonomik nuk mund të jetë një punonjës ose agjent apo punonjës ose agjent i mëparshëm i këtij personi.

13.2.3 Fuqia Ligjore e Vendimeve të Ekspertit Teknik dhe Ekonomik

a) Në rast se kërkohet vendimi i Ekspertit Teknik dhe Ekonomik do të zbatohen procedurat e mëposhtme:

i) Secila palë do të vërë në dispozicion të Ekspertit Teknik dhe Ekonomik çdo informacion që mund të kërkohet prej tij;

ii) Eksperti Teknik dhe Ekonomik (në varësi të Nenit 13.2.3(a)(iii) më poshtë) do të marrë vendimin e tij/saj sa më shpejt që të jetë praktikisht e arsyeshme, pas marrjes së të dhënave, informacionit dhe pretendimeve me shkrim të vëna në dispozicion të tij/saj nga Palët, dhe në çdo rast jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pasi ai/ajo u ka konfirmuar Palëve pranimin e emërimit të tij/saj;

iii) Eksperti Teknik dhe Ekonomik nuk do te marrë në konsideratë të dhënat, informacionin apo pretendimet me shkrim të paraqitura nga palët pas periudhës 30-ditore të referuar në 13.2.3(a)(ii) më sipër, përveç kur ato janë paraqitur në vijim të një kërkese specifike të bërë nga ai/ajo;

iv) Eksperti Teknik dhe Ekonomik do të ketë të drejtë të marrë këshilla të pavarura profesionale dhe/ose teknike ashtu siç mund të kërkohen prej tij/saj në mënyrë të arsyeshme si dhe të sigurojë asistence sekretariale siç mund të jetë e nevojshme në mënyrë të arsyeshme; dhe

v) Eksperti Teknik dhe Ekonomik do ta arsyetojë plotësisht me shkrim vendimin e tij/saj.

b) Vendimi i Ekspertit Teknik dhe Ekonomik i dhënë në përputhje me Nenin 13.2 do të jetë përfundimtar dhe detyrues për Palët, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

i) Në rastin e një gabimi ose mashtrimi të dukshëm; ose

ii) Në rastin kur njëra nga Palët njofton me shkrim Palën tjeter brenda tridhjetë (30) ditëve pasi vendimi i Ekspertit Teknik dhe Ekonomik t'i jetë njoftuar asaj, duke bërë të njohur synimin për të paraqitur mosmarrëveshjen për gjykim në arbitrazhin ndërkombëtar, me kusht që pala njoftuese të fillojë procedurën e paraqitjes së mosmarrëveshjes përpara arbitrazhit ndërkombëtar, brenda një periudhe të mëtejshme 30-ditore pas dhënies së këtij njoftimi.

c) Të gjitha komunikimet ndërmjet Palëve dhe Ekspertit Teknik dhe Ekonomik apo Autoritetit Emërues do të realizohen me shkrim me kopje të këtij komunikimi dhënë secilës Palë njëkohësisht. Nuk do të zhvillohet asnjë takim ndërmjet Ekspertit Teknik dhe Ekonomi ose Autoritetit Emërues dhe Palëve, përveç nëse Palët kanë një mundësi të arsyeshme për të marrë pjesë në këtë takim.

d) Eksperti Teknik dhe Ekonomik nuk do të konsiderohet se është një arbitër, por do të japë vendimin e tij/saj si ekspert.

e) Secila nga Palët do të përballojë kostot për marrjn e të gjitha të dhënave, informacionit apo pretendimeve me shkrim të vëna në dispozicion si dhe shpenzimet dhe kostot për të gjithë këshilltarët, dëshmitarët, dhe punonjësit që kjo Palë ka bërë, por (nëqftëse Eksperti Teknik dhe Ekonomik nuk shprehet për këto kosto dhe shpenzime, pasi nëse bëhet do të jetë pjesë e vendimit të Ekspertit Teknik dhe Ekonomik), këto kosto dhe shpenzime te Ekspertit

Teknik dhe Ekonomik dhe të çdo këshilltari të tij të pavarur si dhe çdo kosto në lidhje me emërimin e tij/saj nëse emërohet nga Autoriteti Emërues, do t'u ngarkohen Palëve në mënyrë të barabartë.

13.3 Arbitrazhi

13.3.1 Në rast se Palët nuk arrijnë të zgjidhin Mosmarrëveshjet sipas procedurave të paraqitura ne Nenet 13. 1 dhe 13.2 më sipër, atëherë, secila Palë do të ketë të drejtë të kërkoje që Mosmarrëveshja t'i paraqitet për gjykim arbitrazhit ndërkombëtar, siç parashikohet më poshtë.

13.3.2 Nëse njëra Palë dëshiron t'i paraqesë një mosmarrëveshje arbitrazhit ndërkombëtar në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, ajo duhet t'ia njoftojë këtë me shkrim Palës tjetër dhe mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga arbitrazhi ndërkombëtar në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

a) Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga 3 (tre) arbitra, njëri prej të cilëve do të përzgjidhet nga Koncesionari, njëri nga Autoriteti Kontraktues, dhe i treti (i cili do të veprojë si Kryetar i trupit gjykues) do të përzgjidhet bashkërisht nga arbitrat e përzgjedhur nga Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues.

b) Arbitrazhi do të zhvillohet në Paris, Francë.

c) Gjuha e procedurave të arbitrazhit do të jetë anglishtja.

d) Të gjithë dokumentet që paraqiten në lidhje me procedurat e arbitrazhit do te jenë në gjuhën angleze (duke perfshirë dhe njoftimet në gjuhën angleze, parashikuar në Nenin 14.10 më poshtë) ose, në të kundërt, të shoqëruara me një përkthim në gjuhën angleze, të noterizuar.

13.3.3 Çdo vendim arbitrazhi do të jepet në formë të shkruar, duhet të përmbajë arsyet mbi të cilat bazohet dhe do të jetë përfundimtar dhe detyrues për Palët.

13.3.4 Kjo Kontratë së bashku me të drejtat dhe detyrimet e Palëve që rrjedhin prej saj, do të mbetet në fuqi dhe do të ketë efekt deri në daljen e vendimit nga nje proces i tillë arbitrazhi, vendim i cili, kur është e nevojshme, do te përcaktojë mënyrën dhe kohën se kur do te hyje ne fuqi çdo zgjidhje e Kontratës.

14. Të NDRYSHME

14.1 Transferimi – Sigurimi

14.1.1 Konçesionari nuk do të shesë, barrësojë, delegojë ose transferojë në asnjëlloj mënyre të drejtat apo detyrimet e tij sipas apo në përputhje me këtë Kontratë pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues; por, megjithatë, Koncesionari do të ketë të drejtë, në masën e lejuar nga Ligji dhe siç mund të kërkohet në bazë të Dokumenteve Financiare, të hipotekojë, të vendosë barrë, apo të transferojë në ndonjë mënyrë tjetër të drejtat e tij në këte Kontrate si dhe interesat e tij mbi Projektin (përfshirë dhe ato që i nënshtrohen kontratave të tjera në lidhje me Sheshet) për qëllimin e vendosjes së garancive në favor të Palëve Financuese për borxhin e Koncesionarit për financimin e projektit, por ai nuk duhet të vendosë apo ngarkojë ne favor të një pale të tretë ndonjë nga interesat e tij në Projekt.

14.1.2 Çdo shitje, barrësim, delegim ose transferim, e kryer ose e mbetur në tentativë ose e synuar nga Koncesionari i ndonjë prej të drejtave, detyrimeve ose interesave të tij në bazë, sipas ose në përputhje me këtë Kontratë, që nuk pajtohet me kushtet e parashikuara këtu në Nenin 14.1 do të jetë e pavlefshme, pa fuqi ose pasojë.

14.2 Ligji i Zbatueshëm

14.2.1 Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare do të veprojnë në përputhje të plotë me të gjitha Ligjet deri në përfundimin e Afatit.

14.2.2 Pavarësisht Nenit 14.2.1, nëse, si pasojë e një Ndryshimi të Ligjit, Ligjet e zbatueshme të Republikës së Shqipërisë i sjellin Projektit kosto shtesë, Autoriteti Kontraktues do të zhdëmtojë, sipas rastit, Koncesionarin apo Shoqërinë Koncesionare për këto shpenzime shtesë.

14.3 Përgjegjësia, Zhdëmtimi dhe Heqja dorë

14.3.1 Secila Palë duhet të zhdëmtojë Palën tjetër kundrejt pretendimeve nga palë të treta në lidhje me cfarëdo veprimi, mosveprimi apo mospërmbushjeje të Palës zhdëmtuese.

14.3.2 Përveç rasteve kur Kontrata parashikon ndryshe, asnjëra nga Palët nuk do të jetë përgjegjëse kundrejt Palës tjetër për Dëmin e Tërthortë që ka pësuar kjo Palë si rezultat i shkeljes së kësaj Kontrate nga Pala tjetër, përveç rasteve kur ky Dëm është pësuar apo shkaktuar

nga neglizhenca e rëndë apo veprimi i papranueshëm i qëllimshëm i kësaj Pale.

14.3.3 Përveç rasteve kur Kontrata parashikon ndryshe, secila nga Palët do të zhdëmtojë Palën tjetër (Filialet e saj, drejtorët përkatës, funksionarët, punonjësit dhe agjentët) nga dhe kundrejt çdo Dëmi të Drejtpërdrejtë që ka pësuar Pala tjetër si pasojë e shkeljes ose mospërmbushjes së kësaj Kontrate nga Pala e parë.

14.3.4 Secila nga Palët duhet të ndërmarrë çdo masë të mundshme për të shmangur çfarëdolloj dëmi që mund të shkaktohet gjatë kësaj Kontrate.

14.3.5 Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të kryejë kompensimin e detyrimeve, aktuale apo të ardhshme, ndaj Koncesionarit sipas Nenit 14.3, nëpërmjet Pagesës së Koncesionit sipas Nenit 4.1.1(a), me kusht që të zbatohen parimet dhe normat standard të tregut për pretendimet e ardhshme.

14.4 Heqja dorë nga Imuniteti Shtetëror

Autoriteti Kontraktues, si një Entitet Shtetëror, heq dorë në mënyrë të parevokueshme, si përsa i përket vetes ashtu edhe pasurive të tij, nga të drejtat e tij për të pretenduar ndonjë imunitet shtetëror (në çfarëdo lloj juridiksioni), duke përfshirë por pa u kufizuar në imunitetin nga juridiksioni, zbatimi i detyrueshëm, vendimet gjyqësore, urdhrat për sigurimet e padive, ose nga masa të tjera parandaluese ose mbrojtëse (duke përfshirë por pa u kufizuar në ndonjë vendim të dhënë nga një gjykatë arbitrazhi) dhe nga të gjitha lehtësitë dhe Proçedurat e tjera ligjore, si dhe nga çdo imunitet për ndonjë pronë të tij, nga ekzekutimi, si dhe jep pëlqimin për procedime dhe lehtësira të tilla.

14.5 Gjuha

Pa rënë ndesh me Nenin e mësipërm 13.3 (Arbitrazhi), kjo Kontratë lidhet dhe zbatohet në gjuhën angleze, dhe çdo komunikim dhe njoftim ndërmjet Palëve në lidhje me të do të bëhet në gjuhën angleze.

14.6 Ligji rregullues

Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

14.7 Nënkontraktorët

Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata me nënkontraktorë për të ushtruar disa nga të Drejtat Koncesionare, me miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues, miratim i cili nuk duhet të refuzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme, nëqoftë se nënkontraktori i propozuar gëzon aftësitë, reputacionin dhe burimet e mjaftueshme në masën që kërkon ndërmarrja e detyrimeve të tilla; me kusht që, sidoqoftë, miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktues nuk nevojitet për (i) nënkontraktorë të mirënjohur në nivelin ndërkombëtar, në gjendje të mirë financiare ose (ii) nënkontrata shuma e të cilave (të zbatuara nga një kontraktor vetëm ose nga grup nënkontraktorësh, të bashkuar në një projekt) është nën 1,500.000. Euro.

Në lidhje me pikën (i) miratimi i Autoritetit Kontraktues nevojitet në rast se nënkontraktoi është Filial i Koncesionarit dhe kushtet e nënkontratës nuk janë sipas normave të tregut.

14.8 Pozita e Autoritetit Kontraktues si Autoritet Shtetëror

Për shmangien e çdo keqinterpretimi, kjo Kontratë nuk kufizon apo cenon të drejtën e Autoritetit Kontraktues të vendosë të përdorë kompetencat e tij ligjore dhe rregullatore, me kusht që, sidoqoftë, këto kompetenca te ushtrohen në përputhje me Ligjin Shqiptar.

14.9 Fosilet dhe Sendet Antike

14.9.1 Pa rënë ndesh me të drejtat e Koncesionarit për zgjatjen e Afatit të Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut në përputhje me Nenin 7.3, në rast zbulimin apo kur pritet zbulimi i ndonjë fosili apo sendi antik (në Shesh apo jashtë tij), Koncesionari duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues për ndërprerjen e Punimeve në atë Shesh.

14.9.2 Autoriteti Kontraktues duhet që, me marrjen e njoftimit nga Koncesionari të njoftojë autoritetet vendase që janë kompetente dhe të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të siguruar koordinimin e përshpejtuar të kërkimeve të fosileve apo sendeve antike në lidhje me atë Shesh nga ato autoritete.

14.9.3 Në rast se raporti kërkimor i autoriteteve kompetente vendase rekomandon mundësinë e zhvendosjes së sendeve antike apo fosileve nga Sheshi, Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër të gjitha shpenzimet e zhvendosjes së fosileve apo sendeve antike.

14.9.4 Në rast se raporti i shkruar i autoriteteve kompetente vendase evidencon faktin se ndërtimi nuk mund të vazhdojë mbi Sheshin në të cilin u zbuluan fosilet apo sendet antike, Autoriteti Kontraktues mund të vendosë të shikojë mundësinë sipas të cilës ai i siguron Koncesionarit një shesh gjeografikisht të krahasueshëm me sipërfaqe të njëjtë ("Sheshi Zëvendësues") duke marrë përsipër edhe kostot e zhvendosjes së Punimeve drejt Sheshit Zëvendësues, me kusht që, sidoqoftë, Koncesionari t'i japë Autoritetit Kontraktues gjithë ndihmën e mundshme për zvogëlimin e shpenzimeve dhe vonesave përkatëse.

14.10 Njoftimet

14.10.1 Pa rënë ndesh me Nenin 13.3 më sipër (Arbitrazhi), çdo njoftim apo komunikim tjetër i njërës Palë për Palën tjetër, që duhet apo mund të bëhet sipas neneve të kësaj Kontrateje, do të: (i) bëhet në gjuhën angleze; (ii) me shkrim; (iii) dorëzohet personalisht (dorazi) ose do të dërgohet me postë rekomande' ose letër në adresën e Palës tjetër që jepet më poshtë ose në një tjetër adresë të njoftuar nga Pala tjetër, ose do të dërgohet me faks (me konfirmim dërgimi) në numrin e faksit të Palës marrëse ose në një tjetër numër faksi të njoftuar nga Pala tjetër; dhe (iv) dërgohet për personin(at) e caktuar më poshtë ose për të tjerë persona sipas njoftimit nga Pala tjetër.

14.10.2 Çdo njoftim apo komunikim tjetër i njërës Palë për Palën tjetër në përputhje me dispozitat në vijim që përmban ky Paragraf, do të konsiderohet, si i marrë nga Pala tjetër ditën e dorëzimit në adresën e Palës tjetër (duke marrë parasysh ndryshimet që mund të bëhen herë pas here, me njoftim të njërës Palë nga Pala tjetër) nëse dorëzohet dorazi, dyzet e tetë (48) orë nga data e dërgimit nëse dërgohet me postë rekomande', letër të thjeshtë apo faks, në adresat e mëposhtme.

Për Autoritetin Kontraktues:
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Në vëmendje të Shkëlqesisë së Tij, Ministrit
Bul. "Dëshmorët e Kombit", 1001 Tiranë, Shqipëri
Fax: + 355 4 2234052

Për Konçesionarin:
DEVOLL HYDROPOWER SHA
Në vëmendje të Bordit Drejtues
Në përkujdesje të Kalo & Associates
Rruga e Kavajës nr.59,
Tirana Tower, Kati i V-të,
Kutia Postare 235,
Tiranë, Shqipëri
Fax: +355 4 2224727

Për dijeni:
EVN AG
Në vëmendje të Bordit Drejtues
EVN Platz,
A-2344 Maria Enzersdorf,
Austria
Fax: 0043 2236 200 82383
and
STATKRAFT AS
Në vëmendje të Bordit Drejtues
Lilleakerveien 6,
0283 Oslo,
Norway
Fax: +47 24067001

14.11 Vlefshmëria e kësaj Kontrate

Nëqoftë ndonjë kusht apo klauzolë e kësaj Kontrate rezulton i pavlefshëm, i paligjshëm

apo i pazbatueshëm, klauzolat e tjera të Kontratës mbeten të pacenuara.

14.12 Gananci të mëtejshme

Palët duhet të kryejnë gjatë gjithë kohës veprime të mëtejshme dhe të tilla akte apo dokumente të mëtejshme duhet të nënshkruhen dhe dorëzohen në mënyrën e duhur për të përmbushur kërkesat e kësaj Kontrate.

Me miratimin e kësaj Kontrate, Kuvendi i Shqipërisë autorizon Autoritetin Kontraktues që të veprojë dhe të lidhë këtë Kontratë për llogari dhe në emër të Republikës së Shqipërisë, dhe Republika e Shqipërisë bëhet kështu Palë e Kontratës.

14.13 Kontrata si e tërë

Kjo Kontratë përfaqëson, bashkë me Pjesën Hyrëse dhe Shtojcat e bashkëngjitura, kontratën e plotë të nënshkruar ndërmjet Palëve në lidhje me Projektin dhe zëvendëson ndonjë apo çdo kontratë a marrëveshje të mëparshme, verbale apo të shkruar (përfshirë këtu dhe negociatat apo shkëmbimin e informacionit në lidhje me fazën konkurruese të Projektit), nga të njëjtat Palë në lidhje me Projektin.

14.14 Ndalimi i Heqjes Dorë

Nuk do të konsiderohet se është hequr dorë nga ndonjë Palë prej ndonjë dispozite të kësaj Kontrate, përveç kur një dorëheqje e tillë është bërë shprehimisht me shkrim. Mosbërja e përpjekjeve nga secila Palë për të përmbushur saktësisht secilën prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose për të përfituar nga ndonjë prej të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet si heqje dorë nga një dispozitë e tillë ose nga këto drejta në të ardhmen.

14.15 Amendimi dhe Ndryshimi

Kjo Kontratë dhe as ndonjëra nga klauzolat e saj, nuk mund t'i nënshtrohet heqjes dorë, amendimeve apo ndryshimeve, përveç se në rast marrëveshjeje ose marreveshjesh me shkrim të Palëve dhe e drejta e Autoritetit Kontraktues për të pranuar çfarëdo amendim apo ndryshim të kësaj Kontrate është detyruese për Palët, (a) pa miratimin paraprak të Këshillit të Ministrave, dhe (b) ratifikimin nga Kuvendi i Shqipërisë; me kusht që heqjet dorë, amendimet apo ndryshimet në lidhje me (i) të Drejtat Koncesionare, (ii) Pagesën e Koncesionit, (iii) Afatin, (iv) pagesa në rast Zgjidhjeje dhe (v) Veprimet Shtetëroea Thelbësisht të Dëmshme kërkojnë (a) miratimin paraprak të Këshillit të Ministrave dhe (b) ratifikimin nga Parlamenti i Republikës së Shqipërise.

14.16 Konfidencialiteti

14.16.1 Secila Palë duhet të trajtojë si konfidencial dhe nuk duhet, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, t'i japë askujt kushtet e kësaj Kontrate apo çfarëdolloj informacioni që i është dhënë apo vënë në dispozicion për shqyrtim ose dhënë në çdo mënyrë tjetër Palës nga Pala tjetër.

14.16.2 Pavarësisht nga kushtet e Nenit 14.16.1, informacioni mund t'i komunikohet, pa pëlqimin paraprak të Palës tjetër:

a) Një Enti Shtetëror;

b) nga Koncesionari Palëve Financuese ;

c) nga njëra prej Palëve, drejtorëve, funksionarëve, të punësuarve, agjentëve dhe këshilltarëve teknikë dhe profesionistë dhe cilitdo Filial të kësaj Pale e cila mund të kërkojë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave dhe pergjegjësive të saj në lidhje me këtë Kontratë;

d) nga njëra prej Palëve, kontraktorëve dhe furnizuesve në shkallën që ky informacion mund të jetë i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të tyre ne lidhje me këtë Kontratë;

e) nga njëra prej Palëve në shkallën normalisht të nevojshme për nënshkrimin dhe mbajtjen në fuqi të policave të sigurimit;

f) në shkallën e kërkuar nga Ligji, Autorizimet apo rregullat e ndonjë burse të njohur ku ndodhen aksionet e Palës njoftuese (apo të Filialeve të saj);

g) me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo zbatim i të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo Kontratë; dhe

h) në masën që ky informacion është bërë përgjithësisht i disponueshëm për publikun jo si rezultat i shkeljes së detyrimeve të Nenit 14 nga Pala njoftuese;

në çdo rast të tillë, me kusht që, në mënyrë tjetër nga ç'është parashikuar në paragrafët

e mësipërm (i), (vi), (vii) dhe (viii), personi të cilit i është komunikuar informacioni pranon ta mbajë atë të fshehtë dhe të kufizojë përdorimin e tij sipas këtij Neni 14.16.

14.16.3 Çdo informacion i komunikuar në përputhje me këtë Nen 14.16 duhet të përdoret vetëm për një ose disa qëllime që kanë lidhje me këtë Kontratë, dhe për asnjë qëllim tjetër.

Kjo Kontratë Koncesioni është nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar rregullisht të Palëve në Kontratë, në datën, muajin dhe vitin e përmendur më lart.

MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga:_____
Emri: _____
Funksioni: _____

EVN AG

Nga:_____
Emri: _____
Funksioni: _____

STATKRAFT AS

Nga:_____
Emri: _____
Funksioni: _____

DEVOLL HYDROPOWER SHA

Nga:_____
Emri: _____
Funksioni: _____

SHTOJCA A
PËRMBLEDHJE E OFERTËS SË KONCESIONARIT – PËRSHKRIMI TEKNIK

A) Kërkesat Teknike Minimale

a) Projekt-Ideja dhe Projekti i Detajuar

EVN-ja ka përgatitur Projekt-Idenë e saj për Luginën e Devollit me qëllimin kryesor të shfrytëzimit të të gjithë potencialit hidroenergjitik duke arritur ndërkohë fleksibilitetin maksimal në lidhje me prodhimin e energjisë elektrike. Objektivi kryesor i projektit të paraqitur është plotësimi i të gjitha kërkesave të pritshme për energji elektrike duke minimizuar ndikimin mjedisor dhe social.

Projekt-Ideja do të shërbejë si bazë për Projektin e Detajuar i cili do të paraqitet nga Koncesionari në kërkesën e tij për Lejen e Ndërtimit. Projekti i Detajuar mund të devijojë nga Projekt-Ideja si pasojë e shqyrtimeve të hollësishme gjeologjike, hidrologjike, mjedisore dhe teknike që do të kryhen nga Koncesionari pas Datës së Hyrjes në Fuqi, me kusht që, megjithatë këto devijime nuk do të çojnë në një ndryshim në total prej plus/minus 20% të Kapacitetit të

Instaluar siç është parashikuar në këtë Kontratë, gjithnjë nëse përdorimi i potencialit të lumit kryhet nga të paktën tre hidrocentrale. Nëse rezultati i studimeve të hollësishme sugjeron nevojën e një investimi të mëtejshëm për të bërë të mundur pajisjen e Çentraleve me funksionet e një sistemi të grumbullimit dhe të pompimit me një kapacitet shtesë prej 200 MW, Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues do të negociojnë në mirëbesim nëse dhe në ç'masë do të kryhet ky investim shtesë për një sistem grumbullimi dhe pompimi.

Në rastet e shpronësimit të tokës sipas kësaj Marrëveshje, Koncesionari do të respektojë dhe ruajë të drejtat ekzistuese të palëve të treta për të marrë ujë për vaditje për aq sa këto të drejta janë autorizuar ligjërisht dhe faktikisht përdoren në Datën e Fillimit.

b) Strukturimi i centraleve

Zona e Projektit ndodhet rreth 70 km në jug të Tiranës dhe përfshin rajonin malor të rrjedhës së mesme dhe të sipërme të Lumit Devoll midis fshatrave Maliq dhe Banjë.

Zhvillimi me tre faza, përdor të tërë potencialin hidraulik të Lumit Devoll midis lartësive 810 m nga niveli i detit dhe 95 m nga niveli i detit, përbëhet nga tre çentrale hidroenergjitike (sipas rendit nga lartë poshtë).

Çentrali Hidro-Energjitik	Zbrazja e Projektuar	Kapaciteti i Instaluar	Prodhimi Mesatar
Lozhan-Grabovë	40,0 m3/s	160 MW	468 GWh/Vit
Skënderbegas-Çekin	72,5 m3/s	114 MW	321,5 GWh/Vit
Banjë	79,0 m3/s	45 MW	195,7 GWh/Vit
Total		319 MW	


c) Jetëgjatësia e Pritshme e Projektit dhe Standartet e Ndërtimit

Jetëgjatësia e Pritshme e Projektit dhe standartet e ndërtimit do të jenë në përputhje me praktikat e mira të industrisë dhe me standartet europiane.

B) Shfrytëzimi i potencialit hidro-energjitik të Lumit Devoll

Zona e Projektit ndodhet rreth 70 km në jug të Tiranës dhe përfshin rajonin malor të rrjedhës së mesme dhe të sipërme të Lumit Devoll.

Bazuar në studimet e ekspertëve shqiptarë që prej vitit 1995, në analizat dhe përpunimin e të dhënave hidrologjike shtesë, dhe në vlerësimin e mjeteve të arsyeshme të ndërmarra në vitin 2007, është përgatitur një projekt me tre faza për të shfrytëzuar të tërë potencialin hidraulik të Lumit Devoll nga lartësia 810 m nga niveli i detit në lartësinë 95 m nga niveli i detit. Zgjidhja e propozuar nga EVN-ja konsiston në tre çentralet hidro-energjitike vijuese (në bazë të lartësisë gjatë rrjedhjes së lumit): Lozhan-Grabovë, Skënderbegas-Çekin and Banjë. Dy centralet e para janë struktura të rëndësishme me kapacitet vjetor grumbullimi dhe çentrali që ndodhet më poshtë ka si qëllim rregullimin e rrjedhjeve të ndryshueshme gjatë ditës së dy centraleve të sipërme.



Përveç këtij propozimi, është studiuar edhe një variant tjetër për çentralin e mesëm, si dhe mundësia për të zhvilluar çentralin e epërm si një strukturë grumbullimi dhe pompimi. Për këtë variant struktura e mesme do të jetë projekti në Bratile-Çekin, i zhvilluar direkt në Luginën e Devollit dhe do të zëvëndësojë projektin në Skënderbegas-Çekin.

Zona e projektit përfshin të tërë Luginën e Devollit midis fshatit Maliq, e ndodhur në kufirin e pllajës së Korçës dhe fshatit Banjë rreth 40 km në jug të Tiranës. Nga ana topografike projekti shkon nga pllaja e lartë në Korçë deri poshtë në rrethinat e valëzuara të Gramshit duke kaluar nga zona malore e mesit të rrjedhjes së lumenjve Devoll dhe Tomorricë.

Në këtë kontekst të zhvillimit të energjisë hidrike është përgatitur edhe një variant për një skemë grumbullimi dhe pompimi për strukurën e epërme atë në Lozhan-Grabovë, më dy kapacitete të mundshme për pompat.

C) Projekti hidro-energjitik Lozhan-Grabovë

Vendndodhja

Projekti hidro-energjitik Lozhan-Grabovë ndodhet në rrjedhën e epërme të Lumit Devoll. Diga ndodhet afër fshatit Lozhan dhe shtrirja e rezervuarit të epërm arrin në qytezën e Maliqit, i cili ndodhet në fillim të luginës, në kufirin e pllajës së madhe të Korçës, ndërsa vendodhja e çentralit nëntokësor është rreth 20 km më poshtë se vendodhja e digës, në afërsi të fshatit Grabovë në bregun e djathtë të lumit.

Ky projekt është projekti i epërm prej strukturës prej tre-fazash në Luginën e Devollit dhe diferenca midis propozimit dhe variantit tjetër është vetëm gjatësia e tunelit dhe si rrjedhojë kapaciteti i instaluar.

Hidrologjia

HEC-i Lozhan-Grabovës ndodhet në pjesën e epërme të rrjedhës së ujërave të Devollit dhe ka një zonë ujëmbledhëse prej 1310 km2. Përveç kësaj, degët anësore e sjellin ujin nga Lumi Osoja, Lumi Çemerica (furnizues të Malësit) dhe Lumi Strelcë dhe zgjerojnë zonën ujëmbledhëse në rreth 1476 km2 (9% më shumë), e cila është pak më pak se gjysma e të gjithë masës ujore të Devollit.

Volumi ujor mesatar vjetor llogaritet në 470 km3 dhe zbrazja e projektuar është 10

l/s/km², që mund të konsiderohet si potencial specifik i vogël për Shqipërinë.

Gjeologjia dhe sizmologjia

Në lidhje me gjeologjinë zona e projektit të HEC-it në Lozhan-Grabovë kalon nëpër katër zona tektonike që lëvizin në drejtimin Veri-Jug. Shtresa e shkëmbit në Luginën e Devollit përbëhet nga shtresa eoçene (gurë gëlqerorë - argjil) të hershme të epokës së kretaçit dhe nga sekuenca gurësh gëlqerorë, që kanë elementë opiolitikë të ndara nga zonat tektonike melangjike të të dyja serive.

Situata gjeologjike e rezervuarit, e vendndodhjes së digës, të tunelit kryesor dhe të shpellës së çentralit si dhe të tunelit fundor ishte e hedhur keqas në harta, përpara një vëzhgimi në vend në vitin 2007. Këndet e rezervuarit mendohet të veprojnë mirë ose shkëlqyeshëm gjatë mbylljes dhe tharjes. Vetitë e mira ose të shkëlqyeshme gjeologjike të shtresës së shkëmbit në vendndodhjen e digës lejojnë ndërtimin e çdo lloj dige, edhe atyre në formë harku.

Tuneli me drejtim lindje-perëndim duhet ndërtuar përmes të tërë shtresave tektonike në Luginën e Devollit me një koncept të saktë në ndërtimin e tuneleve. Aksi, shpella e çentralit dhe pjesë të tunelit dalës ndodhen në shtresa guri opiolitik në kushte gjeofizike të mira ose të shkëlqyeshme.

Shqipëria është një nga vëndet më sizmike në Europë. Në gjendjen aktuale të projektit një vlerësim sizmologjik i zonës së projektit është bërë duke përdorur botimet e ekspertëve shqiptarë si dhe nga të dhënat e tërmeteve në rajon. Vlerat e shpejtimit horizontal për OBE dhe MCE për digën dhe strukturat ndihmëse janë vlerësuar deri diku.

Elementë të përgjithshëm

Elementët e përgjithshëm të propozimit me një zbrazje të projektuar prej 40 m^3/s dhe një maksimum mesatar prej 425 m janë:

- Një rezervuar i epërm, i quajtur Lozhan, me volum total grumbullimi prej 266 milion m^3 dhe një volum vjetor të ngarkuar me elektricitet prej 118 milion m3. Nivelet maksimale dhe minimale të operimit janë caktuar në lartësitë 810 dhe 783.5 m nga niveli i detit, që sjell një lëvizje prej 19.5 m gjatë një viti hidrologjik.

Rezervuari do të bëhet nga një dampë betoni 144,5 m e lartë. Shtrati i lumit (Talweg) në aksin e dampës ka një lartësi prej 662 m nga niveli i detit dhe kurora e dampës është 806,5 m nga niveli i detit. Një sistem me 4 porta dhe 2 dalje në rrëzë janë pjesët përbërëse të dampës. Zbrazja e projektuar për sistemin e rrjedhjes është 530 m^3/s.

- Tre drejtime dytësore të gjendura në lumenjtë Çemericë, Osojë dhe Strlece sjellin ujin e zonave ujëmbledhëse që janë afër drejt në serbatorin e epërm përmes tunelit hyrës. Zbrazjet e projektuara të këtyre drejtimeve dytësore janë 4.5; 3.5 dhe 0.95 m^3/s. Uji prej drejtimeve të Çemericës dhe Osojës rrjedh lirshëm përmes një tuneli 11 km të gjatë më një seksion të tipit harkor, ndërsa uji nga Strelce do të sillet përmes një aksi të shkurtër lidhës drejt në tunelin hyrës.
- Një strukturë anësorë e brëndshme me lartësi të invertuar në 773.9 m nga niveli i detit.
- Një tunel hyrës 16.3 km i gjatë me një diametër të brendshëm prej 4.30 m.
- Një aks i rrjedhës nga lart prej 120 m të lartë me diametër të brendshëm prej 10 m.
- Një aks presioni 420 m të lartë me diametër të brendshëm prej 3.40 m në pjesën e epërme të betonit dhe 3.20 m në pjesën e poshtme të çelikut.
- Një çentral nëntokë me kapacitet të instaluar prej 160 MW, me dy turbina vertikale Francis. Niveli fillestar është caktuar në lartësinë 306.0 m nga niveli i detit.
- Një aks i rrjedhës së poshtme prej 64 m të lartë me dimensionet gjerësi me gjatësi 18.0 me 29.5 m.
- Një tunel dalës 11 km i gjatë me diametër të brendshëm prej 5.00 m, i cili hyn direkt në rezervuarin e projektit hidro-energjitik Skënderbegas-Çekin me nivele normale rezeruari prej 350.0 në 325.3 m nga niveli i detit.

Elementët e përgjithshëm të variantit tjetër kanë të njëjtën zbrazje të projektuar prej 40.0 m^3/s por me një maksimum mesatar prej vetëm 350 m. Në një kohë që rezervuari i epërm dhe drejtimet dytësore janë të njëjta me ato të propozimit, sistemi i drejtimit të ujit në rezervuarin e poshtëm përbëhet nga:

Një tunel hyrës 16.1 km i gjatë me një diametër të brendshëm prej 4.30 m.

- Një aks i rrjedhës së lartë prej 115 m të lartë me diametër të brendshëm prej 10.0 m.

- Një aks presioni 330 m të lartë me diametër të brendshëm prej 3.40 m në pjesën e epërme të betonit dhe 3.20 m në pjesën e poshtme të çelikut.

- Një çentral nëntokë me kapacitet të instaluar prej 130 MW, me dy turbina Francis. Niveli fillestar është caktuar në lartësinë 398.0 m nga niveli i detit.

- Një tunel dalës 5000 m i gjatë me diametër të brendshëm prej 4.30 m, i cili hyn drejt në rezervuarin e projektit hidro-energjitik Bratile-Çekin me nivele normale rezeruari prej 445.0 në 403.6 m nga niveli i detit.

Prodhimi i energjisë dhe kostot e investimit

Për shkak të kapacitetit të lartë të grumbullimit, projekti Lozhan-Grabovë lejon prodhimin në pikën kulmore për gjatë një viti mesatar hidrologjik. Energjia mesatare e prodhuar do të jetë 468 GWh për propozimin dhe 386 GWh për variantin tjetër.

Kosto e investimit për projektin e propozuar Lozhan-Grabovë është llogaritur në 455.7 milion euro, të ndara në 338.3 milion ndërtimet, 1.2 milion për punimet hidromekanike, 18.2 milion për pajisjet mekaniket, 26.4 milion për pajisjet elektrike dhe 71.6 milion për shpenzime të ndryshme si blerja e tokës, shpërnguljet, zhvendosja e rrugëve shtetërore, shqyrtimet, studimet dhe lidhja me sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

Kosto e investimit për projektin e variantit tjetër Lozhan-Grabovë është llogaritur në 364.3 milion euro, të ndara në 274.5 million për ndërtimet, 1.2 milion për punime hidromekanike, 16.6 milion për pajisjet mekanike, 17.7 milion për pajisjet elektrike dhe 54.3 milion për shpenzime të ndryshme si blerja e tokës, shpërnguljet, zhvendosja e rrugëve shtetërore, shqyrtimet, studimet dhe lidhja me rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike.

Ndikimi social dhe mjedisor, masat për zbutjen e efekteve

Lugina e Devollit është pjesë e një rajoni relativisht me popullsi të shpërndarë, në jug-lindje të Shqipërisë. Megjithatë një projekt i këtyre përmasave shkakton ndryshime në strukturën e zonës së prekur. Si pasojë e mbylljes së rezervuarit Lozhan, pjesa e epërme e Luginës së Devollit do të përmbytet për një gjatësi prej rreth 13.8 km. Është vlerësuar ndikimi social dhe mjedisor si edhe masat për zbutjen e efekteve që janë: zhvendosja e pjesës më të madhe të fshatit Zvarisht, rindërtimi i infrastrukturës ekzistuese, rindërtimi i rrugëve etj. Ka ndikim të vogël në tokën bujqësore të përdorur.

D) Projekti hidro-energjitik Skënderbegas-Çekin

Vendndodhja

Rezervuari i projektit Skënderbegas-Çekin ndodhet në afërsi të fshatit Skënderbegas në Luginën e Tomorricës, një luginë anësore nga e majta ndaj asaj të Devollit, kurse çentrali ndodhet në bregun e majtë të Lumit të Devollit afër fshatit Çekin, që ndodhet nga bregu tjetër (bregu i djathtë) i lumit. Uji i turbinave të projektit të epërm dhe uji i zonës ujëmbledhëse të projektit të mesëm do të çohen përmes një tuneli shumë të gjatë në rezervuarin e Skënderbegasit.

Ky është projekti i mesëm nga struktura prej tre fazash në Luginën e Devollit.

Hidrologjia

HEC-i Skënderbegas-Çekin ndodhet në Lumin Tomorricë, i cili është furnizuesi më i madh i Lumit të Devollit. Zona ujëmbledhëse është 290 km2. Së bashku me ujin e dalë nga HEC-i Lozhan-Grabovë dhe dega anësore e lumenjve Devoll dhe Grabovë, zona ujëmbledhëse shkon në rreth 2136 km2, që është rreth 70% e të tërë masës ujore të Devollit.

Volumi ujor mesatar vjetor llogaritet në 824 hm3 dhe kjo është nxjerrë nga vlerësimi i stacioneve të tjera në rrjedhën e Devolli sepse nuk ka pasur të dhëna hidrologjike për Lumin e Tomorricës (shiko Pjesën I – zhvillimi i Energjisë Hidro). Zbrazja e plotë është 12 l/s/km², që mund të konsiderohet si potencial specifik i vogël për Shqipërinë.

Aktiviteti gjeologjik dhe sizmologjik

Zona e projektit ndodhet rreth 70 km në jug të Tiranës dhe përfshin rajonin malor të rrjedhjes së ulët të Lumit Tomorricë dhe rrjedhjen e mesme të Lumit Devoll. Nga ana gjeologjike zona e projektit ndodhet në kompleksion opiolitik të Devollit (Dritarja e Miriditës) në lindje dhe gurët gëlqerorë të kretaçit të sipërm dhe gurë gëlqerorë të Malit Tomorr (Zona e Krujës) në perëndim dhe shtrihet në zonën midis Krujës dhe Detit Jon. Shtresat e gurit në

luginat e Devollit dhe të Tomorricës përbëhen nga shtresa të alternuara prej argjilash, argjilash të pjesshme dhe gurësh, së bashku me shtresa gurësh detrital dhe oliostromesh.

Situata gjeologjike e rezervuarit, e vendndodhjes së digës, të tunelit kryesor dhe të shpellës së çentralit si dhe të tunelit fundor ishte e hedhur keqas në harta, përpara një vëzhgimi në vend më vitin 2007. Këndet e rezervuarit mendohet të veprojnë mirë ose shkëlqyeshëm gjatë mbylljes dhe tharjes.

Forma e luginës dhe shtresat e gurit dhe materialet e shumta sugjerojnë ndërtimin e një dige me mbushje dheu ose shkëmbinjsh, si më të përshtatshmen për këtë rast.

Tuneli me drejtim Jug-Veri duhet ndërtuar përmes të tërë shtresave tektonike që bëjnë të mundur ndërtimin e një TBM-je me dy shtresa. Aksi dhe çentrali gjenden në kushte të njëjta gjeologjike.

Shqipëria është një nga vendet më sizmike në Evropë. Në gjendjen aktuale të projektit është bërë një vlerësim sizmologjik i zonës së projektit, duke përdorur botimet e ekspertëve shqiptarë si dhe nga të dhënat e tërmeteve në rajon. Janë vlerësuar deri diku vlerat e shpejtimit horizontal për OBE dhe MCE për digën dhe strukturat ndihmëse.

Elementë të përgjithshëm

Elementët e përgjithshëm të fazës së mesme të propozuar të projektit me një zbrazje të projektuar prej 72.5 m3/s dhe një maksimum mesatar prej 160 m janë:

- Një rezervuar i epërm, i quajtur Skënderbegas, me volum total grumbullimi prej 124.7 milion m3 dhe një volum vjetor të ngarkuar me elektricitet prej 82.5 milion m3. Nivelet maksimale dhe normale të operimit janë caktuar në lartësitë 350 dhe 325.3 m nga niveli i detit, që sjell një lëvizje prej 24.7 m gjatë një viti të keq hidrologjik.

Rezervuari do të bëhet nga nje dampë me qendër argjili 88 m e lartë. Shtrati i lumit (Talweg) në aksin e dampës ka një lartësi prej 276 m nga niveli i detit dhe kurora e dampës është 355 m nga niveli i detit.

- Një sistem rrjedhje me 2 porta, një kurorë në lartësinë 350 m nga niveli i detit dhe një ujëvarë betoni me një mbledhës në fund. Zbrazja e projektuar për rrjedhjet është 320 m3/s.
- Një tunel hyrës 11.0 km i gjatë në strukturën e epërme Lozhan-Grabovë me diametër të brendshëm 5.00 m i cili e sjell ujin e turbinave të kësaj strukture direkt e në rezervuarin Skënderbegas. Si rrjedhojë ky element është edhe pjesë e strukturës së poshtme.
- Dy drejtime dytësore, njëri i ndodhur në Çarjen e Grabovës dhe tjetri në Lumin Devoll, të dy afër çentralit nëntokësor të shkallës së epërme, që sjellin ujin nga zonat e mbledhjes direkt e në dhomën e rrjedhjes për nga poshtë të strukturës së epërme Lozhan-Grabovë. Zbrazjet e projektuara të të dy drejtimeve dytësore janë 6.2 dhe 12.5 m3/s dhe gjatësitë e tuneleve dytësore janë 1’000 dhe 1’550 m.
- Një strukturë anësore marrje me lartësi të invertuar në 313.7 m nga lartësia e detit.
- Një tunel hyrës 16.5 km i gjatë me diametër të brendshëm prej 5.8 m.
- Një aks ndarës 120 m të lartë me diametër të brendshëm prej 15.0 m
- Një aks presioni 115 m të lartë me diametër të brendshëm prej 4.60 m në pjesën e sipërme të betonit dhe 4.30 m në pjesën e poshtme të çelikut.
- Një çentral i hapur me kapacitet të instaluar prej 114 MW me dy turbina vertikale Francis. Niveli fillestar është caktuar në lartësinë 155.3 m nga niveli i detit.
- Një strukturë e shkurtër dalëse e cila hyn drejt në rezervuarin e projektit hidro-energjitik Banjë me nivele maksimale dhe minimale rezeruari prej 165.0 në 161.6 m nga niveli i detit.

Prodhimi i energjisë dhe kostot e investimit

Për shkak të kapacitetit të lartë të grumbullimit, si edhe të ujit të turbinave të çentralit të epërm, projekti Skënderbegas-Çekin lejon prodhimin në pikën kulmore për gjatë një viti mesatar hidrologjik. Energjia mesatare e prodhuar do të jetë 321.5 GWh.

Kosto e investimit për projektin e propozuar Lozhan-Grabovë është llogaritur në 357 milion euro, të ndara në 263.1 milion për ndërtimet, 0.6 milion për punimet hidromekanike, 19.9 milion për pajisjet mekaniket, 27.0 milion për pajisjet elektrike dhe 46.4 milion për shpenzime të ndryshme si blerja e tokës, risistemimi, rregullimi i rrugëve shtetërore, hetime, studime dhe lidhje me rrjetin elektrik.

Kosto e investimit për projektin e variantit tjetër Lozhan-Grabovë është llogaritur në

364.3 milion euro, të ndara në 274.5 million për ndërtimet, 1.2 milion për punime hidromekanike, 16.6 milion për pajisjet mekanike, 17.7 milion për pajisjet elektrike dhe 54.3 milion për shpenzime të ndryshme si blerja e tokës, shpërnguljet, zhvendosja e rrugëve shtetërore, shqyrtimet, studimet dhe lidhja me sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

Ndikimi social dhe mjedisor, masat për zbutjen e efekteve

Si pasojë e mbylljes së rezervuarit Skënderbegas, pjesa e epërme e Luginës së Tomorricës do të përmbytet për një gjatësi prej rreth 5.8 km. Është vlerësuar ndikimi social dhe mjedisor si edhe masat për zbutjen e efekteve që janë: zhvendosja e pjesës më të madhe të fshatit Zvarisht, rindërtimi i infrastrukturës ekzistuese, rindërtimi i rrugëve etj. Ka ndikim të vogël në tokën bujqësore të përdorur.

E) Projekti hidro-energjitik Bratile-Çekin

Vendndodhja

Projekti hidro-energjitik Bratile-Çekin ndodhet në pjesën e mesme të Lumit Devoll. Dampa ndodhet në afërsi të fshatit Bratile dhe zgjatimi i rezervuarit arrin fshatin Moglicë, në bregun e djathtë të luginës. Vendodhja e çentralit të hapur është në bregun e djathtë të lumit rreth 25 km nën vendndodhjen e dampës afër fshatit Çekin.

Ky projekt është i mesmi nga varianti prej tre fazash i Luginës së Devollit.

Hidrologjia

HEC-i Bratile-Çekin ka një zonë ujëmbledhëse prej 1880 km2. Përveç kësaj, një zgjatim anësor do ta devijojë ujin nga Lumi Tomorricë dhe do ta shtojë zonën ujëmbledhëse në rreth 2060 km2.

Volumi ujor mesatar vjetor llogaritet në 840 km3 dhe zbrazja specifike është 13 l/s/km², që mund të konsiderohet si potencial specifik i vogël për Shqipërinë.

Gjeologjia dhe sizmologjia

Zona e projektit është rreth 65 km në jug të Tiranës dhe përfshin rajonin malor të rrjedhjes së mesme të Lumit Devoll.

Nga ana gjeologjike HEC-i i Bratile-Çekin kalon tre zona tektonike që lëvizin në drejtimin Veri VeriPerëndim-Jug JugLindje. Shtrati i shkëmbit në Luginën e Devollit përbëhet nga një trup opiolitik të fiksuar në një shtresë të herëshme kretaçeoze dhe eoçene (gurë gëlqere - argjil) dhe vazhdime gurësh gëlqerorë të ndara nga zonat tektonike melangjike të të dyja serive.

Situata gjeologjike e rezervuarit, e vëndndodhjes së digës, të tunelit kryesor dhe të shpellës së çentralit si dhe të tunelit fundor ishte e hedhur keqas në harta, përpara një vëzhgimi në vend në vitin 2007. Këndet e rezervuarit mendohet të veprojnë mirë ose shkëlqyeshëm gjatë mbylljes ose tharjes. Këndet e rezervuarit mendohet të veprojnë mirë ose shkëlqyeshëm gjatë mbylljes dhe tharjes. Vetitë e mira ose të shkëlqyeshme gjeologjike të shtresës së shkëmbit në vendndodhjen e digës lejojnë ndërtimin e çdo lloj dige, edhe atyre në formë harku.

Tuneli me drejtim Jug-Veri duhet ndërtuar përmes të tërë shtresave tektonike të zonave të Krujës dhe të Jonit prezente në Luginën e Devollit me një koncept të përshtatshëm të tuneleve (të papërshtatshëm për kushte të mira). Aksi, çentrali dhe tuneli dalës ndodhen në një seri shtresash me kushte gjeologjike të papërshtatshme në të mira.

Shqipëria është një nga vendet më sizmike në Evropë. Në gjendjen aktuale të projektit një vlerësim sizmologjik i zonës së projektit është bërë duke përdorur botimet e ekspertëve shqiptarë si dhe nga të dhënat e tërmeteve në rajon. Janë vlerësuar deri diku vlerat e shpejtimit horizontal për OBE dhe MCE për digën dhe strukturat ndihmëse.

Elementë të përgjithshëm

Elementët e përgjithshëm të projektit të mesëm të variantit tjetër me një zbrazje të projektuar prej 70.8 m3/s dhe një maksimum mesatar prej 240 m përbëhen nga:

- Rezervuari i Bratiles, me volum total grumbullimi prej 139.6 milion m3 dhe një volum vjetor të ngarkuar me elektricitet prej 90.0 milion m3. Nivelet maksimale dhe normale të operimit janë caktuar në lartësitë 445.0 dhe 403.63 m nga niveli i detit, që sjell një lëvizje prej 41,1 m gjatë një viti të keq hidrologjik.

Rezervuari do të bëhet nga nje dampë me qëndër argjili 138.0 m të lartë. Shtrati i lumit (Talweg) në aksin e dampës ka një lartësi prej 312.0 m nga niveli i detit dhe kurora e dampës

është 450.0 m nga niveli i detit.

- Një sistem rrjedhje me 6 porta, një kurorë në lartësinë 445,1 m nga niveli i detit dhe një ujëvarë betoni me një mbledhës në fund. Zbrazja e projektuar për rrjedhjet është 880 m3/s.
- Dalje dytësore anësore që sjell ujin nga zona ujëmbledhëse në rezervuarin Bratile me një tunnel 10.7 km të gjatë.
- Një strukturë anësore marrje me lartësi të invertuar në 392.0 m nga lartësia e detit.
- Një tunel hyrës 21.2 km i gjatë me diametër të brendshëm prej 5.80 m.
- Një aks ngritës 125 m të lartë me diametër të brendshëm prej 18.0 m
- Një aks presioni 195 m të lartë, një zgjatje horizontale prej 1'840 m me diametër të brendshëm prej 4.60 m në pjesën e sipërme të betonit dhe 4.30 m në pjesën e poshtme të çelikut.
- Një çentral i hapur me kapacitet të instaluar prej 165 MW me dy turbina vertikale Francis. Niveli fillestar është caktuar në lartësinë 155.3 m nga niveli i detit.
- Një strukturë e shkurtër dalëse e cila hyn drejt në rezervuarin e projektit hidro-energjitik Banjë me nivele maksimale dhe minimale rezeruari prej 165.0 në 161.6 m nga niveli i detit.

Prodhimi i energjisë dhe kostoja e investimit

Për shkak të kapacitetit të lartë të grumbullimit, si edhe të ujit të turbinave të çentrali të epërm projekti Bratile-Çekini lejon prodhimin në pikën kulmore për gjatë një viti mesatar hidrologjik. Energjia mesatare e prodhuar do të jetë 471.2 GWh.

Kosto e investimit për projektin e propozuar Lozhan-Grabovë është llogaritur në 531.7 milion euro, të ndara në 398.6 milion ndërtime, 0.7 milion për punimet hidromekanike, 28.2 milion për pajisjet mekaniket, 35.8 milion për pajisjet elektrike dhe 68.4 milion për shpenzime të ndryshme si blerja e tokës, shpërnguljet, zhvendosja e rrugëve shtetërore, shqyrtimet, studimet dhe lidhja me sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

Ndikimi social dhe mjedisor, masat për zbutjen e efekteve

Lugina e Devollit është pjesë e një rajoni relativisht me popullsi të shpërndarë, në jug-lindje të Shqipërisë. Megjithatë një projekt i këtyre përmasave shkakton ndryshime në strukturën e zonës së prekur. Si pasojë e mbylljes së rezervuarit Bratile, pjesa e mesme e Luginës së Devollit do të përmbytet për një gjatësi prej rreth 12.5 km. Megjithëse lugina e përmbytshme nuk është e banuar ndikimi social dhe mjedisor është vlerësuar ashtu si edhe masat për zbutjen e efekteve që janë: rindërtimi i rrugës Gransh-Korçë për mbi 12 km, mundësisht me anë të një tuneli etj. Ndikimi në tokën bujqësore të përdorur është i vogël.

F) Projekti hidro-energjitik Banjë

Vendndodhja

Dampa e skemës hidro-energjitike Banjë ndodhet në pjesën e poshtmë të Lumit Devoll, afër fshatit Banjë që ndodhet në bregun e djathtë të luginës. Zgjerimi i rezervuarit arrin fshatin Çekin, që ndodhet në bregun e djathtë të luginës rreth 2 km në vazhdim të qytetit të Gramshit. Çentrali ndodhet në fillim të digës në bregun e majtë të lumit.

Ky projekt është i fundit nga skema prej tre shkallësh i Luginës së Devollit dhe mund të përdoret për të dy variantet atë të propozuarin dhe variantin tjetër. Ky projekt ndihmon në mbrojtjen e pjesës së poshtme të Luginës së Devollit nga përmbytjet katastrofike.

Hidrologjia

HEC-i Banjë ka një zonë ujëmbledhëse prej rreth 2890 km2, që është rreth 92% i të tërë rrjedhës së ujit të Devollit. Volumi ujor mesatar vjetor llogaritet në 1295 hm3. Zbrazja specifike është 14 l/s/km², që mund të konsiderohet si potencial specifik i vogël ose mesatar për Shqipërinë.

Gjeologjia dhe sizmologjia

Raporti për HEC-in në Banjë është i lidhur ngushtë me të dhëna gjeoteknike të projektit origjinal, të hetimeve dhe eksplorimeve të bëra në vitin 1980 (vendndodhja e dampës, terreni, disponueshmëria e materialeve, stabiliteti i këndeve të rezervuarit). Një verifikim i raporteve më të herëshme tregoi për një punë të kuptueshme dhe për njohje të mirë të terrenit. Një udhëtim në terren më 2007 ndihmoi për sqarimin e projektit të vjetër.

Zona e projektit ndodhet rreth 45 km në vijë ajrore në jug të nga Tiranës në një rajon të valëzuar në rrjedhën e poshtme të Lumit Devoll. E ndodhur në zonën e Krujës nga Gramshi në Dushk, dhe me pjesën më lindore të zonës Joniane nga Dushku në Banjë, gjeologjia konsiston në shtresa paleogjenike të mbajtura nga sedimente aluvionale dhe diluvionale, që kanë krijuar një gjeometri në formë tarrace në të dyja anët e luginës. Shtresat e shkëmbit gjatë Luginës së Devollit përbëhen nga shtresa të alternuara argjilës, gjysëm argjile dhe gurësh së bashku me gurë gëlqerorë.

Bazuar në raportet e udhëtimit më vitin 2007, këndet e rezervuarit duhet të punojnë mirë gjatë mbylljes dhe tharjes. Këneta dhe rrëshkitje mund të ketë si pasojë e ndërprerjes së lëvizjes së masave të ujit, por, nuk pritet të ketë lëvizje të mëdha.

Shqipëria është një nga vëndet më sizmike në Europë. Në gjendjen aktuale të projektit një vlerësim sizmologjik i zonës së projektit është bërë duke përdorur botimet e ekspertëve shqiptarë si dhe nga të dhënat e tërmeteve në rajon. Vlerat e shpejtimin horizontal për OBE dhe MCE për digën dhe strukturat ndihmëse janë vlerësuar në mënyrë të përgjithshme.

Elementë të përgjithshëm

Elementët e përgjithshëm të projektit me zbrazje të projektuar prej 79.0 m3/s dhe një maksimum mesatar prej 65.0 m përbëhet nga:

- Një dampë 76 m të lartë me qëndër argjile;
- Rezervuari banjë me volum total grumbullimi prej 300.3 milion m3 dhe kapacitet vjetor grumbullimi prej 36.7 milion m3. Nivelet maksimale dhe minimale të veprimeve janë caktuar në lartësitë 165.0 dhe 161.6 m nga niveli i detit, që sjell një ndryshim prej 3,0.4 m në vit.
- Një sistem rrjedhje me 5 porta, një kurorë në lartësinë 155.1 m nga niveli i detit dhe një rrepirë betoni me një mbledhës në fund. Zbrazja e projektuar për rrjedhjet është 2’270 m3/s.
- Një strukturë të brendshme marrje me lartësi invertimi prej 145.0 m nga lartësia e detit.
- Një tunël hyrës i shkurtër, i realizuar pjesërisht, i gjatë 450 m dhe me diametër të brendshëm prej 6.2 m.
- Një portë uji 600 m të gjatë.
- Një central i hapur i vendosur në fillim të dampës me kapacitet total të instaluar prej 45 MW, që ka tre turbine vertikale Francis.
- Një tunel dalës me gjatësi prej 250 m dhe gjërësi 35.0 m.

Prodhimi i energjisë dhe kostot e investimit

Energjia mesatare e prodhuar do të jetë 195.7 GWh.

Kosto e investimit për projektin e propozuar Lozhan-Grabovë është llogaritur në 137.6 milion euro, të ndara në 67.9 milion ndërtimet, 10.4 milion për punimet hidromekanike, 17.9 milion për pajisjet mekaniket, 19.0 milion për pajisjet elektrike dhe 22.4 milion për shpenzime të ndryshme si blerja e tokës, risistemeimi, rregullimi i rrugëve shtetërore, hetime, studime dhe lidhje me rrjetin elektrik.

Impakti social dhe mjedisor, masa për zbutjen e efekteve

Si pasojë e mbylljes së rezervuarit Banjë, pjesa e poshtme e Luginës së Devollit do të përmbytet për një gjatësi prej rreth 13.5 km. Impakti social dhe mjedisor është vlerësuar ashtu si edhe masat për zbutjen e efekteve që janë: ndryshim vendndodhje e disa shtëpive afër rezervuarit dhe rindërtimi i infrastrukturës ekzistuese (një godinë shkolle, rindërtimi i rrugëve dhe urave etj).

Ka efekte tek tokat bujqësore të përdorura, që do të analizohen për vlerën që kanë. Bazuar në zgjidhje individuale do gjenden edhe masat për zbutjen e fekteve.

Përfundimisht impakti do të jetë shumë herë më i vogël se projekti i vjetër i Banjës me nivelin e tij të mbylljes në 195 m nga niveli i detit.

G) Varianti për skemën e grumbullimit dhe pompimit Lozhan

Mundësi shtesë për planin e zhvillimit të Lumit Devoll

Në kontekstin e zhvillimit hidro-energjitik të të tërë Luginës së Devollit me zgjidhjen me tre shkallë, EVN-ja ka analizuar se si të kalohet nga çentrali i epërm hidro-energjitik

Lozhan-Grabovë në një çentral hidro-energjitik me skemë grumbullimi dhe pompimi si një mundësi shtesë.

Vendndodhja, hidrologjia dhe gjeologjia

Vendndodhja e strukturave të ndryshme të skemës së grumbullimit dhe pompimit, si dhe kushtet hidrologjike dhe gjeologjike, janë të njëjta me ato të projekteve të propozuara Lozhan-Grabovë, por, pa pompa të instaluara.

Elementë të përgjithshëm

Elementët e përgjithshëm të strukturave të ndryshme të skemës së rezervuarit me dalje dytësore dhe të sistemit të mbledhjes së ujit është i njëjtë me sistemin pa pompa. Dy kapacitete të ndryshme për pompat punojnë njëri me 100 MW dhe tjetri me 200 MW. Elementi më i rëndësishëm është mundësia e pompimit për 8 orë:

Varianti 1 (pompa 100 MW)

- Zbrazja e projektuar e brendshme prej 57.2 m3/s
- Diametri i brendshëm i tunelit hyrës 4.90 m
- Diametri i brendshëm i aksit të presionit nga betoni lart në çelikun poshtë përkatësisht 3.85 m dhe 3.65 m;
- Zbrazja e projektuar i mënyrës së funksionimit të turbinës prej 57.23 m^3/s dhe kapaciteti i instaluar prej 220 MW
- Zbrazja e projektuar i mënyrës së funksionimit të pompës prej 18.5 m^3/s dhe kapaciteti i instaluar prej 100 MW
- Diametri i brendshëm i tunelit dalës prej 5.60 m
- Zbrazja e projektuar e marrjes së ulët prej 18.52 m^3/s

Varianti 2 (pompa 200 MW)

- Zbrazja e projektuar e brëndshme prej 74.4 $^3/s$
- Diametri i brëndshëm i tunelit hyrës prej 5.93 m
- Diametri i brëndshëm i aksit të presionit nga betoni lart në çelikun poshtë përkatësisht 4,35 m dhe 4,15 m.
- Design discharge i mënyrës së funksionimit të turbinës prej 74.40 m^3/s dhe kapaciteti i instaluar prej 290 MW.
- Design discharge i mënyrës së funksionimit të pompës prej 36.83 m^3/s dhe kapaciteti i instaluar prej 200 MW.
- Diametri brendshëm i tunelit dalës prej 6.0 m

Zbrazja e projektuar e marrjes së ulët prej 36.83 m^3/s

Prodhimi i energjisë dhe kostot e investimit

Energjia mesatare e prodhuar do të jetë 672.6 GWh për një skemë me kapacitet prej 100 MW, dhe 888.4 GWh për një skemë me kapacitet prej 200 MW. Energjia e kërkuae për pompimin gjatë një viti mesatar hidrologjik është 292.0 GWh dhe 584.0 GWh për të dy kapacitetet e instaluara.

Kosto totale e investimit për variantet 1 dhe 2 vlerësohet në 525.9 milion dhe 590.6 milion euro.

Impakti social dhe mjedisor, masa për zbutjen e efekteve

Impakti social dhe mjedisor si edhe masat zbutëse për realizimin e skemave të grumbullimit dhe pompimit janë pak a shumë të njëjta me ato për skemat pa pompa.

SHTOJCA B
PROCEDURA TREGUESE E SHPRONËSIMIT

Proçedura e mëposhtme e shpronësimit e cila është propozuar nga Autoriteti Kontraktues është me karakter thjesht tregues, nuk është detyruese dhe shërben thjesht për qëllime informimi

A) Procedura e shpronësimit

(Në bazë të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 " Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim të Përkohshëm të Pasurisë, Pronë Private për Interesin Publik", këtej e tutje "Ligji i shpronësimit")

Shpronësimi ushtrohet vetëm për interes publik i cili nuk mund të realizohet ose mbrohet në ndonjë mënyrë tjetër (Dmth, në këtë rast për realizimin e projekteve dhe investimeve që përfaqësojnë shtrirjen territoriale kombëtare ose lokale ose interesin në energji.)

Si subjekti privat ashtu edhe pala e interesuar i paraqet një kërkesë për shpronësim Këshillit të Ministrave, i cili më pas me propozimin e ministrit, i cili është kompetent sipas Ligjit, vendos mbi shpronësimin. Kur shpronësimi bëhet pas kërkesës së një individi/entiteti privat ministri kompetent në statusin e përfaqësuesit të pronës shtetërore, është i autorizuar nga Ligji, që mbi bazën e kërkesës paraprake të subjektit, të bëjë transfertën e pronave të shpronësuara në favor të subjektit privat i cili që në fillim ka aplikuar për të, me kusht që të provohet realizimi i ndërtimit ose investimi në interes publik. Nëse subjekti privat nuk kërkon transferimin e pronës ajo mbetet në pronësi të shtetit.

Personi i interesuar i paraqet kërkesën ministrisë përgjegjëse për aktivitetin respektiv duke paraqitur dokumentacionin e listuar në Nenin 10 të Ligjit për Shpronësimet.

Në ministrinë përkatëse të linjës është krijuar një Komision i Posaçëm për shpronësimet. Kur ministria, nëpërmjet Komisionit të Posaçëm, është e bindur se dokumentet janë përgatitur në bazë të ligjit dhe vendimeve qeveritare, ajo vendos të pranojë kërkesën për shpronësimin dhe njofton personin që ka bërë kërkesën.

Brenda 10 ditëve nga ky njoftim, është parashikuar të lidhet një marrëveshje ndërmjet Ministrisë dhe personit që ka bërë kërkesën.

Brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, Ministria fillon proçedurat sa i përket pronarëve të pronave të prekura nga shpronësimi. Ndërkohë, publikohet një njoftim publik në një gazetë zyrtare dhe në gazetat kombëtare dhe lokale që gëzojnë reputacion të mirë. Këto njoftime publikohen për gjatë një jave.

Një muaj pas datës së fundit të publikimit, ministria i paraqet Qeverisë propozimin për shpronësim në mënyrë që të marrë vendimin përfundimtar.

Subjekti në dobi të të cilit është bërë shpronësimi i paraqet ministrisë që është kompetente në bazë të ligjit kërkesën për shpronësim. Kërkesa do të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

- Dokumentet zyrtare që vërtetojnë statusin dhe regjistrimin e tij si person juridik.
- Planimetritë e nevojshme të miratuara sipas ligjit si dhe argumentet përkatëse ligjorë mbi interesin publik që lidhet me realizimin e këtyre projekteve.
- Dokumentacionin që lidhet me burimin dhe garancinë e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë ato për shpronësim ose ato për shkak të zhvlerësimit të pronës.
- Një vlerësim paraprak të pasurive, objekt shpronësimi si dhe shumën e kompensimit që parashikohet për çdo pronar privat.
- Licencat dhe lejet e nevojshme të organeve kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet.
- Dokumentet zyrtarë që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit nga Kërkuesi i Shpronësimit

Një listë e pronarëve të pronave private, për të cilat kërkohet shpronësimi; një listë të pronarëve të pronave private që janë zhvlerësuar për shkak të shpronësimit si dhe një listë të palëve të treta të cilat duhet të kompensohen për të drejtat e tyre në pronat private që kërkohen

të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilën prej tyre; me përllogaritjet përkatëse të vlerës së këtyre pronave dhe të drejtave, si dhe adresat dhe vendbanimet e fundit të njohura të pronarëve përkatës dhe personave të tretë.

(Shënim: ekzistojnë rregullore të detajuara mbi përmbajtjen dhe standardet që duhen zbatuar në përpilimin dhe paraqitjen e dokumenteve)

Njoftimi Publik– 10 ditë nga nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë dhe personit që ka bërë kërkesën, Ministria fillon proçedurën që lidhet me pronarët e pronave të prekura. Ndërkohë do të botohet një javë rresht një njoftim publik në gazetat zyrtare.

Përcaktimi i Vlerës së Truallit – mesatarja e çmimit të shitjes në zonën e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (Z.R.P.P). Vlerësimi do të bëhet mbi bazën e jo më shumë se 3 muajve nga data e kërkesës zyrtare për shpronësim. Nëse nuk është regjistruar asnjë shitje në atë periudhë, Komisioni i Posaçëm fikson çmimin bazuar në regullat e përshkruara në Vendimin e Këshillit të Ministrave numër 138, datë 23.03.2000 "Për Kriteret Teknike të Vlerësimit dhe të Përllogaritjes së Masës së Shpërblimit të Pasurive Pronë Private që Shpronësohen, të Pasurive që Zhvlerësohen dhe të të Drejtave të Personave të Tretë, për Interes Publik". Çmimi i përcaktuar në përputhje me këtë VKM mund të kundërshtohet dhe pronarët kanë të drejtë të kërkojnë ripërcaktimin nga gjykata të kompensimit - megjithatë kjo nuk çon në ndërprerjen e procedurave të shpronësimit.

Afati kohor për proçedurën e shpronësimit është sa më poshtë vijon:

1. Brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të Koncesionarit për miratimin e shpronësimit, duhet të përfundohet një marrëveshje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.

2. Autoriteti Kontraktues, brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes dhe nga publikimi i kërkesës për shpronësimin për interes publik, fillon proçedurat e njoftimit për çdo pronar apo bashkëpronar të pronave.

3. Brenda 15 ditëve nga data e publikimit, personat e interesuar kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre përpara Autoritetit Kontraktues

4. Autoriteti Kontraktues nuk mund t'i kërkojë Këshillit të Ministrave, marrjen e vendimit të shpronësimit një muaj para datës së përfundimit të proçedurave dhe afatit kohor të njoftimit të pronarit si dhe publikimit të kërkesës për shpronësim.

5. Brenda 15 ditëve nga data e njoftimit apo afatit të publikimit, pronari apo personat e interesuar duhet të njoftojnë Autoritetin Kontraktues nëse ato bien dakord për transferimin e pronës, në përputhje më kushtet e ofruara nga Ministria.

6. Brenda 15 ditëve nga data e dhënies përgjigje nga personat e përmendur më sipër (pika 5), por në çdo rast jo më parë se 1 muaj nga data e fundit e afatit të publikimit, duhet të përfundohen veprimet për transferimin e pronës.

7. Regjistrimi i pronave të shpronësuara duhet të realizohet brenda 30 ditëve nga data e Vendimit të Këshillit të Ministrave.

8. Nëse Koncesionari që ka kërkuar shpronësimin nuk fillon punën brenda 3 muajve nga datat e specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave, shpronësimi konsiderohet i pavlefshëm.

ANEKSI C
LISTA TREGUESE E AUTORIZIMEVE
PËR NDËRTIMIN E NJË HIDROCENTRALI

Kjo listë e cila është përpiluar nga Autoriteti Kontraktues është treguese, jo detyruese dhe është vetëm për qëllime informimi. Autorizimet e përcaktuara më poshtë janë liçensat dhe lejet kryesore të kërkuara nga Ligji për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një hidrocentrali.

Pas përfundimit të procedurave të tenderimit dhe fitimit dhe nënshkrimit të kontratës së koncesionit, duhet të plotësohen procedurat dhe dokumentat e mëposhtme për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit.

1. Leje Koncesioni e lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit

Sipas VKM-së nr.27, datë 19.1.2007, pas miratimit të kontratës së koncesionit për hidrocentralin, koncesionari duhet të aplikojë për lëshimin e Lejen e Koncesionit për përdorim uji tek Këshilli Kombëtar i ujit. Këshilli Kombëtar i Ujit duhet ta lëshojë lejen e koncesionit për përdorim uji brenda 30 ditëve nga paraqitja e aplikimit. Leja e koncesionit për përdorim uji lëshohet në përputhje me ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për Rezervat Ujore" dhe VKM-së nr.289, datë 15.4.2005 "Për caktimin e kërkesave dhe të procedurave për miratimin e lejeve, e autorizimeve dhe koncesioneve për përdorim uji". Aplikimi bëhet me anë të formularit standard të përgatitur nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

2. Leja e Sheshit të Ndërtimit

Aplikimi për marrjen e lejes së sheshit të ndërtimit dhe studimin e tij urbanistik është i detyrueshëm për çdo person fizik ose juridik që ka qëllim të ndërtojë një objekt ndërtimi, qoftë mbi sipërfaqen e tokës, qoftë nën të.

Aplikimi i paraqitet Drejtorisë së Urbanistikës në Këshillin Bashkiak, ose në zyrën e urbanistikës në bashki ose komunë. Vendndodhja e shesheve të ndërtimit dhe kushtet e tyre urbanistike janë paraqitur në Planet e Përgjithshme Rregulluese ose në studime e pjesshme urbanistike. Kërkesa për miratimin e vendndodhjes funksionale dhe të kushteve urbanistike të sheshit bëhet vetëm nga pronari i tokës. Për sheshet e ndërtimit që janë pronë publike mund të paraqitet më shumë se një kërkesë. Këshilli i Qarkut, Këshilli Bashkiak dhe Këshilli i Komunës shqyrtojnë kërkesat, sipas mënyrës së procedurës së tenderimit dhe zgjedhin atë që përmbush më mirë kushtet financiare, ekonomike, sociale, urbanistike, arkitekturore dhe mjedisore.

Nëse organet e pushtetit vendor kanë interes në ndërtimet mbi pronën publike, ata do të fillojnë procedurat e tenderit.

Cilido që aplikon për leje sheshi ndërtimi, duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme:

1. Formularin Tip kërkese Nr. 1, si dhe, nëse është e nevojshme, formularët Nr. 6 (formulari për prerjen e drurëve) dhe Nr. 8 (formulari për prishjen e ndërtimeve ekzistuese);

2. Çertifikatën e Pronësisë shoqëruar me hartat treguese;

3. Gen-Planin e tokës;

4. Azhornime të tjera nga organet dhe ndërmarrjet përkatëse (furnizimi me ujë, kanalizimet e ujrave të zeza, telekomi, etj);

5. Studimin urbanistik pjesor të zonës së ndërtimit, i përgatitur nga një arkitekt i liçensuar për këtë veprimtari;

6. Planimetrinë e vendndodhjes së objektit;

7. Projekt-idenë e objektit;

8. Raportin Shpjegues për studimin dhe projektin;

9. Skemat e sistemeve të jashtme, shesheve, zonave të gjelbra, vendparkimeve, rrugëve dhe trotuareve;

10. Fotomontazhin e objektit me gjendjen aktuale të sheshit;

11. Marrëveshjet me pronarët kufizues, duke përcaktuar numrin e pronave kufizuese;

12. Lejen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, për zonat që janë të mbrojtura nga ky Institut;

13. Çertifikatën nga Institucioni i Monumenteve të Kulturës (për ndërtimet me mbi 3 kate) dhe nga Instituti Sizmiologjik (për ndërtimet me mbi 8 kate);

14. Fotografitë e zonës;

15. Deklaratën noteriale të çdo personi të pa strehë, që banon në pronat private.

Aplikuesi duhet të dërgojë formularin e aplikimit bashkë me dokumentat në zyrën e urbanistikës të pushtetit vendor përkatës. Zyra është ligjërisht e detyruar të vendosë brenda 60 ditëve nga paraqitja e aplikimit.

3. Leja e Ndërtimit

Cilido që dëshiron të ndërtojë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të pajiset gjithashtu me leje ndërtimi. Leja e ndërtimit i jepet personit juridik që është i licensuar si ndërtues. Sipas Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 " Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit ", zbatimi i Punimeve të Ndërtimit kryhet nga ndërtuesit e licensuar sipas ligjit. Licensimi i ndërtuesve rregullohet nga VKM-ja nr. 613, datë 13.12.1993 "Për ushtrimin e veprimtarive në ndërtim dhe projektim të shoqërive". Sipas këtij vendimi çdo shoqëri që dëshiron të kryejë veprimtari në fushën e ndërtimit dhe projektimit duhet të regjistrohet në Regjistrin e Licensave Profesionale, në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Transferimi ose kalimi i lejes së ndërtimit është i ndaluar.

Leja e ndërtimit miratohet brenda 45 ditëve nga aplikimi.

Shoqëria përpara se të marrë lejen e ndërtimit duhet të paguajë 1% të vlerës së investimit, sipas preventivit të projektit. Nëse ndërtimi do të kryhet në pronë publike, në momentin e lëshimit të lejes së ndërtimit shoqëria duhet të paguaje 50% të vlerës së truallit dhe me përfundimin e karabinasë së katit të parë paguhet pjesa tjetër e shumës.

Ndërtimi në zonat turistike përcaktohen në planet rajonale dhe në master planet për zhvillimin e turizmit.

Dokumentat që duhet të paraqiten për të marrë lejen e ndërtimit janë si më poshtë:

1. Leje e sheshit të ndërtimit;

2. Kontrata noteriale midis pronarit të truallit dhe shoqërisë ndërtuese dhe licensa e noterizuar për shoqërinë ndërtuese;

3. Raport teknik për projektin;

4. Kopje të noterizuara të licensave të projektuesit;

5. Të dhëna gjeologjike dhe inxhinierike për vendin e ndërtimit;

6. Të dhëna inxhinierike dhe sizmiologjike për vendin e ndërtimit;

7. Projekti i plotë;

8. Llogaritë kryesore të projektit;

9. Planimetri të sistemeve të jashtme;

10. Lista e punës;

11. Preventivi;

12. Çertifikata nga Inspektoriati i Mjedisit Urban.

4. Lejet Mjedisore

Sipas ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", personat juridikë janë të detyruar të marrin miratimin për veprimtari që ndikojnë ose që mund të ndikojnë në mjedis. Miratimi i aplikimit bëhet me anë të miratimit përkatës nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujit (në vazhdim "Ministri i Mjedisit"), miratim që mund të jetë në formën e deklaratës mjedisore, të lejes mjedisore, të autorizimit mjedisor dhe të miratimit mjedisor, siç parashikohet në ligj.

Në mënyrë që disa lloj projektesh, strategjish dhe planesh zhvillimi të ndërmerren dhe të kryhen, deklarata mjedisore duhet marrë përpara se të merret leja mjedisore.

Sipas legjislacionit mjedisor, pas shqyrtimit të dokumetacionit dhe pas konsultimit me palët e interesuara, Ministri i Mjedisit shpall opinionin e tij zyrtar për projektin, strategjinë ose planin e zhvillimit me anë të deklaratës mjedisore. Koha maksimale për marrjen e deklaratës mjedisore është 3 javë që nga data e aplikimit. Tarifa për t'u paguar është 90.000 lekë, sipas informacionit nga Ministria e Mjedisit.

Shfytëzimi i burimeve minerare dhe i burimeve natyrore, si edhe çdo veprimtari tjetër që ndikon në mjedis, që duhet të pajisen me leje mjedisore përcaktohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Mjedisit.

4.1 Dokumentet e kërkuara për marrjen e lejes mjedisore

Sipas VKM-së nr.249, datë 24.4.2003 dhe Udhëzimit nr.1, datë 7.1.2008 të Ministrit të Mjedisit, për t'u pajisur me leje mjedisore duhet të paraqiten dokumentat e mëposhtme:

- Aplikimi;
- Dokumenta teknike;
- Dokumenta ligjorë (d.m.th Çertifikatë Regjistrimi nga Qëndra Kombëtare e Regjistrimit, që vërteton regjistrimin e aplikuesit);
- Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, hartuar nga persona fizikë ose juridikë të liçensuar, të caktuar nga aplikuesi;
- Të dhëna në lidhje me këshillimet e bëra me publikun dhe me palët e interesuara së bashku me procesverbalet, me dokumentet e paraqitura gjatë takimeve, lista e pjesëmarrësve etj);
- Deklaratë e aplikuesit ku shfaqen kërkesat e publikut, e OJF-ve etj;
- Mendim i organeve të pushtetit vendor në lidhje me zhvillimin e veprimtarisë në fjalë;
- Fatura e pagimit të tarifës prej 50.000 lekë për lejen mjedisore.

4.2 Procedurat për marrjen e lejes mjedisore

Në përputhje me ligjin "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe me ligjin nr. 8990, datë 23.1.2003 "Për ndikimin në mjedis", paraqitja e aplikimit bëhet tek Agjencia Rajonale e Mjedisit (në vazhdim "ARM"). Brenda 20 ditëve, ARM-ja duhet t'i japë Ministrisë së Mjedisit opinionin e saj me shkrim në lidhje me aplikimin. Gjatë fazës proceduriale Ministri krijon një komision i cili bën propozime për vendimin. Ministri merr mendimin e të gjitha palëve të interesuara në lidhje me pozitën e tyre rreth projektit. Një debat publik organizohet dhe drejtohet nga autoriteti vendor. Koha maksimale për marrjen e lejes mjedisore është 5 javë që nga data e aplikimit. Tarifa për t'u paguar në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 5, datë 28.12.2007 është 50.000 lekë.

5. Liçensa nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për prodhim energjie elektrike.

Sipas ligjit nr.9072, datë 22.5.2009 "Për sektorin e energjisë", Enti Regullator i Energjisë jep liçensa për veprimtaritë e mëposhtme:

i) prodhim energjie elektrike;
ii) transmetim i energjisë elektrike;
iii) shpërndarje e energjisë elektrike;
iv) furnizim me shumicë i energjisë elektrike;
v) furnizim me pakicë i energjisë elektrike;
vi) furnizim i enrgjisë elektrike ndaj klientëve të kualifikuar; dhe
vii) tregtim i energjisë elektrike brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Liçensa të veçanta jepen për secilën veprimtari të zhvilluar nga i njëjti subjekt.

Çdo aplikim për liçensë duhet të paraqitet në një formular të përcaktuar nga ERE. Paragrafët vijues tregojnë procedurën specifike, përfshirë hollësitë për secilin dokument të kërkuar.

5.1 Dokumentacioni

Formulari standard i aplikimit i jepet aplikuesit. Dokumentat vijues duhet të bashkohen me të:

a) Dokumentacion ligjor, administrativ dhe pronësie;
b) Dokumentacion financiar dhe fiskal;
c) Dokumentacion teknik në lidhje me çentralet hidro-energjitike;
d) Liçensa nga organe të tjera.

5.2 Procedurat e liçensimit

Nëse fillimi i procedurave për shqyrtimin e një aplikimi për liçensë miratohet nga ERE, ky i fundit brenda 3 ditëve, boton njoftimin për aplikimin në 3 gazeta të përditshme kombëtare për 2 ditë të njëpasnjëshme. Njoftimi përfshin informacion të shkurtër për aplikimin dhe njofton se paraqitja e kundërshtimeve ose e pretendimeve nga palët e interesuara mund të bëhet brënda afateve të përcaktuara nga Rregullorja e ERE ose nga Procedura e Liçensimit. Publikut i jepet mundësia të konsultohet me aplikimin së bashku me dokumentat e tjerë të paraqitur nga aplikuesi për një afat prej 2 muajsh. ERE mund t'i kërkojë aplikuesit paraqitjen e dokumentave të tjerë, që të bashkangjiten me formularin, brënda afateve të caktuara nga ERE, por, gjithnjë brënda afatit të përmendur më lart. ERE mund të refuzojë aplikimin nëse aplikuesi nuk paraqet

dokumentat e kërkuara.

ERE vendos për dhënien ose refuzimin e liçensës brënda nja afati 90 ditor nga paraqitja e aplikimit.

6. Vlerësimi teknik i projektit nga qeveria

Sipas VKM nr.191, datë 22.3.2007 të tërë projektet për ndërtimin e një hidrocentrali me koncesion i nënshtrohen vlerësimit qeveritar nga një grup ekspertësh të fushave të hidro-teknologjisë, të inxhinierisë, të ligjit, të ekonomisë, të gjeologjisë etj.

Ekspertët do të vlerësojnë projektin duke konsideruar shfrytëzimin optimal të rezervave ujore dhe do të kryejnë kontrollin teknik bazuar në kërkesat e ligjit "Për rezervat ujore", i amenduar dhe ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i amenduar.

Raporti i vlerësimit të ekspertëve rishikohet dhe miratohet nga shumica e votave të Bordit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore të Shqipërisë, në vazhdim "AKBN"). Materiali i vlerësimit dhe vendimi i AKBN-së janë pjesë përbërëse e dokumentacionit që i dërgohet Autoritetit Kontraktues (Ministrisë së Ekonomisë, të Tregtisë dhe Energjetikës) për të bërë të mundur miratimin e koncesionit.

Përveç kësaj, në përputhje me ligjin "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" dhe VKM-së nr.363, datë 18.7.2002 ato projekte ndërtimi që mendohet se kanë minimalisht një vlerë prej 100 milion lekë i nënshtrohen vlerësimit nga një institucion qeveritar. Kërkesa për vlerësimin paraqitet nga investitori në momente të ndryshme të ndërtimit, si programimi i investimit, lëshimi i lejes së sheshit të ndërtimit, lëshimi i lejes së ndërtimit si dhe kur miratohet projekti zbatues.

7. Aprovimi nga OST-ja për lidhjen në rrjet dhe për përdorimin

Veprimtaria e prodhimit të energjisë duhet të lidhet më sistemin e transmetimit. Një nga të drejtat e prodhuesit të energjisë elektrike është mundësia e hyrjes në rrjetin e transmetimit, përkundrejt pagesës së tarifave të transmetimit ndaj ERE. .

Në mënyrë që të ketë të drejtë të hyjë në sistemin e transmetimit, i licensuari duhet të paraqesë disa dokumenta dhe të plotësojë disa kushte përkundrejt operatorit të sistemit të transmetimit, OST-së. Rregullat dhe procedurat janë përcaktuar në Kodin e Transmetimit i miratuar nga ERE me Vendimin nr.123, datë 24.10.2008.

Aplikimi tek OST-ja për lidhjen me rrjetin duhet të përmbajë të dhënat dhe dokumentat e mëposhtëm, megjithatë, OST-ja ka të drejtë të kërkojë të dhëna shtesë sipas rastit:

i) emri, adresa, kontaktet e aplikuesit (telefon/faks/email);

ii) qëllimi i lidhjes me rrjetin (njësi prodhimi, instalim shpërndarje etj);

iii) angazhimin me shkrim të aplikuesit për respektimin e Kodit të Transmetimit;

iv) dokumenta në lidhje me nivelin e voltazhit që aplikuesi dëshiron të lidhet.

OST-ja duhet të pranojë ose të refuzojë aplikimin brënda 60 ditëve nga data e aplikimit. Nëse duhen të dhëna shtesë, afati mund të shtyhet për 30 ditë nga data që të dhënat shtesë janë dorëzuar. Këto të dhëna duhet të paraqiten brenda 20 ditëve. Nëse OST nuk merr të dhënat shtesë, mund të refuzojë aplikimin. Miratimi teknik nga OST-ja bëhet brenda 90 ditëve nga data kur janë paraqitur të gjithë dokumentat.

Pasi është dhënë miratimi nga OST-ja, aplikuesi lidh një kontratë me këtë operator. Kushtet e përgjithshme, si edhe, kushtet specifike teknike dhe financiare përfshihen në këtë kontratë.

SHTOJCA D
FORMA E GARANCISË SË KONTRATËS
GARANCIA E KONTRATËS

[Data]

i) Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

ii) Në vëmendje të Shkëlqesisë së tij, Ministrit :

iii) Blvd. "Dëshmorët e Kombit", 1001 Tiranë, Shqipëri

Letra e Garancisë numër.: [●]

Përderisa ju keni lidhur me klientin tonë DEVOLL HYDROPOWER SHA ("Koncesionari") një kontratë koncesioni që lidhet me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e tre hidrocentraleve si pjesë e Projektit Hidroenergjitik mbi Lumin Devoll, Republika e Shqipërisë ("Kontrata e Koncesionit"):

Ne, [ ] ("Banka"), në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme marrim përsipër t'ju paguajmë çdo shumë deri në një vlerë maksimale prej 50 milion (pesëdhjetë milionë) Euro ("Shuma maksimale") në lidhje me detyrimet e Koncesionarit në bazë të Nenit 7.3.14 të Kontratës se Koncesionit dhe në përputhje me sa më poshtë:

A) Ne do t'ju paguajmë menjëherë me paraqitjen e kërkesës suaj me shkrim dhe pavarësisht të ndonjë kundërshtimi nga Koncesionari apo ndonjë palë tjetër, këtë shumë ose shumat sipas kërkesës suaj deri në Shumën Maksimale.

B) Të gjitha pagesat e bëra pas kërkesës suaj do të jenë të plota, duke mos u bërë ndonjë zbritje nga pagesa, si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen, për pagimin e ndonjë takse, detyrimi, tatimi, pagese të detyrueshme, tarife, zbritje ose pagesa të mbajtura të çfarëdolloj natyre dhe të vendosura nga cilido;

C) Angazhimet e marra në këtë garanci përbëjnë detyrimet tona thelbësore dhe të drejtpërdrejta dhe janë të pakushtëzuara dhe të parevokueshme. Ne nuk do të çlirohemi nga detyrime të tilla për asnjë lloj arsye të cfarëdolloj natyre apo burimi, të tilla si ndryshimi në kushtet e kontratës ose zgjatja e saj, ndryshimi në objektin apo natyrën e punës që do të kryhet, apo çdo lloi mosveprimi ose veprim i kryer nga ju apo nga ndonjë palë e tretë që do të na përjashtonte ose shkarkonte nga detyrimet dhe përgjegjësite e shprehura në këtë garanci.

D) Kjo Garanci do të hyjë në fuqi më 1 Shkurt, 2009 dhe do të jetë e vlefshme dhe fuqi të plotë deri në fund të _____,Muajit _____, Vitit (që do të thotë 1 vit pas datës së lëshimit të kësaj garancie).

E) Kjo garanci do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë garanci do të zgjidhet nga gjykata kompetente shqiptare.

Banka
Nënshkrimet e Autorizuara

SHTOJCA E
PËRLLOGARITJA E TOTALIT TË NBK

Totali i normës së brendshme të kthimit ("Totali i NBK") llogaritet në bazë të formulës së mëposhtme:

$$NPV = \sum_{t=0}^{N} \frac{C_t}{(1 + r)^t} = 0$$

ku:

NPV = Vlera Aktuale Neto (siç përkufizohet më poshtë);

Ct = Rrjedhja kesh (siç përkufizohet më poshtë) në një vit të veçantë ;

r = Totali i NBK i cili përbën normën e zbritjes që rezulton në një Vlerë Aktuale Neto zero të një serie rrjedhjesh kesh;

t = koha, që do të thotë një vit i veçantë brenda periudhës që po shqyrtohet,

Vlera Aktuale Neto do të thotë vlera aktuale e Rrjedhjeve të ardhshme Kesh.Vlera aktuale e Rrjedhjeve të ardhshme Kesh llogaritet, duke i zbritur këto Rrjedhje Kesh në normën e aplikueshme të kthimit.

Rrjedhja(et) Kesh do të thotë, në lidhje me çdo periudhe kohore, (a) Të ardhurat e marra gjatë një periudhe të tillë, minus (b) Shpenzimet e paguara gjatë kësaj periudhe.

Të ardhura do të thotë, për çdo periudhe kohore, shumën e (a) Prodhimit Elektrik Neto të prodhuar në çdo orë të ditës shumëzuar me çmimin aktual elektrik të tregut, kuotuar në Bursën Përkatëse të Energjisë për atë orë të ditës ("Të Ardhura Neto nga Shitjet e Energjisë Elektrike), dhe b) të ardhurat e përftuara nga Koncesionari si rrjedhojë e e shitjeve faktike të çertifikatave të ripërtëritjes së energjisë apo produkteve të ngjashme me to, nëse ka. Bursa Përkatëse e Energjisë do të jetë një bursë energjie që (i) ndodhet në rajonin e Evropës Juglindore, (ii) karakterizohet nga një likuiditet i lartë dhe (iii) reflekton në mënyrën e duhur çmimin rajonal të tregut në nivel rajonal. Palët do të përcaktojnë në mënyrë unanime para Përfundimit Finaltë Hidrocentralit të parë, se cila nga bursat e energjisë do të jetë Bursa Përkatëse e Energjisë. Nëse palët nuk bien dakord mbi caktimin e kësaj Burse, Bursa Përkatëse e Energjisë do të përcaktohet nga Eksperti Teknik dhe Ekonomik në përputhje me Nenin 13.

Shpenzime do të thotë (a) për çdo periudhë deri në dhe duke përfshirë Datën Faktike të Përfundimit të Punimeve, Faza 1 e Shpenzimeve, dhe (b) për çdo periudhë pas Datës Faktike të Përfundimit të Punimeve, Faza e dytë e Shpenzimeve. Shpenzimet nuk përfshijnë detyrimet financiare jo-kesh, të tilla si shkalla e zhvlerësimit, amortizimi apo zërat e tjerë të bilancit të një natyre të ngjashme. Shpenzimet e paguara apo për t'u paguar nga Shoqëria Koncesionare te një Filial i Shoqërisë Koncesionare për shërbimet e kryera nga ky Filial, do të llogariten në bazë të parimit ligjor që aplikohen në transaksionet reale dhe të drejta dhe jo në kushte favoriuese.

Faza I e Shpenzimeve do të thotë të gjitha apo çdo shpenzim të paguar apo për t'u paguar gjatë çdo periudhe duke përfshirë dhe Datën Faktike të Përfundimit të Punimeve nga apo në emër të Shoqërisë Koncesionare në lidhje me Projektin, duke përfshirë por pa u kufizuar në në të gjitha shpenzimet për projektimet, zhvillimin e punimeve, ndërtimin, shfrytëzimi dhe mirëmbajtjen(të tilla si, në veçanti, pa kufizim, pagesat për personelin dhe stafin drejtues, punimet civile, punimet hidromekanike, pajisjet mekanike dhe elektrike, infrastrukturën, blerjen e tokës, shpërnguljet, shqyrtimet, studimet e fizibilitetit, planimetritë, mbikqyrjen dhe administrimin, aksesin dhe lidhjen me Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike dhe përdorimin e tij, etj.), pagesat për çdo Qira në vazhdim, sigurimin, Taksat (të tilla si, pa kufizim, pagesat e taksave mbi të ardhurat e shoqërisë, pagesa e koncesionit, taksa për përdorimin e ujit, taksa urbane dhe e infrastrukturës, etj. secila nëse është e zbatueshme), kostot dhe pagesat e tjera që lidhen me përftimin dhe mbajtjen në fuqi të të gjitha Autorizimeve, pagesat sipas Kontratës së Koncesionit tek Autoriteti Kontraktues ose tek ndonjë Ent tjetër Shtetëror, pagesat për shërbimet ligjore dhe financiare si dhe pagesa të tjera profesionale në lidhje me sa u përmendën më sipër, si dhe kostot e financimit të borxhit në vlerat e tregut në lidhje me shpenzimet e sipërpërmenduta (të tilla si në veçanti dhe pa u kufizuar, të gjithë interesat mbi

huatë që i janë dhënë Shoqërisë Koncesionare dhe të gjitha pagesat e bëra në lidhje me këto hua dhe si rrjedhojë garancia e dhënë; për shmangien e çdo keqinterpretimi, ri-shlyerja e principalit për çdo hua të tillë nuk përbën një Shpenzim).

Faza II e Shpenzimeve do të thotë të gjitha apo çdo shpenzimi të paguar apo për t'u paguar gjatë çdo periudhe pas Datës Faktike të Përfundimit të Punimeve nga ose në emër të Shoqërisë Koncesionare në lidhje me Projektin, duke përfshirë por pa u kufizuar në, të gjitha shpenzimet e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes (të tilla si në veçanti, pa kufizim, pagesat për personelin dhe stafin drejtues, shpenzimet për mirëmbajtjen civile, hidraulike, mekanike dhe elektrike, administrimin, mbikqyrjen, avancimin, përdorimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike), pagesat për çdo Qira në vazhdim, sigurimi, Taksat (të tilla si ,por duke mos u kufizuar në, pagesat e taksave mbi të ardhurat e shoqërisë, pagesa e koncesionit, taksa për përdorimin e ujit, taksa urbane dhe e infrastrukturës, etj. secila nëse është e zbatueshme), kostot dhe pagesat e tjera që lidhen me përftimin dhe mbajtjen në fuqi të të gjitha Autorizimeve, pagesat sipas Kontratës së Koncesionit tek Autoriteti Kontraktues ose tek ndonjë Ent tjetër Shtetëror, pagesat për shërbimet ligjore dhe financiare si dhe pagesa të tjera profesionale në lidhje me sa u përmendën më sipër, me kusht, megjithatë, që kostot e financimit (të tilla si interesi mbi huatë që i janë dhënë Shoqërisë Koncesionare dhe të gjitha pagesat e bëra në lidhje me këto hua dhe si rrjedhojë garancia e dhënë; për shmangien e çdo keqinterpretimi, ri-shlyerja e principalit për çdo hua të tillë nuk përbën një Shpenzim).

SHTOJCA F
KËRKESAT PËR SIGURIMIN

Në masën e mundshme sipas kushteve të arsyeshme tregtare, Koncesionari do të nxjerre policat e mëposhtme të sigurimit të dhëna nga Shoqëri Sigurimi Evropiane dhe me reputacion të cilat janë lejuar të kryejnë këto aktivitete në përputhje me legjislacionin shqiptar

a) Gjatë periudhës së ndërtimit,:

Kompensimi i punëtorëve dhe sigurimi nga aksidentet për personelin e Hidrocentraleve në përputhje me ligjin e zbatueshëm;

Sigurimi i Kontraktorit nga Të gjitha Rreziqet për vlerën e plotë të zëvendësimit të Hidrocentraleve, me një deduksion që nuk do tejkalojë 50,000 (apo ekuivalentin në lekë) Euro; dhe

Sigurimi për Përgjegjësinë Publike më një mbulim prej të paktën 5,000,000 Euro (ose ekuivalenti në lekë) për çdo rast sigurimi.

b) Gjatë Fazës së Shfrytëzimit:

Kompensimi i punëtorëve dhe sigurimi nga aksidentet për personelin e Hidrocentraleve në përputhje me ligjin e zbatueshëm;

Sigurimi për Përgjegjësinë Publike më një mbulim prej të paktën 5,000,000 Euro (ose ekuivalenti në lekë) për çdo rast sigurimi.

Sigurimi nga Të gjitha Rreziqet për pasuritë e paluajtshme që mbulon vlerën e plotë të zëvendësimit të Hidrocentraleve, me një deduksion që nuk tejkalon 50,000 (apo ekuivalentin në lekë) Euro;

Sigurimi nga humbja e Tërthortë në vijim të sigurimit nga Të gjitha Rreziqet me një periudhë zhdëmtimi prej jo më pak se 12 muaj dhe një periudhë pritjeje (të zbritshme) prej jo më tepër se 60 ditë;

Sigurimi nga mosfunksionimi i makinerive që mbulon vlerën e plotë të zëvendësimit të pajisjes përkatëse, me një deduksion që nuk tejkalon 100,000 Euro (apo ekuivalent në lekë) për çdo rast sigurimi;

Sigurimi nga humbja e Tërthortë në vijim të sigurimit nga nga mosfunksionimi i makinerive, me një periudhë zhdëmtimi prej jo më pak se 12 muaj dhe në periudhë pritjeje prej jo më tepër se 60 ditë.

Autoriteti Kontraktues dhe Huadhënësit do të jenë të siguruarit shtesë sipas të gjitha këtyre policave të sigurimit dhe Huadhënësit (ose përfaqësuesi që vepronpër llogari të tyre) do të jenë subjektet që do të paguhen për humbjet.

SHTOJCA G
UDHËZIMET PËR TESTET E FUNKSIONIMIT

Koncesionari do të paraqesë një program të hollësishëm për Testet e Funksionimit, në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë, i cili do të përfshijë:

- Treguesin e datës, orës dhe kohëzgjatjes së testeve
- Proçedurën e detajuar për testet
- Kriteret e suksesit apo dështimit për testet
- Sistemin për dokumentimin e rezultateve të testeve
- Para apo gjatë periudhës së testeve, Autoriteti Kontraktues do të japë të gjithë informacionin që i është kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Koncesionari për të lehtësuar zhvillimin e proçedurave të testeve.

Nëse kërkohet nga secila prej Palëve dhe pas njoftimit të arsyeshëm, Përfaqesuesit e Autoritetit Kontraktues do të jenë prezentë gjatë testeve (me shpenzimet e Palës që ka kërkuar një gjë të tillë).

Testet e Funksionimit që lidhen me një Hidrocentral do të përmbajnë:

a) Veprimin e Sistemit Nxitës

b) Kapacitetin Reagues

c) Testet e Kundërshtimit të Ngarkesës
d) Kapacitetin Minmale Vazhdues
e) Testi i Kapacitetit
Duhet të demonostrohen aftësitë e mëposhtme:
iv) Që çdo Njësi arrin Kapacitetin e Instalimit për këtë Njësi
v) Që ky Hidrocentral arrin Kapacitetin e Instalimit

Një Njësi do të konsiderohet si operacionale nëse testet e përshkruara më lart janë përfunduar në mënyrë të suksesshme.

Me kusht që çdo Njësi të jetë kolauduar në përputhje me paragrafët paraardhës dhe ky Hidrocentral të jetë kolauduar në të gjitha aspektet e tjera, Koncecionari mund t'i deklaroje METE-s me anë të njoftimi, nëse ky Hidrocentral është ose jo i aftë të arrijë Kapacitetin e Instaluar.

Çdo mosmarrëveshje përsa i përket Kapacitetit të Instaluar do t'i paraqitet nj Eksperti Teknik dhe Ekonomik në përputhje me Nenin 13.2 të kësaj Kontrate.

SHTOJCA H
FORMA E NJOFTIMIT TË MBYLLJES FINANCIAR E

Drejtuar: Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
vi) Në vëmendje të Shkëlqesisë së tij,Ministrit :
vii) Blvd. "Dëshmorët e Kombit", 1001 Tiranë, Shqipëri
Faks: [●]

Lënda: Projekti Hidroenergjitik i Devollit– Njoftimi i Mbylljes Financiare

Duke ju Referuar Kontratës së Koncesionit në lidhje me projektimin, ndërtimin, financimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit Hidroenergjitik në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë ("Kontrata e Koncesionit") e lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë, dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë si Autoriteti Kontraktues dhe EVN AG, STATKRAFT AS dhe DEVOLL HYDROPOWER sha, secila si Bashkë-Koncesionar , më …., 2008,

Fjalët e përdorura me shkronjë të madhe dhe jo të përkufizuara në këtë do të kenë kuptimin që u jepet këtyre fjalëve në Kontratën e Koncesionit

Në respektim dhe në përputhje me Nenin 3.3.1 të Kontratës së Koncesionit, ne të nënshkruarit, me anë të kësaj, konfirmojmë se kemi siguruar një financim të tillë që mbulon njëqind për qind (100%) të kostos totale të kapitalit të Projektit përmes marrëveshjeve me ndonjë apo të gjithë Aksionerët dhe/ose Palët Financuese për të siguruar financimin në formës e Pjesëmarrjes Pasurore të Aksionerëve dhe/ose borxhit ndaj Shoqëris Koncesionare, në përputhje me zhvillimin e Projektit. Për shmangien e çdo keqinterpretimi, fondet sipas këtij financimi të siguruar do t'i derdhen Shoqërisë Koncesionare në mënyrë periodike në përputhje me kërkesat e saj financiare në fazën përkatëse të Projektit.

_____
DEVOLL HYDROPOWER SHA
[nënshkrimet e autorizura]

SHTOJCA I
INVENTARI I INFRASTRUKTURËS QË DO TË PËRMBYTET

Kompensimi i Rrugëve dhe Urave që do të përmbyten
Studimi i Detajuar i shumës dhe kostove te rrugëve dhe urave të përmbytura në Devoll

Projekti HEC.


I përgatitur, përfshirë vlerësimin e detajuar të kostos nga konsulenti, Z.ing. Arqile Prifti.

Ky vlerësim paraqet të plotë gjatësinë e rrugëve të asfaltuara dhe me gurë i grimcuar dhe numrin e urave të cilat do të dalin jashtë përdorimit pas përbytjes së rezervuarve në Luginën e Devollit.


